



Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur
Projektat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo
Project of the Kosovo Foundation of Open Society

Identifikimi i Politikave të Qeverisjes së Hapur në Evropën Juglindore

Vendi: Republika e Kosovës



Mbështetja e së Drejtës për Informim
në Evropën Juglindore

Financuar nga:
Bashkimi European



Deklaratë mohimi:
Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e mbështetësve.

Përgatitur nga:
INSTITUTI RIINVEST
Fisnik Reçica, Etida Zeka, Agon Nixha
dhe Premton Hyseni



Publikuar nga:
Forum 2015 - projekt operacional i KFOS
Imzot Nikë Prela nr. 13
10 000 Pristina



I. QEVERISJA E HAPUR	9
a. Veprimet dhe intervenimet	
b. Institucionet juridike dhe administrative	
c. Përfshirja e elementeve shumetnike në planet e veprimit	
d. Analiza e aktorëve	
1. SFIDAT E MËDHA TË PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR	19
Transparenca	
Llogaridhënia	
Teknologjia dhe inovacioni	
Tabela 1. Përmirësimi i shërbimeve publike: Rreziqet dhe Mundësitë	
2. INTEGRITETI PUBLIK I SHTUAR	31
Transparenca	
Pjesëmarrja Publike	
Llogaridhënia	
Teknologjia dhe inovacioni	
Tabela 2. Integriteti publik i shtuar. Rreziqet dhe Mundësitë	
3. MENAXHIMI EFEKTIV I RESURSEVE PUBLIKE	39
Transparenca	
Pjesëmarrja publike	
Llogaridhënia	
Teknologjia dhe inovacioni	
Tabela 3. Menaxhimi efektiv i resurseve publike. Rreziqet dhe Mundësitë	
4. KOMUNITETET E SIGURTA	45
Transparenca	
Pjesëmarrja publike	
Llogaridhënia	

Teknologjia dhe inovacioni

Tabela 4. Komunitetet e sigurta. Rreziqet dhe Mundësitë

5. LLOGARIDHËNIA E SHUAR E KORPORATAVE **51**

Transparenca

Pjesëmarrja publike

Llogaridhënia

Teknologjia dhe inovacioni

Tabela 5. Përmirësimi i qeverisjes së korporatave. Rreziqet dhe Mundësitë

II. SONDAZH LIDHUR ME BESIMIN DHE MIRËBESIMIN NË QEVERISJEN E HAPUR **63**

Metodologjia dhe informatat e përgjithshme

REZULTATET E SONDAZHIT

Niveli i besimit dhe i mirëbesimit në institucionet shtetërore dhe publike

Transparenca

Pjesëmarrja Publike

Llogaridhënia

Përdorimi i teknologjisë

III. PËRFUNDIM **75**

IV. BURIMET / REFERENCAT **79**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Identifikimi i Politikave të Qeverisë ka për qëllim identifikimin e politikave aktuale që kanë të bëjnë me qeverisjen e hapur dhe me zbatimin e tyre praktik nga Qeveria dhe nga institucionet e tjera relevante. Qasja në të dhënat e ekspozuara është një mjet i domosdoshëm për anëtarësimin e ardhshëm të Kosovës në Nismën e Partneritetit për Qeverisje të Hapur OGP (PQH). Nisma OGP (PQH) ua mundëson qeverive ta promovojnë transparencën, t'iu japin mundësi qytetarëve, ta luftojnë korrupsionin dhe t'i shfrytëzojnë teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Në mënyrë që të anëtarësohet në Nismën OGP (PQH), Qeveria e Kosovës duhet ta përqafojë Qasjen e nivelit të lartë të Qeverisjes së Hapur e cila duhet të shpallet në një Letër të Qëllimit ose në një Deklaratë për Qeverisje të Hapur. Për më tepër, duhet ta hartojë një plan të veprimit të vendit dhe të angazhohet për raportim të pavarur në mënyrë që ta përcjellë përparimin në veprimet e marra përsipër në fillim.

Qeveria e Kosovës rishtazi ka ndër marrë një nismë që ta fillojë procesin për t'iu bashkuar Nismës OGP (PQH). Qeveria ka vendosur ta autorizojë Ministrinë për Integritet Evropian që ta krijojë një grup punues, i cili do të bashkë-drejtohet nga përfaqësuesi i Lëvizjes FOL (Organizatë joqeveritare e cila merret me kërkimin dhe avokimin për çështjet që kanë të bëjnë me transparencën në Kosovë). Në vendim po ashtu kërkohet përfshirja e anëtarëve të odave ekonomike dhe të organizatave të shoqërisë civile. Më 19 korrik, si njëri prej hapave të parë për t'u bërë anëtar të OGP (PQH), Ministrja për Integritet Evropian, në një Letër të Qëllimit, ka theksuar interesimin e Qeverisë së Kosovës për t'iu bashkuar Nismës OGP (PQH).

Sa ju përket kritereve të cilat duhet t'i plotësojë Kosova për t'u anëtarësuar në OGP (PQH), rishtazi Kosova është përfshirë në vlerësimin e kritereve të pranueshmërisë nga ana e ekipit mbështetës të OGP (PQH), por është vlerësuar vetëm në lidhje me kriterin e Qasjes në Informata (disponueshmëria e ligjit mbi lirinë e informimit) por jo në lidhje me tri kriteret e tjera siç janë: Transparenca Fiskale (publikimi i propozimit të buxhetit të ekzekutivit dhe raporti i auditimit) Deklarimet lidhur me zyrtarët e zgjedhur apo zyrtarët e lartë publikë (deklarimi publik i të ardhurave dhe i pasurisë së zyrtarëve të zgjedhur dhe të zyrtarëve të lartë publikë) dhe Angazhimi i Qytetarëve (të qenit të hapur ndaj pjesëmarrjes dhe angazhimit të qytetarëve në bërjen e politikave dhe në qeverisje). Gjetjet tona tregojnë që Kosova është e përshtatshme për anëtarësim në OGP (PQH).

Sa ju përket politikave të përgjithshme, Kushtetuta e Kosovës i përfshin standardet e sistemit të hapur të qeverisjes dhe ekzistojnë ligjet përkatëse të cilat janë vendimtare për nismën OGP (PQH). Qeveria e Kosovës është duke e zbatuar strategjinë e e-qeverisjes që është në funksion të qasjes së sistemit të hapur të qeverisjes. Një portal elektronik është aktiv dhe qytetarët, bizneset dhe palët e tjera të interesuara mund t'i shfrytëzojnë informatat relevante për shërbimet publike ose për administratën publike. Pjesa më e madhe e ligjeve të aprovuara në Kuvendin e Kosovës janë në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së. Ekziston ligji mbi deklarinë e pasurisë dhe ligji mbi qasjen në dokumentet publike. Sfidat kryesore të institucioneve të Kosovës është zbatimi i duhur i ligjeve të aprovuara.

Gjatë dy vjetëve të kaluar, Qeveria e Kosovës e ka vendosur përqendrimin politik në dialogun intensiv me Qeverinë e Serbisë të lehtësuar nga BE-ja që ka për qëllim arritjen e mar-

rëveshjeve teknike dhe politike për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Integrimi i komunave veriore të Kosovës, të populluara kryesisht me serbë të Kosovës, në sistemin legjislativ konsiderohet si njëra prej sfidave më të mëdha për Qeverinë e Kosovës. Ky ishte një hap i rëndësishëm në mënyrë që Komisioni i BE-së (2013) ta rekomandojë hapjen e bisedimeve për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim (MSA). Meqë kriteret e procesit të integritetit në BE përfshijnë edhe çështjet që kanë të bëjnë me OGP (PQH), anëtarësimi në OGP (PQH) do të jetë një mjet tjetër që Qeveria e Kosovës t'i forcojë institucionet sa ju përket pesë fushave të cilat i adreson OGP (PQH): rritja e cilësisë së shërbimeve publike, integriteti publik, menaxhimi efektiv i resurseve publike, përmirësimi i sigurisë së komuniteteve dhe llogaridhënia e korporatave. Këto pesë fusha të OGP (PQH) janë analizuar në kontekst të katër kriterëve të OGP (PQH): transparencë, integriteti publik, pjesëmarrja qytetare dhe inovacioni ose teknologjia e shfrytëzuar nga Qeveria e Kosovës për ta rritur efikasitetin dhe përgjegjësinë e organeve publike.

Janë bërë disa hapa për përmirësimin e transparencës, të integritetit publik dhe të pjesëmarrjes publike. Janë hapur faqet e internetit të institucioneve përkatëse dhe portalet elektronike të qeverisjes dhe shfrytëzohen si mjete kryesore të transparencës së të dhënave. Prandaj, nevojitet përmirësim i mëtejshëm. Nuk ka procedura të standardizuara dhe të dhënat e publikuara varen nga liria e veprimit të zyrtarëve në institucionet përkatëse. Zbatimi i plotë i qasjes së e-qeverisjes dhe transparencë e shtuar mund ta lehtësojnë qasjen e qytetarëve në informata e cila në anën tjetër mund ta rrisë cilësinë e shërbimeve publike dhe të administratës publike. Të dhënat e hapura për të gjitha proceset e rekrutimit, siç janë vlerësimet në procesin e rekrutimit, mund të krijojnë presion pozitiv në shtimin e cilësisë të të punësuarve të pajtuar në punë. Institucionet qendrore dhe ato komunale i publikojnë buxhetet e tyre të aprovuara në faqet e tyre të internetit, edhe pse kjo mund të mos ndodhë në të gjitha komunat. Propozimi i buxhetit i ekzekutivit nuk bëhet publik para se të aprovohet. Raportet e auditimit të institucioneve publike bëhen publike nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Ndërsa, Agjencia Kundër Korrupsionit e publikon pasurinë e deklaruar të zyrtarëve publikë dhe të politikanëve të zgjedhur. Legjislacioni i Kosovës është në përgjithësi në pajtim me standardet e BE-së, por problemet kryesore janë në zbatimin e ligjeve të aprovuara. Integriteti i institucioneve të pavarura është po ashtu i zbehtë për shkak të ndikimit politik. Përfshirja e përfaqësuesve të ndikuar politikisht, si anëtarë të bordit ose drejtorë ekzekutivë në institucionet e pavarura, minon në masë të madhe besueshmërinë e këtyre institucioneve. Një problem i ngjashëm ekziston në Ndërmarrjet Publike (NP) ku anëtarët e bordit janë në përgjithësi të lidhur me partitë politike.

Një qasje e qeverisjes së hapur me përfshirje të gjerë të qytetarëve në qeverisje është thelbësore në mënyrë që ta rrisë cilësinë e shërbimeve publike dhe integritetin publik të institucioneve. Si hap fillestar, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me CIVIKOS (Rrjeti i organizatave të shoqërisë civile) kanë hartuar strategjinë qeveritare për bashkëpunimin e qeverisë dhe të shoqërisë civile në Kosovë për periudhën 2013-2017 e cila ka për qëllim përmirësimin e procesit të konsultimeve dhe të bashkëpunimit. Prandaj, përfshirja e deritashme e qytetarëve dhe e organizatave të shoqërisë civile nuk është e kënaqshme. Për ta mundësuar një qasje më të lehtë dhe një përfshirje më të madhe të qytetarëve, një platformë digjitale e informatave kthyesë, e cila do të ishte e obligueshme për të gjitha institucionet publike, do

ta lehtësonte një proces më të gjerë konsultativ, ku secili qytetar i interesuar do të ishte në gjendje të ofrojë informata kthyesë për çështjet me interes. Kufizimet e sipërpërmendura të politikave dhe kufizimet e tjera lidhur me to dhe zbatimi i tyre duhet të adresohen në planin e ardhshëm të veprimit të OGP (PQH). Një përkushtim serioz ndaj standardeve të qeverisjes së hapur mund ta përmirësojë perceptimin dhe besimin e qytetarëve ndaj institucioneve. Aktualisht, rezultatet e sondazhit të opinionit të kryer nga Riinvest (2013)¹ tregojnë që Qeveria e Kosovës, Presidenti i Kosovës dhe partitë politike janë institucionet të cilave qytetarët ju besojnë më së paku. Në anën tjetër, qytetarët e Kosovës duket që kanë më shumë besim në media, në institucionet fetare dhe në organizatat që kanë të bëjnë me sigurinë siç janë Policia e Kosovës dhe KFOR-i.

¹ Riinvest (2013) i referohet rezultateve të sondazhit me opinionin të paraqitur në pjesën IV.

I. QEVERISJA E HAPUR

Qasja në qeverisjen e hapur përmes Nismës OGP (PQH) ua mundëson qeverive ta promovojnë transparencën, t'i fuqizojnë qytetarët, ta luftojnë korrupsionin dhe t'i shfrytëzojnë teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Të shfrytëzuarit e teknologjisë informative do ta rriste efikasitetin dhe përgjegjësinë e organeve publike². Përqendrimi në të dhënat e hapura e dallon nismën OGP (PQH) nga programet e tjera. Megjithatë, nuk ka të bëjë vetëm me transparencën sepse kushtet institucionale dhe procedurale të përgjegjësisë janë po ashtu pjesë përbërëse të nismës (Peteri, 2013)³.

Nisma OGP (PQH) mbështet bashkëpunimin ndërmjet shumë aktorëve. Ajo mbikëqyret nga një komision drejtues i qeverive dhe i organizatave të shoqërisë civile. Në mënyrë që të anëtarësohen në Nismën OGP (PQH) është e nevojshme që qeveritë ta përqafojnë Qasjen e nivelit të lartë në Qeverisjen e Hapur të cilën duhet ta theksojnë në një Letër të Qëllimit ose në një Deklaratë Qeverisjes së Hapur, ta dorëzojnë një plan të veprimit të vendit dhe të angazhohen për raportim të pavarur në mënyrë që ta përcjellin përparimin e bërë lidhur me veprimet e marra përsipër në fillim.

Në parimet e saj themelore Kushtetuta e Kosovës i mbështet standardet e saj të qeverisjes së hapur. Në nenin 1 të Kushtetutës së Kosovës thuhet "Republika e Kosovës është shtet i të gjithë qytetarëve të saj". Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj duke u bazuar në respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut të qytetarëve të saj dhe të të gjithë individëve të tjerë brenda kufijve të saj. Ndërsa në nenin 2 thuhet: "Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute". Nga neni 2 i Kushtetutës së Kosovës mund të nxirret përfundimi që Kosova është e përcaktuar për sistem të hapur dhe transparent të qeverisjes ndaj qytetarëve të saj.

Më 9 korrik 2013, Qeveria e Kosovës vendosi ta nisë procesin për t'iu bashkuar Nismës OGP (PQH), ndërsa më 19 korrik bëri hapin e parë drejt anëtarësimit në Nismën OGP (PQH) përmes Letrës së Qëllimit në të cilin shprehu interesimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'iu bashkuar Nismës OGP (PQH) të cilën Ministria për Integritet Evropian ia dërgoi sekretarisë së OGP (PQH). Vendimi për nisjen e procesit për t'iu bashkuar nismës OGP (PQH) vjen pas një vargu të proceseve politike në të cilat ka qenë e angazhuar Qeveria e Kosovës. Në dy vjetët e fundit ajo ka qenë e përfshirë në mënyrë intensive në dialogun me Qeverinë e Serbisë të lehtësuar nga BE-ja. Në këtë dialog, i cili filloi në mars 2011, u arritën disa marrëveshje, edhe pse zbatimi i tyre është i diskutueshëm. U arritën marrëveshje për menaxhimin e integruar të kufirit, për lirinë e lëvizjes, përfaqësimin e Kosovës në forumet ndërkombëtare, mbrojtjen e objekteve fetare dhe të trashëgimisë kulturore, pranimin e diplomave universitare, regjistrat civilë dhe vulat doganore. Raundi i dytë i dialogut vazhdoi në nivel të kryeministrave. Kryeministri i Kosovës dhe ai i Serbisë u pajtuan që të fillojë mbledhja e taksave doganore dhe të themelohet një fond për zhvillimin e Kosovës veriore. Më në fund, më 19 prill 2013 dy kryeministrat nënshkruan "Marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve".

² <http://www.opengovpartnership.org/about>

³ Shih Peteri, G (2013). "Monitorimi dhe avokimi për zotimet e partneritetit për sistem të hapur të qeverisjes në Ballkanin Perëndimor: Metodologjia e përgjithshme." f. 3.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës u kritikua për mungesë të transparencës në lidhje me dialogun dhe me marrëveshjet specifike të arritura me qeverinë e Serbisë.

Meqë OGP (PQH) përfshin një varg të gjerë të fushave të qeverisjes së mirë, mbështetja e organizatave të shoqërisë civile gjatë procesit për anëtarësim në OGP (PQH) dhe pas tij është me rëndësi vendimtare. Organi bashkërendues i OGP (PQH) të Kosovës, i udhëhequr nga MIE, ka menduar për këto nevoja dhe për këtë është iniciuar krijimi i grupit të gjerë të aktorëve relevant, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, asociacionet e biznesit dhe institucionet qeveritare⁴. Megjithatë, procesi është në fazën fillestare.

Veprimet dhe intervenimet

Pavarësia e Kosovës daton nga 17 shkurti 2008. Pas shpalljes së pavarësisë Kosova u zotua ta zbatojë Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të hartuar nga i dërguari i posaçëm i Kombeve të Bashkuara Martti Ahtisaari dhe në Kushtetutën e Kosovës u inkorporuan dispozitat e Ahtisaarit. Në fillim pavarësia e Kosovës u mbikëqyr nga bashkësia ndërkombëtare. Grupi ndërkombëtar drejtues i shteteve emëroi një Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (PCN) për ta mbikëqyrur zbatimin e planit nga ana e Kosovës. Mandati i PCN dhe mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës përfunduan në shtator 2012. Përfaqësuesi Special aktual i BE-së në Kosovë është Samuel Zbogar nga Sllovenia, i cili vazhdon t'i japë këshilla Qeverisë së Kosovës lidhur me reformat që nevojiten për të lëvizur më afër anëtarësimin të ardhshëm të mundshëm në BE.

Raporti i Komisionit Evropian (2013) për Kosovën nënvizon që Kosova ka përbushur një grup të prioriteteve afatshkurta të studimit të fizibilitetit të një viti më parë në fushën e sundimit të ligjit, të administratës publike, të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të tregtisë. Komisioni ka rekomanduar hapjen e bisedimeve për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim. Një marrëveshje e tillë është një hap i rëndësishëm për Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së: duke qenë një element kryesor për procesin e zgjerimit, ajo liberalizon tregtinë me BE-në dhe vendos qëllime të përbashkëta politike dhe ekonomike. Procesi i stabilizim dhe asociimit mundet po ashtu ta lehtësojë forcimin e kapaciteteve qeveritare për plotësimin e kritereve që kanë të bëjnë me OGP (PQH).

Anëtarësimi në nismën OGP (PQH) kërkon që vendet t'i plotësojnë së paku 75% të kritereve të caktuara të pranueshmërisë. OGP (PQH) ka caktuar katër kritere⁵.

1. Transparenca fiskale – Publikimi me kohë i dokumenteve themelore buxhetore formon elementet themelore të përgjegjësisë buxhetore dhe të një sistemi të hapur buxhetor.
Vlerësimi: Dy pikë të fituara për publikimin e secilit prej dy dokumenteve themelore (Propozimi i buxhetit nga ekzekutivi dhe raporti i auditimit) për buxhetet e hapura.

4 Intervistë me Fidan Kalanë, bashkë-udhëheqësin e organit bashkërendues të OGP (PQH) Kosovë, gusht 2013.

5 <http://www.opengovpartnership.org/eligibility>

Në rastin e Kosovës, propozimi i buxhetit nga ekzekutivi është i hapur për kontribute dhe diskutime vetëm në Komisionin për Buxhet të Kuvendit të Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës të cilët kanë të drejtë ta rishikojnë dhe ta aprovojnë versionin përfundimtar. Buxheti publikohet sapo të aprovohet por jo si propozim i buxhetit. Sa i përket raportit të auditimit, zyra e auditorit të përgjithshëm i publikon raportet e pjeshme të auditimit për të gjitha institucionet dhe agjencitë shpenzuese, së bashku me raportin vjetor të auditimit në të cilin përfshihet mendimi i auditimit për pasqyrat e konsoliduara financiare të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në janar 2013 Partneriteti Ndërkombëtar Buxhetor (PNB) nxori Studimin e Buxhetit të Hapur 2012 (SBH), vlerësimin e vetëm të pavarur, krahasues dhe të rregullt për transparencën e buxhetit, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien në mbarë botën. SBH 2012 përfshiu 100 vende, duke përfshirë 36 vende anëtare të OGP (PQH) dhe vende të ardhshme anëtare që janë duke i zhvilluar zotimet e tyre⁶. Meqë Kosova nuk është pjesë e studimit, përfshirja e saj në SBH do ta mundësonte një vlerësim krahasues të kriterëve të transparencës fiskale.

2. Qasja në informata – Qasja në ligjin për të drejtën e informimit që garanton të drejtën e publikut për informim dhe qasje në të dhënat e qeverisë është me rëndësi themelore për frymën dhe ushtrimin e qeverisjes.

Vlerësimet e shfrytëzuara në këtë rast: 4 pikë i fitojnë vendet të cilat e kanë ligjin për qasje në informata, 3 pikë nëse një vend ka dispozitë kushtetuese që garanton qasjen në informata dhe 1 pikë nëse një vend është duke e shqyrtuar projektligjin për qasje në informata. Kushtetuta e Kosovës parashikon lirinë e shprehjes, qasjen në informata dhe pluralizmin e mediave. Në nenin 40 të Kushtetutës [Liria e Shprehjes] thuhet: “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.” Më tej thuhet që liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe të provokimit të dhunës dhe të armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Përveç kësaj, Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar Ligjin nr.03/L-215 i cili garanton të drejtën e qasjes në dokumente publike dhe e rregullon të drejtën e qasjes në informata, përkatësisht në dokumente publike.

3. Deklarimet lidhur me zyrtarët e zgjedhur ose të lartë publikë – Rregullat të cilat kërkojnë deklarin publik të të ardhurave dhe të pasurisë për zyrtarët e zgjedhur dhe të lartë publikë janë thelbësore për qeverisje kundër korrupsionit, të hapur dhe të përgjegjshme.

Vlerësimi: vendet, të cilat kanë ligj i cili kërkon deklarin publik për politikanë dhe zyrtarë të lartë publikë, i marrin 4 pikë, 3 pikë ju jepen vendeve që kanë ose ligj që kërkon deklarimet publike për politikanë ose për zyrtarë të lartë publikë dhe 2 pikë jepen për një ligj që kërkon deklarim jopublik për zyrtarët e zgjedhur ose ata të lartë.

⁶ <http://www.opengovpartnership.org/2013/09/open-budgets-key-to-open-government-next-steps-for-ogp-countries/>

Ligji i Kosovës nr. 04/L-050 e rregullon procedurën për deklarimin dhe kontrollimin e pasurisë, deklarimin e të hyrave dhe të obligimeve për të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e tyre të familjes dhe po ashtu i rregullon sanksionet e përkufizuara. Ligji mbi deklarimin, kontrollimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë përcakton me saktësi që secili zyrtar në kohën e marrjes së pozitës së lartë publike duhet ta bëjë deklarimin e pasurisë së tij në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) brenda 30 ditëve. Por ka pasur raste kur zyrtarët e kanë shkelur ligjin në fjalë. Si rrjedhojë, Agjencia ka filluar procedura gjyqësore për kundërvajtje kundër tyre. Ky ligj e rregullon po ashtu edhe procedurën për deklarimin, kontrollimin dhe prejardhjen e dhuratave të marra nga të gjithë zyrtarët publikë. Në Kosovë zyrtarët e lartë publikë (përfshirë pjesëtarët e Kuvendit, të Presidencës dhe të Qeverisë në mes tjerësh) kanë obligim ta bëjnë deklarimin e pasurisë gjatë tërë shërbimit publik dhe sipas kushteve të përkufizuara me ligj dhe ata janë të obliguar ta deklarojnë gjendjen e pasurisë së tyre në AKK prej 1 deri më 31 mars të secilit vit (AKK, 2013).

Angazhimi qytetar

Qeverisja e hapur kërkon të qenit të hapur ndaj pjesëmarrjes dhe angazhimit të qytetarëve në hartimin e politikave dhe në qeverisje, përfshirë mbrojtjet themelore për liritë civile.

Vlerësimi: Duke e shfrytëzuar nën indikatorin e liritë civile të Indeksit të Demokracisë të Njësisë Studimore të Ekonomistit (NJSE) (EIU) ku nota më e lartë është 10 dhe më e ulëta është 0, 4 pikë për vendet që arrijnë më shumë se 7.5, 3 pikë për vendet që kanë më shumë se 5, 2 pikë për vendet që kanë më shumë se 2.5 dhe 0 pikë në rastin e kundërt.

Një vlerësim krahasues i liritë civile në rastin e Kosovës është më kompleks meqë Kosova nuk është pjesë e Indeksit të Demokracisë të EIU (NJSE) i cili shfrytëzohet për vlerësimin e liritë civile. Për arsye se metodologjia e indeksit të EIU (NJSE) nuk është publike, është i pamundur vlerësimi krahasues i angazhimit qytetar. Në mënyrë alternative, sipas indeksit të shoqërisë civile (KCSF, 2011), pjesëmarrja e qytetarëve në jetën publike është tepër e ulët, me vetëm 16.3% qytetarë të Kosovës të cilët janë aktiv në nismat dhe në organizatat shoqërore. Megjithatë, duke e pasur parasysh që të gjitha vendet rajonale kanë arritur rezultat mbi 7 në Indeksin e Demokracisë të EIU (NJSE), dhe duke u bazuar në vlerësimin vetë subjektiv, pritet që Kosova do t'i fitojë së paku edhe 3 pikë duke arritur rezultatin mbi 5 në nën-indikatorin për liritë civile.

Pas një vetëvlerësimi të kritereve të pranueshmërisë të OGP (PQH) të Kosovës, duket që Kosova do t'i fitojë 14 prej 16 pikëve, që është mbi pragun e nevojshëm të pranueshmërisë për t'u bërë anëtar i OGP (PQH).

Veprimet lidhur me këtë që janë realizuar deri më tani:

- Më 09 korrik 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur t'i fillojë procedurat për anëtarësimin e Kosovës në OGP (PQH).
- Më 19 korrik 2013, Ministria për Integritet Evropian e ka dërguar një Letër të Qëllimit në të cilën ka shprehur interesimin e Qeverisë së Kosovës që të bëhet anëtare e Nismës OGP (PQH).
- Ministria për Integritet Evropian ka mandatin ta krijojë një grup punues i cili do të udhëhiqet nga një përfaqësues i ministrisë dhe nga një përfaqësues i Lëvizjes FOL (organizatë e shoqërisë civile). Vendimi thërret për krijimin e një grupi punues gjithëpërfshirës, përfshirë përfaqësuesit përkatës të shoqërisë civile, qeverisë dhe aktorë të tjerë relevant.
- Plani i Veprimit i OGP (PQH) të Kosovës është planifikuar të hartohet deri në mars 2014.
- Qeveria e Kosovës po ashtu ka ndërmarrë hapa të cilët janë në funksion të standardeve OGP (PQH) dhe siç duket nga vetë-vlerësimi i kritereve të pranueshmërisë, Kosova është e pranueshme për t'u bërë anëtare e re e OGP (PQH).
- Aktualisht, Kosova është duke e zbatuar strategjinë e e-qeverisjes e cila është e bashkërenduar nga departamenti i Teknologjisë Informative në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.
- Qeveria e Kosovës ka krijuar një portal kryesor elektronik ku qytetarët, bizneset dhe palët e tjera të interesuara mund t'i gjejnë informatat më relevante për shërbimet publike, administratën publike. Të gjitha kredencialet e shfrytëzuesve janë të mbrojtura në pajtueshmëri me të gjitha standardet e sigurisë për shërbimet online⁷.
- Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me CIVIKOS, e ka hartuar strategjinë qeveritare për bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovës për periudhën 2013-2017, e cila ka për qëllim përmirësimin e procesit të konsultimeve dhe të bashkëpunimit.
- Komisioni i BE-së (2013) ka rekomanduar hapjen e bisedimeve për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim (MSA). Procesi MSA mundet po ashtu ta lehtësojë forcimin e kapaciteteve qeveritare për t'i plotësuar kriteret lidhur me OGP (PQH).
- Pjesa më e madhe e ligjeve të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës janë në harmoni me legjislacionin e BE-së. Ligjet përkatëse lidhur me kriteret OGP (PQH), siç është Ligji për deklarimin e pasurisë dhe Ligji për qasje në dokumente publike, janë në fuqi. Rishtazi Kosova ka aprovuar Ligjin për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, zbatimi i duhur i tij është një sfidë serioze.

⁷ Për hollësitë dhe shërbimet që ofrohen shih <https://www.rks-gov.net/en-US/Pages/Fillimi.aspx>

Veprimet fillestare të propozuara:

- Anëtarësimi në Nismën OGP (PQH) do ta rrisë integritetin publik të Qeverisë së Kosovës dhe do ta shtojë OGP (PQH) në listën e organizatave ndërkombëtare anëtare e të cilave është Kosova.
- Në mënyrë që t'i tejkalojë kufizimet lidhur me kapacitetet qeveritare për përgatitjen e një plani të veprimit OGP (PQH), duhet të zhvillohet një proces i gjerë konsultativ në të cilin përfshihen institucionet qeveritare, shoqëria civile, përfaqësuesit akademikë dhe afaristë. Qeveria e Kosovës duket që është e gatshme të ketë një përfshirje të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe të institucioneve të tjera të lidhura me to në këtë proces.
- Meqë procesi i është caktuar Ministrisë për Integritim Evropian, ministres duhet t'i jepet përgjegjësia për ta siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për të gjitha grupet e interesit në procesin OGP (PQH). Autoriteti i ministres mund të shërbejë si mekanizëm lehtësues për ndërtimin e kapaciteteve dhe për bashkërendimin e të gjitha institucioneve relevante në zbatimin e qasjes së qeverisjes së hapur. Kjo do të jetë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve, transparencës, integritetit publik, menaxhimit të pasurisë publike, komuniteteve më të sigurta dhe përmirësimit të qeverisjes së korporatave.
- Përfshirja e Kosovës në SBH do ta mundësonte vlerësimin krahasues të kriterëve të transparencës fiskale dhe prandaj duhet të jetë njëri prej aktiviteteve të para në mënyrë që t'i përshtatë të dhënat që do ta bëjnë hapjen e politikës fiskale të Kosovës më të krahasueshme me vendet e tjera. Në këtë kontekst, publikimi i Propozimit të Buxhetit të Ekzekutivit duhet të jetë hapi i parë për ta treguar përkushtimin e qeverisë ndaj standardeve të qeverisjes së hapur.

Institucionet juridike dhe administrative

Departamenti i Teknologjisë Informative në Ministrinë e Administratës Publike, në bashkëpunim me UNDP, ka hartuar "Strategjinë për Qeverisjen Elektronike 2009-2015" të Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimeve të institucioneve qeveritare për qytetarët, bizneset dhe kategoritë e tjera përmes teknologjisë informative dhe të komunikimit (siç është WAN, Interneti, rrjeti i telefonisë mobile). Plani i Veprimit paraqet procesin e zhvillimit të shërbimeve elektronike të bazuar në bazë ligjore dhe në pajtueshmëri me infrastrukturën e TIK. "Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Qeverisjen Elektronike 2009-2015" i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga faja e internetit të Ministrisë së Administratës Publike.

Trajnimi i personelit aktual dhe angazhimi i kapaciteteve të nevojshme shihet si rrezik i madh për zbatimin e strategjisë të qeverisjes elektronike. Përveç kësaj, ndryshimi i ligjeve

të nevojshme dhe zbatimi i shërbimeve elektronike do të përfshijë kufizime të mëtejshme në buxhet. Në mes tjerash, një prej gjërave të rëndësishme që nuk është përfshirë në planin e veprimit është vonesa në zbatimin e e-prokurimit. Sipas planit të veprimit, e-prokurimi është dashur të zbatohet më 2011, por deri më tani nuk është zbatuar.

Ligjet kryesore dhe urdhëresat administrative lidhur me kriteret OGP (PQH) janë në fuqi. Qasja në dokumente publike garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Neni 41 i kushtetutës thotë: “Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”.

Sa i përket transparencës dhe qasjes së e-qeverisjes, urdhëresa administrative nr. 7/2008 e Ministrisë së Administratës Publike thotë që të gjithat institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës janë të obliguara t’i krijojnë faqet e veta të internetit ose t’i përmirësojnë ato ekzistueset, në mënyrë që ta rrisin transparencën. Kosova po ashtu ka aprovuar Ligjin nr.03/L-215 mbi qasjen në dokumentet publike. Neni 1 i Ligjit thotë: “Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.” Kërkesa për qasje në dokumente publike mund të bëhet në cilëndo formë që do ta mundësojë identifikimin e dokumentit nga institucionet dhe kërkuesit nuk janë të obliguar ta arsyetojnë nevojën e tyre për qasje në dokumente. Sipas Ligjit, institucionet janë të obliguara t’i përgjigjen kërkesës për qasje në dokumente publike brenda 7 ditëve. Në rast të refuzimit të kërkesave, Ligji parashikon një proces të ankesës tek Avokati i Popullit, në gjykatat kompetente ose në institucionet e tjera përkatëse. Institucionet qendrore dhe lokale si edhe institucionet e pavarura i kanë caktuar zyrtarët që merren me kërkesat e tilla.

Sipas nenit 12 të Ligjit secili kërkues ka të drejtë të ketë qasje në dokumentet publike. Kufizimi i kësaj të drejte do të ushtrohet në mënyrë proporcionale dhe vetëm me qëllim të ruajtjes së: sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; sigurisë publike; parandalimit, zbulimit dhe hetimit të aktiviteteve kriminale; hetimeve disiplinore; inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike; intimitetit dhe interesave të tjera private të arsyeshme; interesave komerciale apo interesave të tjera ekonomike; politikave ekonomike, monetare dhe të këmbimit; barazisë së palëve në procedurën gjyqësore dhe në administrimin efikas të drejtësisë; dhe çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin.

Sa i përket garantimit të përgjegjësisë lidhur me të drejtën për të pasur qasje në dokumentet publike, neni 17 të Ligjit për qasje në dokumentet publike – Avokati i popullit është institucion i pavarur i cili ju ndihmon qytetarëve dhe aktorëve të tjerë relevantë të kenë qasje në dokumentet publike të cilat ju refuzohen atyre. Përveç kësaj, në nenin 20 të ligjit thuhet që çdo institucion publik publikon një raport vjetor për vitin paraprak, përfshirë numrin e rasteve në të cilat autoriteti publik ka lejuar qasje, si edhe rastet në të cilat autoriteti publik nuk e ka lejuar qasjen në dokumente, si edhe arsyet për moslejimin e tillë.

Numri i kërkesave për qasje në dokumentet publike është i kufizuar (Raporti gjithëpërfshirës, 2012). Në nivel të institucioneve qendrore, gjatë vitit 2012 janë bërë mbi 600 kërkesa për qasje në dokumente të institucioneve publike prej të cilave në 80% të rasteve është lejuar qasja në dokumente. Rreth 49% e kërkesave kanë ardhur nga gazetarët ndërsa vetëm 9% nga shoqëria civile. Kërkesat e tjera i kanë bërë individët, organizatat buxhetore dhe aktorët e tjerë të interesuar. Në nivel komunash, për rreth 590 kërkesa të bëra është lejuar qasja në dokumentet publike në rreth 80% të rasteve, ndërsa kërkesat e tjera janë refuzuar ose qasja ishte e kufizuar. Për dallim nga niveli qendror, në nivelin komunal rreth 44% të kërkesave janë bërë nga organizatat e shoqërisë civile. Në anën tjetër, raportet e organizatave të pavarura paraqesin një shkallë shumë më të ulët të përgjigjeve pozitive nga institucionet publike.

Njëra prej dobësive duket të jetë mungesa e informatave për mundësinë e qasjes në dokumente publike dhe sqarimi kush mund ta bëjë kërkesën dhe si duhet të shkruhet ajo. Zyra e kryeministrit ka publikuar po ashtu një listë të të gjithë zyrtarëve publikë të cilët janë përgjegjës për lejimin e qasjes në dokumentet publike në secilin institucion.⁸

Përfshirja e elementeve shumetnike në planet e veprimit

Kosova nuk ka plan të veprimit për plotësimin e standardeve OGP (PQH) por elementet shumetnike janë pjesë e pothuajse çdo strategjie dhe të drejtat specifike për komunitetet janë të siguruara me Kushtetutën e Kosovës që rrjedhë nga Plani Ahtisari, i cili ka vënë bazën për pavarësinë e Kosovës.

Në nenin 57 të Kushtetutës së Kosovës thuhet: “Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute”. Të drejtat specifike të komuniteteve kanë të bëjnë me: gjuhën, kulturën, fenë, arsimin, përfaqësimin e garantuar në institucionet publike dhe me të drejtat e tjera relevante. Ndërsa neni 60 i Kushtetutës së Kosovës përkufizon themelimin e këshillit konsultativ për komunitete si: “ Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet”. Sa i përket fesë, neni 8 i Kushtetutës së Kosovës thotë: “Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare”. Sa i përket përfshirjes së komuniteteve në institucionet e Kosovës, ekziston Ministria për Komunitete dhe Kthim të cilën e udhëheq një ministër serb i Kosovës si pjesë e koalicionit qeveritar.

Problemi kryesor i qeverisë së Kosovës në raport me pakicat në Kosovë është në komunat veriore të Kosovës të populluara kryesisht me serbë të Kosovës. Popullsia në këtë rajon nuk është pajtuar me institucionet dhe me Qeverinë e Kosovës, ndërsa qeveria serbe ka vazh-

⁸ Shih Raporti Gjithëpërfshirës (2012). Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, raporti gjithëpërfshirës për të drejtën për të pasur qasje në dokumentet publike nga institucionet publike.

duar t'i financojë institucionet paralele të cilat janë funksionale në 14 vjetët e fundit.

Marrëveshja e fundit ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë ka për qëllim integrimin e institucioneve të serbëve të Kosovës në komunat veriore në sistemin legjislativ të Kosovës duke ua dhënë disa të drejta shtesë të qeverisjes lokale, siç është themelimi i Asociacionit të komunave të serbëve të Kosovës në veri të Kosovës. Asociacionit të propozuar rishtazi i janë dhënë kompetenca shtesë të qeverisjes lokale siç është propozimi për komandantin rajonal për komunat në rajonin e veriut të Kosovës. Është arritur pajtimi që një njësi e Gjykatës së Apelit të Kosovës të themelohet në veri të Kosovës po ashtu. Kjo njësi e gjykatës do t'i adresojë çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin serb të Kosovës. Kështu që, deri më tani ende nuk është arritur një pajtim për planin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Përveç sistemit juridik lidhur me aspektet shumetnike, ekzistojnë disa fusha të tjera ku do të nevojitej transparencë më e madhe për ta pasur një tablo më të qartë për përmbushjen e shërbimeve, nivelin dhe burimet e financimit të shërbimeve publike, etj. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile të serbëve të Kosovës nga të gjithat komunat e serbëve të Kosovës në grupin punues OGP (PQH) të Kosovës është vendimtare në mënyrë që të mundësohet përfshirja e përgjithshme dhe adresimi i çështjeve përkatëse të qeverisjes lokale të këtyre komunave në planin e ardhshëm të veprimit të OGP (PQH) të Kosovës.

Analiza e aktorëve

Nisma OGP (PQH) kërkon pjesëmarrje të gjerë të institucioneve qeveritare, të shoqërisë civile dhe të organizatave të biznesit për ta përgatitur planin e veprimit. Meqë hartimi i një plani të veprimit do të jetë hapi i menjëhershëm pas aprovimit të Deklaratës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur nga ana e Qeverisë së Kosovës, me interes vendimtar është bashkërendimi ndërmjet të gjithë aktorëve në proces në mënyrë që të hartohet një plan gjithëpërfshirës dhe real që i adreson të gjitha çështjet e nevojshme.

Sa ju përket institucioneve të Qeverisë së Kosovës, Ministria për Integritet Evropian është institucioni kryesor për procesin OGP (PQH) meqë ajo është caktuar për ta bërë bashkërendimin e procesit të anëtarësimit të OGP (PQH) të Kosovës. Roli i saj në bashkëpunimin dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile ishte evident po ashtu në Task Forcën për Integrimin Evropian. Ministrinë e tjera që kanë të bëjnë me këtë siç është Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave pritet të jenë aktorët kryesorë në procesin e anëtarësimit OGP (PQH) pasi që ato janë drejtpërdrejt të lidhura me kërkesat OGP (PQH). Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për zbatimin e strategjisë së e-qeverisjes i cili është një element shumë i rëndësishëm i qasjes së qeverisjes së hapur; prandaj pritet që roli i saj të jetë i rëndësishëm dhe pozitiv. Roli i Ministrisë së Financave është kryesor sa i përket rritjes së transparencës fiskale.

Sa ju përket agjencive të pavarura qeveritare dhe komisioneve parlamentare të Kosovës, ato janë institucione shumë të rëndësishme për garantimin e llogaridhënies së qeverisë dhe transparencë të shtuar, kështu që pritet që roli i tyre të jetë pozitiv ndaj rritjes së transparencës. Kështu që, përderisa pritet që agjencitë e pavarura t'i mbështesin qëllimet e lidhura me OGP (PQH), roli i komisioneve parlamentare është i dykuptueshëm. Përbërja e komisioneve parlamentare mund të ndikojë në drejtimin e ndikimit të çështjeve të lidhura me OGP (PQH) nga komisionet përkatëse. Ndërsa anëtarët e partive politike në qeveri mund ta përkrahin më pak procesin për shkak të implikimeve të mundshme që aktivitetet lidhur me OGP (PQH) mund të kenë në grupet e tyre të interesit, ndërsa nga anëtarët e partive politike opozitare në Kosovë do të pritej të vepronin në drejtimin pozitiv. Ata mund të kenë ndikim në qeverisje drejt transparencës dhe llogaridhënies më të madhe, kështu që ata janë aktorë shumë të rëndësishëm, sidomos në procesin e monitorimit të progresit të veprimeve OGP (PQH) të marra përsipër nga qeveria.

Përveç institucioneve publike dhe të pavarura përgjegjëse për përmirësimin dhe zbatimin e transparencës dhe të instrumenteve të qeverisjes së mirë, nga organizatat e shoqërisë civile në Kosovë pritet që të avokojnë dhe ta shtojnë vetëdijësimin e institucioneve lidhur me rëndësinë e OGP (PQH) dhe të vepronë në partneritet për ta përgatitur një plan të veprimit. Disa OSHC kanë bërë përvujtë të konsiderueshme dhe bazë të njohurisë në lidhje me fushat e përfshira nga OGP (PQH). Lëvizja FOL është e angazhuar në promovimin e OGP (PQH) në Kosovë dhe aktualisht është duke punuar në terren. Përfaqësuesi i saj është propozuar të jetë koordinator i përbashkët i procesit OGP (PQH) nga Qeveria e Kosovës. Organizatat tjera të shoqërisë civile me përvujtë të gjerë në kërkimin e politikave dhe në avokimin për qeverisje të hapur dhe transparente janë Instituti Demokratik i Kosovës (IDK), Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe Instituti për Studime të Avancuara (GAP), në mes tjerash. Pritet që CIVIKOS po ashtu të luajë një rol të rëndësishëm në bashkërendimin e OSHC-ve në procesin e avokimit dhe të monitorimit të OGP (PQH). Është shumë me rëndësi përfshirja e OSHC-ve të cilat i përfaqësojnë pakicat e Kosovës. Kjo do t'i shtojë mundësitë e njohurive kur të adresohen problemet në komunitat të banuara kryesisht me pakica. Në mesin e organizatave të tjera të sipërpërmendura, pritet që Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) të veprojë si aktori kryesor mbështetës për procesin OGP (PQH) sa i përket koordinimit dhe mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile të përfshira në përgatitjen e planit të veprimit OGP (PQH) dhe në monitorimin e rezultateve të veprimeve të planifikuara.

Aktorët e tjerë relevantë në procesin e avokimit janë shoqatat e biznesit për shkak të përvujtës së tyre të gjerë në promovimin e politikave lidhur me biznesin në një qasje të qeverisjes së hapur dhe transparente. Në këtë aspekt politikave të prokurimit publik dhe qasja në të dhëna të hapura janë me rëndësi vendimtare. E-prokurimi do të ishte hapi tjetër progresiv në avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Shërbimet tjera të të dhënave të hapura do ta lehtësojnë bërjen e biznesit në Kosovë dhe do ta rrisin transparencën dhe konkurrencën e lirë. Në mesin e aktorëve të lidhur me biznesin, asociacionet e biznesit më me ndikim, të cilat do ta fuqizojnë procesin e avokimit për OGP (PQH), janë Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, Aleanca Kosovare e Biznesit dhe Oda Ekonomike Gjermane. Përfshirja e pakicave në këtë proces është me rëndësi vendimtare. Edhe pse të gjitha pakicat janë të përfaqësuara mjaft në Asociacionet e Biznesit të Kosovës, përfshirja e asociacionit të biznesit të serbëve të Kosovës do ta rrisë nivelin e pjesëmarrjes të komunitetit serb të Kosovës. Në përgjithësi, është i domosdoshëm një

SFIDAT E MËDHA TË PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR

bashkërendim i afërt i të gjitha organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve qeveritarë, organeve të pavarura dhe aktorëve të tjerë përkatës në mënyrë që të përgatitet një plan i veprimit gjithëpërfshirës që do t'i mbulojë të gjitha fushat e Nismës OGP (PQH)

Për t'u bërë anëtare të OGP (PQH), vendet pjesëmarrëse duhet ta aprovojnë një Deklaratë të nivelit të lartë për Qeverisje të Hapur; ta paraqesin planin e veprimit të zhvilluar me konsultime publike; dhe ta marrin përsipër raportimin e pavarur për përparimin e tyre për të ecur përpara. Nevojitet udhëheqje politike. Nevojitet njohuri teknike. Nevojitet përpjekje e pandërprerë dhe investim. Nevojitet bashkëpunimi ndërmjet qeverive dhe shoqërisë civile⁹. Nga Qeveria e Kosovës pritet që ta aprovojë zotimin e nivelit të lartë të Deklaratës për Qeverisje të Hapur dhe ta përgatis një plan të veprimit në konsultim të përbashkët me shoqërinë civile dhe me aktorët e tjerë relevantë.

Pesë "sfidat e mëdha" me të cilat përballet qeveria dhe të cilat përbëjnë qendrën e zotimeve të Partneritetit për Qeverisje të Hapur janë: 1) përmirësimi i shërbimeve publike; 2) rritja e integritetit publik; 3) menaxhimi më efektiv i resurseve publike; 4) krijimi i komuniteteve më të sigurta dhe 5) rritja e llogaridhënies së korporatave. Metodologjia e aplikuar përbëhet nga elementet e kornizës së llogaridhënies të saktësuara nga deklarata OGP (PQH) (Peteri, 2013). Përqendrimi është më i madh në qeverinë si institucion i identifikueshëm dhe më pak në qeverisje, i cili është koncept i orientuar ndaj procesit dhe veprimit të menaxhimit të çështjeve publike. Parimet kryesore të qeverisjes së hapur janë, si në vijim: 1) transparenca; 2) pjesëmarrja e qytetarëve 3) llogaridhënia dhe 4) teknologjia dhe inovacioni. Këto zotime mund të zhvillohen në përpjekjet ekzistuese, t'i identifikojnë hapat e ri për përfundimin e reformave që janë në vazhdim e sipër ose ta nisin veprimin në një fushë plotësisht të re¹⁰.

PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në këtë pjesë flitet për shërbimet publike në Kosovë nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur. Administrata publike, agjencitë e shërbimeve publike dhe të gjitha shërbimet relevante publike janë në domenin e ndikimit të qeverisë dhe të qasjes së saj qeverisëse. Arsimiti, kujdesi shëndetësor, çështjet e mjedisit, mjedisi i biznesit dhe shërbimet e tjera administrative janë thelbi i kësaj analize. Informacionet e hapura dhe transparenca janë aspektet kryesore të cilat sigurojnë qeverisje më të mirë. Në mënyrë që të ketë zbatim teknik të kriterit të të qenit të hapur duhet të ekzistojnë ligjet e përshtatshme. Më tej, kjo pjesë analizon qeverisjen e hapur në administratën publike dhe në sektorin e shërbimeve publike si njëri prej pesë fushave OGP (PQH), në aspektin e transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes publike dhe inovacionit.

9 Shih faqen e internetit të OGP (PQH) www.opengovernmentpartners.org

10 Faqja e internetit e OGP (PQH) www.opengovernmentpartners.org

Transparenca

Shërbimet personale të bazuara në meritë dhe infrastruktura: Transparenca në shërbimet publike do t'ua mundësojë qytetarëve të Kosovës të kenë qasje të lirë edhe në administratën publike edhe në informatat që kanë të bëjnë me personelin civil dhe qasje në shërbimet që burojnë nga to dhe nga organizatat shërbyese. Në këtë aspekt, një regjistër i plotë dhe i hapur i organizatave shërbyese mund ta mbështes ndonjë monitorim të ardhshëm.

Qeveria e Kosovës gradualisht është duke e zhvilluar një qasje të informacioneve të hapura. Ajo ka vendosur një e-portal i cili shërben si qendër kontaktuese e informatave për qytetarët dhe bizneset. Përmes këtij e-portali janë regjistruar organizatat shërbyese dhe janë ofruar informata të përgjithshme. Megjithatë, informacionet e dhëna në portal janë të natyrës përshtues, siç janë të dhënat për ligjet përkatëse, institucionet dhe agjencitë e tjera përkatëse të krijuara në Kosovë. Informatat kryesore të cilat mund të nxirren nga e-portali janë: informatat për llojet e ndihmës sociale që jepen nga institucionet, informatat për procedurat dhe dokumentet që ju nevojiten qytetarëve për ta zgjidhur statusin e tyre civil, informatat lidhur me përkujdesjen shëndetësore, informatat që kanë të bëjnë me punën, biznesin dhe informatat e tjera përkatëse siç është qasja në dokumentet publike, siguria, liria e lëvizjes, etj. Përveç kësaj, përmes e-portalit të qeverisë, qytetarët mund të kenë qasje në faqet e internetit të komunave, informata lidhur me zhvillimin lokal dhe informata të tjera lidhur me faqet individuale të internetit të agjencive shërbyese.

Mekanizmat e bashkërendimit të politikave dhe pronësia nga qeveria rishtazi janë përmirësuar përmes masave të ndryshme: themelimi i Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS), përfshirja e dispozitave lidhur me planifikimin strategjik në Rregulloren e re të Punës së Qeverisë 2011, vlerësimi aktual i strategjive sektoriale që i është proceduar qeverisë nga ZPS, themelimi i departamenteve për integritet në BE dhe bashkërendimi i politikave në ministritë e linjës, sqarimi i procedurave dhe i standardeve për zhvillimin e strategjive dhe të politikave (Programi Vjetor i BE-së, 2013). Aktualisht Ministria për Integritet Evropian është duke e kryer bashkërendimin e politikave dhe funksionet bashkërenduese të ndihmës së jashtme, duke e siguruar një qarkullim të informatave dhe bashkërendim më të mirë.

Sa ju përket procedurave për lëshimin e autorizimeve dhe lejeve, qytetarët, bizneset dhe palët e tjera të interesuara mund të kenë qasje në këto informata online përmes e-portalit të Qeverisë së Kosovës dhe faqeve individuale të internetit të ministrive dhe të institucioneve përkatëse, por aplikimi online nuk është në dispozicion. Qasja në planet e aprovuara, siç janë planet rregulluese dhe ato hapësinore, etj., është shumë e kufizuar meqë institucionet i publikojnë vetëm informatat e përgjithshme. Një shembull është Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e cila publikon vetëm informata të përgjithshme për projektet që janë në vazhdim e sipër, siç është shuma e plotë e projektit, afati i përfundimit të projektit dhe kryerja aktuale e punës gjëra që nuk janë shumë informuese për qytetarët.

Më 2011 Kuvendi i Kosovës aprovoi tri ligje lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e

përafërta, Ligji për markat tregtare nr. 04/L-026, Ligji për patenta nr. 04/L-029 dhe Ligji për dizajnin industrial nr. 04/L-028. Zyra për pronë industriale është një institucion që merret me aktivitetin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronës industriale. Zyra zbaton procedurat për mbrojtjen dhe regjistrimin e të drejtave në pajtim me Ligjin nr. 2004/49 mbi patentat, Ligjin nr. 02/L-100 mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për patenta nr. 2004/49”, dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 2007/06 mbi organizimin dhe funksionimin e Zyrës për pronë industriale. Përveç kësaj, Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta është një organ administrativ i themeluar nën Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Formularët e aplikimit për regjistrimin e patentave, markave tregtare dhe dizajneve industriale dhe udhëzimet për plotësimin e këtyre aplikacioneve mund të gjenden në faqen e MTI-së¹¹. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve, në vitin 2012 MTI ka themeluar departamentin për mbrojtjen e konsumatorëve. Konsumatorët mund ta raportojnë çdo shkelje duke telefonuar pa pagesë në numrin e telefonit të dhënë në faqen e internetit të MTI-së. Në faqen e internetit të MTI-së është redaktuar dhe botuar një fletushkë informuese si informatë për konsumatorët.

Në lidhje me qasjen në informatat financiare, institucionet qendrore dhe komunale i publikojnë buxhetet e tyre të aprovuara në faqet e tyre të internetit, edhe pse kjo mund të mos ndodhë në të gjitha komunitat. Po ashtu publikohen edhe informatat për donatorët e projekteve specifike. Është themeluar një platformë online për menaxhimin e ndihmës. Zotimet dhe shumat aktuale të paguara nga donatorët për komunë mund të nxirren përmes kësaj platforme. Ndërsa, raportet e auditimit të organizatave publike shërbyese publikohen nga zyra e auditorit të përgjithshëm në faqen e saj të internetit. Për shërbimet të cilat kontrahohen me një kontraktues privat, sipas ligjit të prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) publikon vetëm fituesin dhe çmimin e kontratës së shërbimit. KRRPP është përgjegjës për vendosjen e rregullave të hollësishme zbatuese të Ligjit për prokurim publik dhe është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik të Kosovës (Riinvest, 2012). Nuk bëhet publike e tërë marrëveshja ndërmjet organizatës shërbyese dhe klientit, qeverisë. Qasja në këto kontrata mund të arrihet pasi që të bëhet një kërkesë zyrtare për qasje në dokumentet publike por në shumë raste nuk ia kanë dalë të sigurojnë një qasje të tillë.

Rregullat për qasje në dokumentet publike përcaktohen gjerësisht, kështu që në shumë raste qeveria mund të argumentojë që ka të drejtë ligjore t’i fshehë informatat e ndjeshme nga publiku. Në disa raste autoritetet ua kanë mohuar gazetarëve qasjen në dokumente publike (për shembull, në lidhje me kontratën për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Tiranë (BTI, 2012). Sipas Fidan Kalasë, ka nevojë që të ketë një proces të standardizuar për qasje në dokumentet publike në mënyrë që të shmangen justifikimet e paarsyeshme që jepen nga zyrtarët publikë kur refuzohet qasja në informacione¹². Sipas raportit të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, janë plotësuar rreth 80% e

11 Shih <http://www.mti-ks.org/?cid=1,381>

12 Intervistë me Fidan Kalaja, prill, 2013.

kërkesave për qasje në dokumentet publike (Raporti gjithëpërfshirës, 2012). Në anën tjetër, sipas raportit të BIRN-it (2013), vetëm 100 prej 300 kërkesave të bëra në institucionet zyrtare qeveritare për qasje në dokumentet publike kanë marrë përgjigje pozitive ndërmjet janarit 2012 dhe majit 2013. Ndërsa institucionet publike nuk duket se reagojnë plotësisht lidhur me kërkesat për qasje në dokumentet publike, rezultatet e sondazhit të opinionit (shih pjesën IV) tregojnë që afërsisht 77 % e të anketuarve pajtohen që të gjitha informatat financiare, të përmbushjes dhe ato teknike lidhur me kontratat e financuara nga qeveria duhet të bëhen publike (Riinvest, 2013).

Përveç agjencive rregullative, organizatat e shoqërisë civile janë duke e luajtur një rol të rëndësishëm në Kosovë në vlerësimin e përmbushjes së shërbimeve të organizatave publike shërbyese dhe të institucioneve relevante në Kosovë. Me kalimin e viteve është rritur kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes së organizatave shërbyese. Për ta rritur transparencën në sistemin e arsimit, Agjencia për Akreditim e Kosovës publikon të gjitha raportet e akreditimit të institucioneve arsimore private dhe publike në faqen e saj të internetit. Agjencia më tej mund ta forcojë transparencën duke mbledhur dhe publikuar statistika lidhur me numrin e studentëve të cilët vijnë në universitetet publike dhe private si edhe përmbushjen e këtyre institucioneve. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e publikon raportin vjetor për përmbushjen e arsimit në nivelin fillor dhe të mesëm. Përveç raportit vjetor të përbërë nga statistikat e grumbulluara për numrin e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, të dhënat veç e veç nuk janë në dispozicion publikisht. Të dhënat lidhur me personelin që punon në shkolla, kualifikimet dhe përvoja e tyre dhe përmbushja e shkollës e vlerësuar me përmbushjen vjetore do ta shtonte transparencën dhe në anën tjetër do ta rriste llogaridhënien.¹³ Ndërsa, në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë i publikon të gjitha ligjet dhe raportet përkatëse në faqen e internetit por informatat duket se nuk janë të përditësuara. Raporti i fundit i inspektimit, i cili është publikuar në faqen e internetit, është i vitit 2009. Skema organizative dhe informatat për stafin drejtues në Ministrinë e Shëndetësisë publikohen në faqen e internetit po ashtu¹⁴. Megjithatë, çmimet dhe informatat tjera relevante të ofruesve individualë të kujdesit shëndetësor nuk bëhen publike në e-portal por në përgjithësi ofrohen në nivel të institucioneve shëndetësore.

Çështjet mjedisore trajtohen me Ligjin e Kosovës për vlerësimin e ndikimit në mjedis i cili është aprovuar më 2010. Në lidhje me transparencën, përveç raporteve të përgjithshme të publikuara nga Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës, në faqet e internetit të institucioneve relevante nuk ka qasje në të dhënat për emetimet nga shërbimet e ndryshme komunale dhe kompanitë private të cilat mund të ndikojnë në ndotjen e mjedisit ose në çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mjedisin. Sa ju përket lejeve të ndërtimit dhe taksave relevante, MMPH publikon në faqen e saj informatat për taksat për ndërtim sipas komunës.

Administrata publike: Administrata publike e Kosovës karakterizohet me planifikim dhe politikbërje të shkëputur në nivel qeveritar dhe ministror. Shpesh planet zhvillohen në

13 Shih MASHT për raportet vjetore

14 Shih faqen e MASHT

mënyrë ad hoc duke reaguar ndaj momentit dhe/ose jo ndaj nevojave të shprehura kryesisht nga bashkësia ndërkombëtare (Programi vjetor i BE-së, 2013). Ligji për shërbimin civil hyri në fuqi më 9 korrik 2010. Është me rëndësi meqë përcakton cilët zyrtarë publikë konsiderohen “nëpunës civilë” dhe i rregullon kushtet e punësimit të tyre. Sipas raportit të OSBE-së (2012), Ligji i Kosovës për shërbimin civil parashikon një sistem të emërimit dhe të gradimit në bazë të meritave dhe krijon bazën juridike për diversitetin e shërbimit civil. Në të njëjtin raport thuhet që ministritë e Qeverisë së Kosovës kanë nxjerrë konkurse për punë që kanë pasur për qëllim inkurajimin e aplikimit të komuniteteve, ndërsa vendet e lira të punës kanë publikuar në mënyrë konsekuente në dy gjuhët zyrtare në mediat e shtypura dhe në faqet zyrtare të internetit. Në nivel komunal, 28 prej 29 komunave të vlerësuara i kanë shpallur vendet e lira të punës në të dy gjuhët zyrtare në mediat e shtypura, në faqet zyrtare të internetit dhe shpesh përmes radio stacioneve lokale. Sidoqoftë, procesi i rekrutimit është njëra prej çështjeve më kontestuese në sektorin publik i cili në përgjithësi lidhet me nepotizëm. Transparenca e kontratave afatshkurta është vendimtare. Vendet e punës për periudhë të shkurtë në arsim, në veçanti në shkollat fillore dhe të mesme zakonisht nuk bëhen publike, kështu që në shumicën e rasteve kandidatët e interesuar duhet të kenë dikë brenda në mënyrë që të informohen për një vend të lirë pune për afat të shkurtë.

Informatat për institucionet dhe struktura e tyre organizative publikohen në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Emrat e zyrtarëve të lartë në institucionet publike bëhen publik. Pagat e zyrtarëve publikë publikohen po ashtu meqë zyrtarët publikë janë të obliguar t’i deklarojnë të ardhurat dhe pasurinë e tyre. Ndërsa, pagat e zyrtarëve të tjerë publikë dihen publikisht bazuar në pozitat dhe koeficientet relevante të gradave që i kanë. Numri i të punësuarve dhe struktura organizative raportohen nga kompanitë publike në raportet e tyre vjetore.

Edhe pse të gjitha institucionet dorëzojnë raporte tremujore në Ministrinë e Administratës Publike (MAP), duke dhënë hollësi lidhur me numrin e nëpunësve civilë të punësuar (të ndarë sipas komunitetit, gjinisë dhe kualifikimeve), vetëm disa prej tyre kanë të dhëna të sakta për komunitetin e kandidatëve (OSBE, 2012). Në pothuajse të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal, numri i pozitave të parashikuara me ligj është më i madh se sa numri i të punësuarve aktualë¹⁵. Ky është tregues që administratës publike të Kosovës i mungojnë kapacitetet, ndërsa pritet që gjatë vitit 2013 të bëhet një vlerësim formal i kapaciteteve të administratës publike¹⁶.

Një faktor problematik në administratën shtetërore mbetet ekzistimi i strukturave paralele të Serbisë, kryesisht në veri. Këto i përfshijnë sistemet paralele të shëndetësisë dhe të arsimimit përkrah administratës shtetërore të Serbisë. Në zonat tjera serbe ky fenomen është zvogëluar si pjesë e procesit të decentralizimit të vendit. (BTI, 2012)

Siguria dhe mbrojtja: KFOR-i, forca paqeruajtëse në Kosovë e udhëhequr nga NATO, ka rolin e garantimit të sigurisë së përgjithshme të Kosovës, duke ua lënë detyrat e policimit

15 Shih përgjigjet e dhëna në pyetësorin për procesin e stabilizimit dhe asociimit, Ministria për Integritet

16 Intervista me sekretarin e përhershëm të Ministrisë për Integritet Evropiane (2013)

autoriteteve lokale dhe EULEX-it. KFOR-i po ashtu luan rol udhëheqës në mbikëqyrjen e trajnimit të 2,500 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) të kërkuar me planin Ahtisaari. NATO dhe Shtetet e Bashkuara janë duke i ofruar ndihmë dhe trajnim FSK-së e cila posedon armë të vogla por nuk ka armë të rënda siç është artileria dhe tanket.

Aktualisht forcat policore të Kosovës nuk janë duke shërbyer në komunat veriore të Kosovës të cilat janë të banuara me serbë të Kosovës. Sa i përket transparencës, Policia e Kosovës publikon raportin vjetor me statistika të hollësishme siç janë rastet e krimeve, arrestimet, aksidentet dhe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me policinë¹⁷. Zinxhiri komandues publikohen në faqen e internetit, ndërsa personeli i policisë kanë uniforma dhe numra identifikues të cilët janë të dukshëm për qytetarët në rast se dëshirojnë të ankohen ose ta raportojnë ndonjë abuzim nga një zyrtar. Nivel i ngjashëm i transparencës zbatohet edhe në rastin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Si Policia e Kosovës ashtu edhe Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdimisht mbështesin përfshirjen e pakicave në këto shërbime. Shkalla e suksesit në integrimin e pakicave në jug të Kosovës është e lartë, ndërsa komunat veriore ende po rezistojnë të funksionojnë nën institucionet e Kosovës.

Pjesëmarrja publike

Sipas raportit të BTI (2012), Qeveria e Kosovës ka qenë në të shumtën e mbyllur në vendimet e saj, duke u konsultuar me shoqërinë civile vetëm formalisht. Të kërkuarit e kontributit është bërë kryesisht pjesërisht dhe është monopolizuar nga qeveria. Në një masë të konsiderueshme, për shkak të trysnisë së shtuar nga bashkësia ndërkombëtare për të përfshirë në vendimmarrje OJQ-të, më 2010 qeveria filloi t'i mbështesë grupet specifike të OJQ-ve. Së fundi, sekretaria e Kuvendit të Kosovës i ka forcuar kapacitetet kërkuese të komisioneve. Janë organizuar më shumë dëgjime publike por ndikimi i tyre mbeti minimal (OSBE, 2013).

Kosova vazhdon ta lehtësojë kulturën e shoqërisë civile, duke çuar shpesh në debate shoqërore dhe duke paraqitur këndvështrimet e shoqërisë civile për çështje të ndryshme që janë shqetësuese për publikun. Pjesët e tjera të shoqërisë civile, siç janë akademikët dhe shkencëtarët, vazhdojnë të mbeten të heshtur lidhur me çështjet që e shqetësojnë publikun dhe rrallë angazhohen në të kritikuarit e qeverisë (BTI, 2012). Liria e organizimit dhe e tubimit është shtylla kryesore e demokracisë kushtetuese të Kosovës. Individët dhe grupet shoqërore apo politike kanë të drejta të pakufizuara për t'u organizuar dhe për t'u tubuar. Megjithatë, kriteret të cilat shfrytëzohen për vlerësimin e kërkesave për leje për t'u tubuar nuk janë transparente në masë të mjaftueshme (OSBE, 2012).

Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me CIVIKOS e kanë hartuar një strategji qeveritare për bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë për periudhën 2013-2017, e cila ka për qëllim përmirësimin e procesit të konsultimeve dhe të bashkëpunimit. Zyra e kryeministrit po ashtu ka përgatitur doracakët udhëzues për ministritë e linjës lidhur me mënyrën e hartimit të legjislacionit në bashkërendim me organizatat e shoqërisë civile

¹⁷ Shih raportin vjetor 2012 të Policisë së Kosovës

dhe doracakun për procesin e konsultimeve publike. Doracaku për konsultime publike është hartuar për të gjithë nëpunësit civilë në nivelin lokal dhe qendror, të cilët janë përgjegjës për hartimin e ligjeve dhe të politikave, por po ashtu edhe për anëtarët e organizatave të shoqërisë civile të cilët janë të interesuar të përfshihen në procesin e vendimmarrjes në

Kosovë, përmes procesit të konsultimit publik. Inkurajohen shoqëria civile dhe nëpunësit civilë që të kalojnë nëpër procesin e konsultimit publik. Hapi i parë në proces është informimi, i pasuar nga procesi i konsultimit, dialogu i hapur dhe niveli më i lartë i angazhimit që është partneriteti. Ndërsa pritet që dy hapat e parë të iniciohen nga institucionet publike, dy hapat e fundit mund të iniciohen nga të dy palët.

Doracaku thekson nevojën që në procesin e konsultimit publik të përfshihen grupet e marginalizuara të shoqërisë dhe palët e tjera përkatëse. Rregullorja e punës 65 dhe 66 e Kuvendit të Kosovës mundëson pjesëmarrjen e OJQ-ve në komisionet parlamentare dhe dëgjimet publike të organizuara nga këto komisione. Megjithatë, ana e dobët e kësaj është që rregullorja saktëson që OJQ-të mund të marrin pjesë, pa e përshkruar si të shfrytëzohet kjo mundësi për pjesëmarrje publike. Prandaj pjesëmarrja e OJQ-ve në dëgjimet publike do të varet nga gatishmëria e komisioneve të Kuvendit të Kosovës që të angazhojnë OJQ në përgatitjen e legjislacionit. Sipas statistikave duket që më shumë se 1/3 e ligjeve të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës kanë kaluar nëpër dëgjime publike në komisione të ndryshme parlamentare (KCSF, 2011).

Rregullorja e punës e Qeverisë së Kosovës trajton në mënyrë më specifike çështjen e pjesëmarrjes publike. Sipas nenit 32, 39, 69 dhe 70 të kësaj rregulloreje, të gjitha propozimet nga Qeveria e Kosovës do të shkojnë përmes konsultimit publik me shoqërinë civile, ndërsa qeveria do të përgjigjet për çdo nismë apo propozim që vjen nga shoqëria civile. Kapaciteti për shqyrtimin e politikave, para se ato të dorëzohen në qeveri dhe kapaciteti për të përgatitur politika dhe për të hartuar legjislacion, është i kufizuar nga burimet e kufizuara njerëzore në të gjitha ministritë. Duhet të përmirësohen proceset e konsultimit si ato ndërministrore ashtu edhe ato me shoqërinë civile (SIGMA, 2011).

Në lidhje me nivelin komunal, Ligji mbi vetëqeverisjen lokale njih të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e komunave të tyre përkatëse (neni 4.5). Komunitat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët për planet ose programet e tyre të cilat janë me interes për publikun. Ky ligj parashikon po ashtu që komunitat t'i kenë së paku dy takime publike brenda vitit. Në legjislacionin përkatës thuhet që takimet publike duhet të lajmërohen dy javë më parë. Sipas gjetjeve të OSBE-së (2012), ky rregull është respektuar vetëm në 50% të rasteve për dëgjimin publik në zhvillimet e buxhetit komunal. Përveç kësaj, format e njoftimit publik për takime publike të cilat janë shfrytëzuar më së shumti kanë qenë shpalljet në faqen e internetit të komunës, njoftimet e vendosura në ndërtesat komunale dhe/ose në tabelat e informimit, ose kombinimi i këtyre dy formave. Vetëm një komunë ka njoftuar për takime publike në mediat e shtypura (gazeta). Njëri prej problemeve më të mëdha të identifikuar nga raportet e OSBE-së është dështimi i pjesës më të madhe të kuvendeve komunale për ta thirrur së paku një takim publik për propozimin e buxhetit komunal para se ai të

aprovohet. Në përgjithësi, përfshirja e shoqërisë civile dhe e qytetarëve në hartimin e planeve dhe të strategjive ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, ndërsa duhet të vendoset moduli i informatave kthyesë për të marrë komente nga qytetarët në lidhje me shërbimet institucionale.

Llogaridhënia

Për ta siguruar llogaridhënien e organizatave shërbyese është me rëndësi të bëhet auditimi i brendshëm dhe i jashtëm i secilës organizatë publike. Përmes auditimit mund të sigurohet një menaxhim më i përgjegjshëm në ministri, në komuna dhe në ndërmarrjet e tjera publike (Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 2012).

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e bën publik raportin e jashtëm të auditimit për secilin institucion publik, ndërsa raportet e brendshme të auditimit kryhet nga institucionet përkatëse. Qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të kenë qasje në raportet e auditimit në faqen e internetit të zyrës së auditorit të përgjithshëm. Institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale i publikojnë në faqet e tyre të internetit buxhetet e tyre, raportet e auditimit, projektet të cilat janë duke u zhvilluar dhe ato të përfunduarat, vendimet e qeverisë dhe informatat lidhur me shërbimet që i ofrojnë. Për dokumentet të cilat nuk janë në dispozicion në faqen e internetit, qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe palët e tjera përkatëse duhet ta bëjnë një kërkesë që t'ju lejohet qasja në dokumentet publike dhe ata nuk kanë nevojë të japin arsye pse po e kërkojnë një dokument dhe pritë që ata të marrin përgjigje brenda shtatë ditëve.

Agjencia kundër korrupsion është aktive në monitorimin dhe publikimin e ndonjë konflikti të interesi, të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publikë. Për ta siguruar llogaridhënien, agjencia e Kosovës kundër korrupsionit ka zbatuar procesin e deklarimit të pasurisë nga zyrtarët publikë dhe deri më 2013 rreth 99% e zyrtarëve publikë që janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre e kanë bërë këtë. Edhe rastet e konfliktit të interesit bëhen publike. Në faqen e internetit të AKK-së publikohen vendimet e gjyqit për konfliktin e interesit, gjobat lidhur me zyrtarët të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre dhe listat e të gjithë zyrtarëve të cilët e kanë deklaruar pasurinë e tyre¹⁸.

Sa ju përket masave të tjera të llogaridhënies, inspektoratet dhe agjencitë rregulluese janë kryesore për mbajtjen e institucioneve dhe kompanive përgjegjëse dhe për monitorimin e veprimeve të tyre. Një shembull është Zyra e Rregullatorit për Energjetikë në Kosovë e cila nuk e ka lejuar rritjen e çmimit të energjisë ashtu siç ka kërkuar udhëheqja e kompanisë së shpërndarjes së energjisë. Në lidhje me shërbimet e sigurisë, Inspektorati i Policisë së Kosovës është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së policisë. Statistikat për aktivitetet brenda Policisë së Kosovës publikohen si pjesë e raportit vjetor të policisë.

Besueshmëria dhe integriteti publik i bordeve ekzekutive të ndërmarrjeve publike sfidohet nga ndikimi politik i qeverisë në anëtarit e bordit, i cili buron nga emërimi i tyre i ndikuar nga partitë politike në qeveri. Edhe pse me ligj anëtarët e bordit duhet të jenë të pavarur, ata duket se janë

¹⁸ Për informata të hollësishme shih faqen e internetit të AKK-së.

nën ndikimin e partive politike.

Në lidhje me planifikimin e veprimeve afatmesme dhe afatshkurta dokumentet e përgatitura pr-iren t'i identifikojnë masat pa vlerësimin paraprak të buxhetit të disponueshëm dhe të kapacitetit të institucionit për t'i kryer detyrat relevante. Për rrjedhojë, si proceset afatmesme të planifikimit ashtu edhe ato afatshkurta janë të institucionalizuara dobët, duke pasur si rezultatt pronësinë e paqartë të planeve brenda institucioneve që në anën tjetër ndikon në monitorim dhe në zbatim (Programi vjetor i BE-së, 2013).

Rekrutimi i administratës publike i është nënshtruar nepotizmit, i cili në anën tjetër ndikon në cilësinë dhe në përmbushjen e sektorit publik. Indikacionet e fundit lidhur me nepotizmin në institucionet publike kanë dalë nga përgjimi i zyrtarëve të qeverisë, përfshirë kryeministrin e Kosovës, i cili ka qenë i përfshirë në bisedën e incizuar nga hetuesit e EULEX-it si pjesë e një procesi hetues, incizime të cilat janë publikuar në mënyrë të paligjshme. Mungon një sistem i besueshëm informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe informatat e disponueshme lidhur me burimet njerëzore nuk janë mjaft të sakta për ta mbështetur një politikë dhe menaxhim të duhur dhe koherent të shërbimit civil (SIGMA, 2011). Megjithatë, legjislacioni i aprovuar ka krijuar një bazë ligjore në të cilën MAP dhe Ministria e Financave do të jenë në gjendje ta përmirësojnë cilësinë e kontrollimit të punësimit të stafit në shërbimet publike. Sa ju përket politikave të rekrutimit duket se një numër i madh i qytetarëve beson se në mënyrë që procesi i rekrutimit të jetë i drejtë nuk duhet të mblidhen informatat për përkatësinë etnike dhe fetare (Rinvest, 2013)¹⁹.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-11 për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjen Publike shërbimet publike, siç është transporti publik dhe kompanitë e ngrohjes, funksionojnë si ndërmarrje lokale publike. Kompanitë e ngrohjes funksionojnë në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë si ndërmarrje lokale publike (kjo e fundit nuk është funksionale). Gjithsej ato prodhojnë vetëm 3% të kërkesës për ngrohje në Kosovë (vetëm Prishtina përbën rreth 80% të këtij kapaciteti). Ato i furnizojnë zonat më të populluara të qytetit dhe objektet publike siç janë spitalet, shkollat dhe ndërtesat administrative. Sistemet e tilla vuajnë nga teknologjia e vjetruar, menaxhimi i dobët, humbjet e mëdha komerciale të shkaktuara nga mos pagesa e faturave që çon tek paqëndrueshmëria, mungesa e subvencioneve shtetërore²⁰.

Administrata e Kosovës nuk është e pranishme në komunat veriore të Kosovës të banuara me serbë të Kosovës. Me marrëveshjen e fundit ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë, pritet që gjendja të përmirësohet. Ndërsa në komunat në pjesët e tjera të Kosovës, ku komuniteti serb është shumicë, strukturat ligjore janë duke funksionuar tani dhe ligji i Kosovës është duke u zbatuar. Megjithatë, priten më shumë standarde të informacioneve të hapura për ta shtuar llogaridhënien e zyrtarëve komunalë në këto komuna.

Në lidhje me administratën publike, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) është njëri prej organeve kryesore të pavarura. Është një organ i dobishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përballet me sfida të mëdha, sidomos në lidhje me buxhetin dhe objektin (KE,

¹⁹ Rezultatet e sondazhit (Shih pjesën IV, 2.1).

²⁰ Task Forca për Integritim Evropian (2012). Materiali për diskutim, Tryeza e rrumbullakët tematike "Ekonomia, Financat dhe Statistikat".

2012). Zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë rregullohet me nenin 25 të Ligjit për shërbimin civil në Kosovë në të cilin thuhet se për secilën kategori të punës do të ketë grada të caktuara të vendosura në mënyrë progresive. Avancimi në karrierë i nëpunësve civilë prej kategorisë së tyre aktuale në një kategori më të lartë do të bazohet në përmbushjen e tyre. Po ashtu, neni 26 sakteson që nuk lejohet emërimi i drejtpërdrejtë në një pozitë të lirë në kundërshtim me parimin e meritës dhe të procedurave të caktuara nga legjislacioni në fuqi.

Infrastruktura ligjore që përfshin gjyqësorin në Kosovë është plotësuar me aprovimin e një numri të ligjeve themelore dhe thelbësore. Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 104, paragrafi 1, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ja propozon emrat Presidentit të Kosovës dhe pastaj Presidenti bën emërimin, riemërimin dhe heqjen nga pozita të gjyqtarëve. Nëse pavarësia e gjyqësorit garantohet me ligj, në praktikë ka përpjekje për ndërhyrje politike, ndikim dhe kërcënim të gjyqtarëve (OSBE, 2012a). Një perceptim i përhapur është që gjykatat janë ndër institucionet më të korruptuara dhe më të kontrolluara nga institucionet politike. Megjithatë, ekzistojnë disa statistika të besueshme ose raste të njohura të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të politikës në gjyqësor. Në të gjitha institucionet dhe kompanitë publike qytetarët inkurajohen që të ofrojnë informata kthyesë por nuk ka ndonjë mekanizëm të duhur të informatave kthyesë.

Teknologjia dhe inovacioni

Mjetet kryesore teknologjike të cilat shfrytëzohen nga qeveria qendrore dhe ajo lokale janë mediat dhe interneti. Ata i shfrytëzojnë faqet e tyre të internetit për ta informuar publikun e gjerë lidhur me ligjet dhe vendimet. Ndërmarrjet publike po ashtu i publikojnë në faqet e tyre të internetit raportet e tyre vjetore, buxhetet dhe raportet e auditimit. Mediat e tjera sociale si facebook shfrytëzohen nga Qeveria dhe udhëheqësit e tjerë institucionalë për të komunikuar me qytetarët. Në lidhje me shfrytëzimin e teknologjisë për qasje në informata dhe ndarje të tyre me të tjerët, është shqetësuese që 55.1% e të anketuarve në sondazh (Riinvest, 2013) nuk kanë njohuri nëse qeveria e tyre lokale ka faqe të vetën të internetit. Ndërsa, vetëm 37.7 % e dinë që qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit dhe 7.2 % thonë që qeveria e tyre lokale nuk ka faqe të vetën të internetit.

Një e-platform për regjistrimin e biznesit është në dispozicion. Bizneset mund të regjistrohen online dhe të shfrytëzojnë informata relevante përmes e-portalit. Ndërsa qytetarët tani mund ta përcjellin online procesin e lëshimit të dokumenteve personale siç është leja e njoftimit, pasaporta dhe leja e ngasjes së automjeteve. Sistemet e tjera digjitale, të cilat janë duke u funksionalizuar, janë aplikimi online për leje të ngasjes së automjeteve, regjistrimi i automjeteve, aplikimi online për certifikatat e gjendjes civile, sistemi i menaxhimit të pasurisë, arkivi elektronik i dokumenteve, sistemi i menaxhimeve të projektit dhe aplikacioni i shërbimit policor për identifikimin e automjeteve dhe të lejeve për ngasjen e automjeteve²¹. Ndërsa, informatat për shërbimet e kontraktuara publikohen nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

21 Shih faqen e internetit të Ministrisë së Administratës Publike.

Aktualisht, departamenti i TI në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike është duke shërbyer si qendër e e-qeverisjes. Publikimi i vendeve të lira të punës në faqet e internetit duket të jetë dobësi. Në veçanti në faqet e komunave, publikimet e vendeve të lira të punës janë të vjetra dhe duket që rishitazi nuk është publikuar ndonjë vend i lirë pune. Si alternativë, institucionet duket se parapëlqejnë gazetatat për publikimin e vendeve të lira të punës. Nevojitet një modul i informatave kthyesë në të gjitha shërbimet publike në mënyrë që të merren komentet e drejtpërdrejta nga qytetarët për rritjen e cilësisë në shërbimet publike.

Tabela 1. Përmirësimi i shërbimeve publike: Rreziqet dhe Mundësitë

Rreziqet	Mundësitë
<p>Mungesa e rregullave dhe procedurave të standardizuara për publikimin e informacioneve do ta rrisë lirinë e veprimit të zyrtarëve qeveritarë në zgjedhjen e informacioneve që dëshirojnë t'i bëjnë publike. Mungesa e kapacitetit për vlerësimin e përmbushjes së agjencive shërbyese dhe ndikimi i supozuar politik krijon rrezikun për vlerësim të anshëm të përmbushjes.</p>	<p>Informacionet e hapura për të gjitha proceset e rekrutimit, siç janë vlerësimet e proceseve të rekrutimit, CV-të e punëtorëve të pranuar në punë, etj., do të krijojnë presion pozitiv në rritjen e cilësisë së të punësuarve të pranuar në punë.</p>
<p>Nepotizmi i supozuar në administratën publike mund të ndikojë negativisht në cilësinë dhe përmbushjen e administratës publike.</p>	<p>Krijimi i një mekanizmi të informatave kthyesë të bazuar në internet si mjet për rritjen e cilësisë dhe përmbushjes së shërbimeve është një mundësi për institucionet që t'i përmirësojnë shërbimet publike.</p>
<p>Mungesa e një sistemi informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe e informatave për burimet njerëzore do të krijojë rreziqe për punësimin e mëtejshëm të të afërmeve në administratën publike në dëm të cilësisë dhe të punësimit të bazuar në përmbushje.</p>	<p>Hartimi i strategjisë së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile është një mundësi për përfshirje më të madhe të shoqërisë civile në procesin e planifikimit dhe të vendimmarrjes.</p>
<p>Bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe CIVIKOS mund ta rrezikojë procesin e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile nëse udhëheqësit e CIVIKOS bien nën ndikimin e qeverisë.</p>	<p>Integrimi i institucioneve paralele të serbëve të Kosovës në sistemin legjislativ të Kosovës sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë mund të krijojë mundësi për përfshirje më të madhe dhe informacione më transparente për shërbimet e ofruara në komunat në rajonin verior të Kosovës</p>
<p>Ndikimi politik mbi udhëheqjen e agjencive shërbyese do ta komprometojë cilësinë e shërbimeve.</p>	

INTEGRITETI PUBLIK I SHTUAR

Kosova ka arritur përparim në vendosjen e kornizës së duhur ligjore për shtimin e integritetit publik. Deri më 2009 u aprovua ligji për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar por institucioni i cili e menaxhon këtë pasuri është ende në fazën e tij fillestare të funksionimit. Më 2011 u aprovuan disa ligje si: ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve të lartë publikë, ligji për mbrojtjen e informatorëve dhe ligji për prokurimin publik. Ligji për financimin e partive politike dhe ai për konfliktin e interesit duhet të përmirësohen edhe më tepër. Zbatimi i plotë i këtij legjislacioni është sfidë e ardhshme për institucionet e Kosovës, ndërsa korrupsioni mbetet shqetësimi kryesor i shoqërisë.

Transparenca

Qeveria e Kosovës i ka bërë disa hapa drejt qeverisjes më transparente por nevojiten përmirësime të rëndësishme. Sipas rregullores së punës disa prej dokumenteve siç janë procesverbalet e takimeve të Qeverisë së Kosovës janë të dhëna konfidenciale (Pjesa 59, paragrafi 3). Procesi i aprovimit të buxhetit vjetor nga Kuvendi i Kosovës e rregullon po ashtu edhe publikimin e buxhetit të Qeverisë.

Edhe pse buxheti vjetor i Kosovës dhe shpenzimet e qeverisë janë në dispozicion për qytetarët, informatat për shpenzimet më të hollësishme janë të komplikuar që qytetarët e zakonshëm t'i kuptojnë ato. Në këtë aspekt nevojitet që të gjitha informatat lidhur me buxhetin të bëhen transparente dhe të ndiqen shembujt e vendeve të tjera, siç është Shqipëria, ku jepen informata të hollësishme për shpenzimet publike në bazë akruale.

Kuvendi i Kosovës publikon raporte për punën e forumeve të tij të brendshme në periudha specifike, por nuk ka ndonjë kërkesë ligjore që t'i raportojë ndonjë institucioni specifik ose qytetarëve të Kosovës (KDI, 2011). Shpenzimet vjetore të Kuvendit të Kosovës nuk janë publikuar në faqen e internetit dhe publikimi i dokumenteve thelbësore në faqen e Kuvendit nuk është në nivel të kënaqshëm.

Kosova ka themeluar një Agjenci Kundër Korrupsionit (AKK), një Task Forcë Kundër Korrupsionit, Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Këshillin Prokurorial Kundër Korrupsionit. AKK e Kosovës publikon në faqen e saj pasurinë e deklaruar të zyrtarëve të lartë publikë. Agjencia Kundër Korrupsionit është institucioni kryesor për vetëdijesimin e publikut për korrupsionin në Kosovë, i cili ka për detyrë ta kontrollojë deklarimin e pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesit dhe mund të kryejë hetime administrative me vetë iniciativë ose t'i përcjellë denoncimet (Sigma, 2011).

Përçindja e zyrtarëve publikë të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe që janë duke e bërë këtë është rritur konsiderueshëm. Në prill 2013, AKK publikoi që 99% e zyrtarëve publikë të cilët janë të obliguar ta bëjnë këtë kishin vepruar ashtu. Kjo e ka rritur

transparencën e zyrtarëve publikë por megjithatë problemi mbetet tek boshllëku i deklaruar dhe pasuria e vërtetë në një anë dhe tek burimet e kapitalit për pasurinë e tyre të raportuar. Duket se kjo përkrahet edhe nga qytetarët meqë shumica dërrmuese e të anketuarve që ishin pjesë e anketimit (rreth 75 %) tregojnë që pjesëtarët e parlamentit dhe këshilltarët lokalë duhet ta bëjnë publike pasurinë dhe të ardhurat personale.

Është themeluar po ashtu edhe Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AKMDHP). Mandati i saj i referohet Ligjit nr. 03/L-172. Ky ligj përcakton procesin dhe shkallën e përpunimit të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave sekret, në mes tjerash. Lista e zyrtarëve që janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave në secilin institucion publikohet në faqen e AKMDHP. Të dhënat e tjera relevante që publikohen në faqen e internetit janë: skema organizative e agjencisë, informatat për mbështetje dhe projekte, të drejtat e qytetarëve, vendet e lira të punës dhe raporti vjetor në mesin e informatave tjera. Agjencia ka bërë disa refuzime dhe aprovime lidhur me qasje në të dhënat personale. Për shembull një kërkesë e një OJQ-je në komunën e Lipjanit për të pasur qasje në listën e pagave të të punësuarve komunalë dhe një kërkesë e një qytetari të Kosovës që të ketë qasje në fondin pensional të kushëririt të tij në Trustin e Kursimit Pensional të Kosovës janë konsideruar që janë kundër Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë refuzuar (AKMDHP, 2013)

Çështje tjetër lidhur me transparencën dhe shtimin e integritetit publik është financimi i partive politike. Partitë politike nuk janë të sigërtat në raportet e tyre financiare. Kjo bëhet e qartë në kohën e zgjedhjeve kur partitë posedojnë dhe shpenzojnë më shumë fonde se sa që posedojnë sipas deklarimeve të tyre. Auditimi i partive duhet të bëhet nga kompanitë e pavarura në mënyrë që publikut t'i ofrohet transparencë e plotë (KIPRED, 2012). Ligji për financimin e partive politike, i ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës më 16 shtator 2010, rregullon kushtet për financimin, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin e shpenzimeve, të pasurisë dhe të të hyrave të partive politike në Kosovë. Partitë politike i dorëzojnë pasqyrat e tyre financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) por këto raporte nuk ngarkohen në faqet e tyre të internetit ose në faqen e KQZ-së. Informatat për partitë politike të publikuara nga KQZ janë të kufizuara sa i përket ofrimit të hollësive. Në faqen e KQZ-së publikohen informatat për ligjet, vendimet, rezultatet, formularët dhe informatat e tjera lidhur me këtë. Në lidhje me fushatat zgjedhore duhet të bëhet publike vetëm shuma e plotë e shpenzimeve. Informatat e tjera nuk bëhen publike. KQZ është e obliguar t'i auditojë shpenzimet, megjithatë vetëm për t'u siguruar që nuk tejkalohet shuma e plotë (KDI, 2011).

Auditimi i përgjithshëm i të gjitha institucioneve publike është një mjet i rëndësishëm për shtimin e transparencës dhe të integritetit publik. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) i publikon të gjitha raportet në faqen e internetit prej vitit 2005. Publiku mund t'i gjejë informatat e përgjithshme, bazën ligjore, politikat, standardet, doracakët dhe udhëzimet. Për më tepër, ajo jep informata për tenderët dhe adresat, numrat e telefonit ose adresat elektronike të personave kontaktues në ZAP.

Në lidhje me transparencën në gjyqësor, gjyqtarët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës (AKKK) në pajtim me ligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë (Ligji 03/L-151) dhe në KGJK duke u bazuar në Kodin e etikës dhe të sjelljes profesionale të gjyqtarëve. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) i raporton Kuvendit të Kosovës një herë në vit në lidhje me efikasitetin dhe funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor, ashtu siç kërkohet me kushtetutë. Rregullorja 2005/52 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, neni 1.7, parashikon që KGJK ofron të dhëna dhe statistika për sistemin gjyqësor sipas nevojës.

Vendimet dhe të dhënat për gjyqësorin publikohen vetëm në raportin vjetor të KGJK-së i cili nuk është gjithëpërfshirës dhe i cili i dërgohet Kuvendit të Kosovës dhe publikohet në faqen e këtij institucioni. Në këtë raport gjenden të dhënat për numrin e gjyqtarëve, të rasteve të pranuar dhe të zgjidhura, numri i rasteve të trashëguara nga vitet e mëparshme, numri i gjyqtarëve në krahasim me numrin e rasteve, etj., por, për shembull, nuk përfshihen të dhënat për buxhetin dhe qeverisjen në gjyqësor. Në praktikë, gjyqtarët e deklarojnë pasurinë e tyre e cila pastaj hetohet nga KPGJP dhe ka pasur shumë raste kur është zbuluar mos deklarimi i pasurisë nga gjyqtarët dhe si rrjedhojë janë ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj tyre.

Në lidhje me shërbimet publike, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) publikon raportin vjetor për aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, i cili i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Në raport ofrohen të dhënat për prokurimin publik në Kosovë, numri i kontratave të dhëna, vlera e tyre, etj. KRRPP dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) i kanë faqet e tyre të internetit ku mund të shihen vendimet e marra nga këto dy institucione.

Pjesëmarrja Publike

Përfshirja publike në një proces konsultativ përcaktohet në nenin 27 (konsultimet e grupeve punuese me publikun) dhe në nenin 36 (konsultimet shitesë me shoqërinë e Kosovës në rastin e dilemave lidhur me aspektet specifike të draft legjislacionit) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, Qeveria ka ngurruar ta përfshijë publikun dhe organizatat e shoqërisë civile në proceset e bërjes së politikave (KDI, 2011). Bashkëpunimi dhe përfshirja e shoqërisë civile në planifikimin dhe vendimmarrjen qeveritare mund ta shtojë integritetin publik të institucioneve. Bashkëpunimi i fundit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe CIVIKOS për hartimin e strategjisë për përmirësimin e bashkëpunimit është fillim i mirë. Dobësitë dhe rreziqet janë që platforma e CIVIKOS mund të pushtohet nga interesat qeveritarë dhe ta monopolizojë vendimmarrjen nga ana e shoqërisë civile.

Të mundësuarit e përfaqësuesit të shoqërisë civile që të marrë pjesë në takimet qeveritare do të ishte një hap tjetër përpara në rritjen e transparencës dhe të integritetit të institucioneve. Ministria për Integritet Evropian ka themeluar një Task Forcë për integritet ev-

ropiane si mekanizëm për krijimin e konsensusit që mbledhë ekspertë të ndryshëm nga të gjitha strukturat qeveritare dhe joqeveritare të vendit, në mënyrë që ta diskutojë dhe ta analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen aktuale dhe sfidat që duhet të adresohen në kuadër të procesit të integritimit evropian. Me këtë, ajo ka për qëllim t'i shumëfishojë përpjekjet dhe angazhimet përmes pjesëmarrjes dhe kontributit të të gjithë aktorëve në qeverisje, politikë, botën shkencore, jetën publike, shoqërinë civile, media dhe të aktorëve të tjerë që janë të interesuar për procesin e integritimit evropian.

Domosdoshmëria e përfshirjes së shoqërisë civile dhe e aktorëve të tjerë në planifikimin dhe në përgatitjen e ligjeve dhe të strategjisë rrjedhë nga shumë dështime të qeverisë që të dalë me zgjidhje të shpejta dhe të mbyllura. Mungesa e bashkëpunimit në zhvillimin e strategjisë për zhvillim ekonomik të Kosovës, e përgatitur nga Qeveria e Kosovës më 2012, është kritikuar për mungesë të qasjes serioze dhe intensitet të planifikimit strategjik. Duket që e njëjta strategji është harruar nga qeveria vetëm një vit më pas.

Sipas rezultateve të sondazhit rreth 46.4 % e të anketuarve thonë që një qytetar i zakonshëm nuk ka ekspertizë të mjaftueshme të gjykojë për vendimmarrjen e qeverisë (Riinvest, 2013). Kjo mund të jetë njëra nga arsyet pse 76.4 % e të anketuarve të intervistuar – ndonëse të pakënaqur me qeverinë – nuk protestojnë ose demonstrojnë. Rrjedhimisht, përfshirja e përgjithshme e qytetarëve mbetet e ulët.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës ka përfshirë organizatat e shoqërisë civile në procesin e konsultimit në disa raste. Më 2013, në bashkëpunim me Qendrën për Arsim të Kosovës (QAE), janë organizuar 12 punëtori në komuna të ndryshme rreth Kosovës në mënyrë që të diskutohet strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit, Ligji kundër korrupsionit, dhe mandati ligjor i Agjencisë Kundër Korrupsionit. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte që të rritet kontributi publik në përgatitjen e dokumenteve.

Organizata e shoqërisë civile ÇOHU mori pjesë në zhvillimin e Strategjisë kundër korrupsionit; megjithatë, rekomandimet e tyre ishin injoruar. Pavarësisht nga fakti që versioni i kësaj strategjie i dërguar nga Qeveria e Kosovës ishte refuzuar nga Kuvendi me kërkesën e OJQ-ve dhe me arsyetimin që ky dokument ishte hartuar keq, më vonë Agjencia Kundër Korrupsionit dërgoi të njëjtën strategji me vetëm disa ndryshime të vogla, e cila u aprovua nga Kuvendi në rastin e dytë (KDI, 2011). Më 2013 është aprovuar strategjia kundër korrupsionit dhe përkundër sugjerimeve nga organizatat e shoqërisë civile të cilat ishin një forum këshillues që ishte duke vazhduar (FOL, KDI, AsKK, ÇOHU, GAP, IKS, INPO, KMDLNJ, QPA) ato nuk u përfshin në dokumentin përfundimtar.

Në përgjithësi, bashkëpunimi qeveri – shoqëri civile duhet të forcohet dhe të kuptohet si partneritet dhe jo si raport armiqësor. Institucionet duhet të jenë shumë më të hapura dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë më proaktive dhe më energjike (KDI, 2011). Një shembull i mirë i pjesëmarrjes publike në fazën e planifikimit është zhvillimi i planit të planifikimit hapësinor të Kosovës. Ky plan është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me profesionistë, institucione të ndryshme shkencore, universitet, organizatat joqeveritare, zyrtarë vendas dhe organizata ndërkom-bëtare²².

22 For further details see website of Ministry of Environment and Spatial Planning.

Llogaridhënia

Llogaridhënia politike është njëra prej tipareve për vetëkontroll dhe llogaridhënie të përfaqësuesve politikë. Integriteti i Qeverisë së Kosovës duket se vihet në pikëpyetje nga të anketuarit e intervistuar si pjesë e sondazhit. Shumica dërrmuese e të anketuarve pajtohen që vendimet e qeverisë ndikohen nga bashkësia ndërkombëtare, nga deputetët individualë të parlamentit, ose madje nga kompanitë e mëdha (Rinvest, 2013). Meqë, me ligj, Kosova është e përcaktuar si një zonë elektorale dhe nuk ka qarqe elektorale, llogaridhënia e deputetëve të Kuvendit është çështje e zgjedhjes së tyre meqë ata nuk janë drejtpërdrejt përgjegjës për zonat elektorale që i përfaqësojnë.

Kuvendi i Kosovës, Ligji për të drejtat dhe detyrimet e deputetëve thotë që një deputet i kuvendit nuk mundet në të njëjtën kohë të jetë kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër ose zëvendësministër (neni 6 i ligjit). Sidoqoftë, ligji ka krijuar disa privilegje siç është e drejta për pension shtesë për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka vendosur ta suspendojë zbatimin e këtyre dispozitave në masë të përkohshme në bazë të asaj që kjo mund të ketë si rezultat dëmtimin e përhershëm dhe që ky suspendim është në interes publik (Sigma, 2011).

Në nenin 7 të ligjit për partitë politike thuhet: “Një parti politike, e cila nuk e dorëzon raportin vjetor financiar në KQZ brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, e humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin në vijim”. Personat përgjegjës brenda partisë politike gjobiten me shumën prej një mijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) euro. Ndërsa partitë politike të cilat nuk mund ta vërtetojnë prejardhjen e të hyrave mbi njëzetmijë (20.000) euro do të gjobiten sa tri herë ajo shumë. Nëse fondet keqpërdoren nga një kandidat ose parti politike dhe mund të vërtetohet që të fituarit e mandatit (-ve) është rezultat i keqpërdorimit të fondeve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, mandati i kandidatit ose i subjektit politik mund të merret. Në disa raste janë gjobitur financiarisht shkeljet e dispozitave ndërsa masat e tjera, si marrja e mandatit të ndonjë kandidati, nuk janë ndërmarrë. Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës ua mundëson qytetarëve, të cilët kanë informata për rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin ose që ballafaqohen me korrupsion në jetën e tyre të përditshme, që ta kontaktojnë agjencinë në numrin e ofruar të telefonit, duke siguruar që të gjitha raportimet do të jenë të fshehta. Agjencia është po ashtu përgjegjëse për: fillimin e hetimit lidhur me rastet e korrupsionit dhe fillon akuzat penale në rastet e dyshimit për korrupsion, nëse nuk është marrë ndonjë procedurë penale për rastin e njëjtë. Agjencia monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit, rastet e konfliktit të interesit dhe i ndërmerr masat e nevojshme ose detyrat e tjera lidhur me to siç është mbikëqyrja e pasurisë së zyrtarëve publikë, pranimi i dhuratave nga zyrtarët publikë. Rasti i fundit i raportuar nga AKK është konflikti i interesit të një anëtarit të bordit të Bankës Qendrore të Kosovës i cili është njëkohësisht edhe zëvendës i rektorit të Universitetit Publik “Hasan Prishtina”.

Ligji i ri për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-042, është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 gusht 2011, është shpallura nga Presidentja e Republikës së Kosovës me dekretin Nr.DL-032-2011, më 31 gusht 2011 dhe është publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.18, më 19 shtator 2011. Sipas nenit 135 të këtij ligji, parashihet që ky ligj të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, që do të thotë se ligji i ri për prokurimin publik Nr. 04/L-042 hyn në fuqi prej datës 5 tetor 2011. Autoritetet kontraktuese të Kosovës janë të obliguara që prej kësaj date ta zbatojnë Ligjin për prokurimin publik Nr. 04/L-042 për të gjitha aktivitetet e prokurimit. Nenet 34 – 37 të këtij ligji autorizojnë në mënyrë specifike shfrytëzimin e procedurave të ndryshme të prokurimit, procedurat e hapura dhe të kufizuara, prandaj autoriteti kontraktues e zgjedh dhe e shfrytëzon procedurën e hapur apo të kufizuar gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit që çojnë tek dhënia e kontratës publike.

Ndër vite janë vërejtur shumë shkelje të procesit të prokurimit. Sipas një hulumtimi nga Preportr (2013), bizneset e huaja për dhjetë vjet me radhë kanë marrë me qindra miliona euro nga KEK-u, shpesh duke ju shitur atyre pajisje të zhvlerësuar si pajisje të reja, por po ashtu edhe shërbime dhe energji me çmime më të larta se çmimi i tregut. I njëjti hulumtim gjeti se më shumë se 200 biznese vendase dhe ndërkombëtare fituan mbi 500 tenderë publikë të KEK-ut, me një vlerë prej mbi 550 milionë euro. Në mesin e këtyre kompanive përfituesit më të mëdhenj janë dy kompani vendase që shton dyshimet për korrupsion.

Në lidhje me praktikën e trajtimit të mekanizmit të ankesës, është me rëndësi të theksohet që Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë shumë përpjekje për ta rritur nivelin e njohurisë për këtë mundësi të ankesave dhe të peticioneve të qytetarëve në Kuvend. Madje as në faqen e Kuvendit (prej shtatorit 2010) nuk ka ndonjë formular/aplikacion ose udhëzim të nevojshëm në lidhje me fushën e funksionimit të këtij komisioni dhe mundësinë për të pasur qasje në këtë komision.

KDI (2011) vëren që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen rregullisht auditimin e Qeverisë dhe i raporton vetëm Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, mungojnë mekanizmat zbatues për sigurimin e pajtueshmërisë dhe zbatimin e vërejtjeve të auditorit. Në raportin e njëjtë thuhet që ka pak bashkëpunim të institucioneve me avokatin e popullit si agjenci e pavarur shtetërore e thirrur për t'i mbrojtur interesat e përgjithshëm dhe për t'i mbajtur institucionet përgjegjëse për veprimet e tyre. (KDI, 2011).

Procesi i privatizimit i NSH-ve në Kosovë është përcjellë me kritika nga shoqëria civile për shkak të mënyrës së menaxhimit të tij. Edhe pse vetë procesi ishte transparent në aspektin ligjor, janë ngritur dyshime për keq menaxhim dhe korrupsion në hije. Vetëvrasja e shefit të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës më 2012 i përforcoi këto dyshime edhe më shumë. Së fundi, një ish-zëvendësministër i qeverisë së Kosovës u emërua shef i Agjencisë së Privatizimit të Kosovës dhe veprimet e tij pas emërimit e shtynë përfaqësuesin e SHBA-së në bord të japë dorëheqje, duke u thirrur në keq menaxhim të supozuar dhe në çështjet e nepotizmit brenda agjencisë. Kjo çoi tek dorëheqja e tij po ashtu. Besueshmëria në institucionet e tjera të pavarura siç është Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është lëkundur nga emërimi

i guvernatorit të ri i cili është ish-ministër i financave. Edhe pse procesi sipas të cilit është zgjedhur e ka respektuar rrugën ligjore dhe është votuar në Kuvendin e Kosovës, kjo e ka sfiduar pavarësinë e BQK-së.

Përkundër aprovimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike, institucionet e Kosovës nuk duket se janë përgjegjëse ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike. Partneriteti i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), vazhdimisht ka kërkuar qasje në dokumentet publike lidhur me privatizimin e KEDS-it, por të gjitha përpjekjet kanë pasur rezultat negativ. Tetorin e kaluar, gjatë një konference për shtyp KOSID-i ka publikuar një dosje në të cilën është paraqitur një korrespondencë ndërmjet Institutit për Studime të Avancuara GAP dhe Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Drejtori ekzekutiv i GAP-it, Agron Demi, pohoi që Ministria për zhvillim ekonomik kurrë nuk u përgjigj në asnjërin prej kërkesave të bëra (Prepotr, 2013). Sipas përfaqësuesit të lëvizjes FOL, në kërkesën e tyre për të pasur qasje në kontratën për ndërtimin e autostradës, ata morën tri arsyetime të ndryshme pse nuk mund të kishin qasje në kontratë, të cilat nuk ishin në pajtim me njëra tjetër²³. Prandaj, nevojitet një proces i standardizuar i lejimit të qasjes në dokumentet publike, në mënyrë që të zvogëlohet liria e veprimit të zyrtarëve publikë të cilët janë përgjegjës për lejimin e qasjes në dokumentet publike.

Teknologjia dhe inovacioni

Në mënyrë që të sigurohet integriteti publik i Kuvendit të Kosovës, të gjitha seancat e kuvendit transmetohen online, ndërsa takimet e komisioneve parlamentare janë të hapura për media. Pra transmetimi përmes mediave është njëri prej mjeteve teknologjike që shfrytëzohet për shtimin e transparencës. Gazeta zyrtare është një mjet tjetër për publikimin e ligjeve dhe të dokumenteve tjera relevante. Vendimet e qeverisë publikohen në faqen e internetit pas secilit takim të qeverisë.

Përfshirja e informatave kthyesë të qytetarëve duhet të jetë imperativ në mënyrë që të rritet integriteti publik. Përveç Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) e cila ka përfshirë një modul të informatave kthyesë ku qytetarët mund t'i shkruajnë komentet e tyre në zyrën për marrëdhënie me publikun, institucionet e tjera nuk kanë të vendosura module të tilla.

Rezultatet e sondazhit tregojnë që prej rreth 37 % të të anketuarve të cilët e dinë që qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit, vetëm 22% e tyre e shfrytëzojnë faqen për përcjelljen e vendimeve të këshillit, për dorëzimin e dokumenteve ose madje për ushtrimin e ankesës. Duket që në këtë aspekt nevojitet vetëdijesimi. Është në interes të institucioneve t'i përgatisin rregullat dhe politikën e përgjithshme për komente kthyesë nga qytetarët të cilat do të funksionin në mënyrë digjitale në e-portalin e qeverisë dhe në anën tjetër do ta lehtësonin llogaridhënien e institucioneve.

²³ Intervistë me Fidan Kalaja (Prill, 2013).

Tabela 2. Integriteti publik i shtuar. Rreziqet dhe Mundësitë

Rreziqet	Mundësitë
<p>Ndikimi politik në punën e agjencive të pavarura e rrezikon besueshmërinë e institucioneve.</p> <p>Rreziku nga manipulimi i të dhënave të publikuara për hir të interesave politike.</p> <p>Ngurrimi i Qeverisë për t'i përfshirë organi zatat e shoqërisë civile në procesin e planifikimit.</p> <p>Rreziqet nga anshmëria e zgjedhjes kur përfshihen organizatat e shoqërisë civile.</p> <p>Rreziqet nga zbulimi i informatave në rastet e raportimit të korrupsionit dhe mos mbrojtja e informatorëve.</p> <p>Ekzistimi i korrupsionit në hije përkundër procedurave të duhura ligjore administrative. Mungesa e sanksioneve ligjore kundër keqpërdorimit të fondit publik mund ta rrisë rrezikun e vazhdimin të sjelljes së tillë.</p> <p>Shkalla e lirisë së veprimit që ju jepet zyrtarëve qeveritarë për t'u përgjigjur në kërkesat për të pasur qasje në dokumentet publike.</p> <p>Emërimi i individëve të lidhur me politikën në pozita të rëndësishme, siç është pozita e guvernatorit të Bankës Qendrore ose e shefit të Agjencisë së Privatizimit, do të kenë ndikim negativ në nivelin e besimit dhe të integritetit publik të institucioneve.</p> <p>Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e ligjeve dhe të strategjive por mos marrja parasysh e këndvështrimeve të tyre në rezultatet e këtyre proceseve do ta dobësojnë edhe më shumë besimin në institucione dhe do të kenë ndikim negativ në pjesëmarrjen publike në proceset e vendimmarrjes.</p> <p>Mungesat e platformës së informatave kthyesë online e dobëson shkallën e raportimit të shkeljeve institucionale</p>	<p>Rritja e efikasitetit të sundimit të ligjit gjatë procesit të integrimet në BE.</p> <p>Publikimi i të dhënave të detajuara nga të gjitha institucionet do të rris llogaridhënien institucionale.</p> <p>Përfshirja e rregullt e qytetarëve dhe e organizatave të shoqërisë civile në procesin e konsultimit duke u bazuar në procedurën e standardizuar.</p> <p>Krijimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse për informatorët do ta rrisë numrin e raportimit të rasteve të shkeljes. Për rrjedhojë, kjo do ta rris llogaridhënien e zyrtarëve publikë dhe të institucioneve.</p> <p>Procesi i standardizuar për qasje në dokumentet publike do ta zvogëlojë lirinë e veprimit të zyrtarëve qeveritarë kur të vendosin për lejimin e qasjes në dokumentet publike.</p> <p>Krijimi i një mekanizmi të informatave kthyesë online, i cili do të sigurojë fshehtësinë e informacioneve, do ta rris numrin e rasteve të raportuara të korrupsionit dhe shkeljet e tjera institucionale të lidhura me të.</p>

MENAXHIMI EFEKTIV I RESURSEVE PUBLIKE

Transparenca

Ndarjet buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë komunat, vendosen nga Ligji vjetor për ndarjet buxhetore i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës i cili ju jep organizatave buxhetore kompetenca për shpenzimin ose transferimin e fondeve publike, deri në një limit të caktuar dhe për qëllime specifike, gjatë një viti të caktuar fiskal²⁴.

Menaxhimi i përgjithshëm i financave publike në Kosovë është shqetësues. Kosovës i mungon stabiliteti makro-ekonomik sepse ajo kërcënohet nga politikat e paparashikuara fiskale. Edhe pse legjislacioni për menaxhimin e shpenzimeve publike ekziston dhe i përmban elementet e kërkuara me standarde ndërkombëtare; papajtueshmëritë mbeten ndërmjet legjislacionit të rreptë dhe zbatimit. Kapaciteti i Kosovës për të ofruar planifikime makro-ekonomike dhe fiskale është mjaft bazik. Në këtë rast, Ministria e Financave publikon rregullisht të dhëna për gjendjen ekonomike dhe fiskale në Kosovë, por planifikimet për buxhetin vjetor publikohen vetëm me dokumentet të cilat aprovohen nga qeveria (Sigma, 2011).

Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) i është ofruar mbështetje për rregullat e Thesarit, me udhëzimet për menaxhim dhe kontroll financiar, të cilat janë aprovuar pjesërisht nga Ministria e Financave më 2010. Me ndihmën e vazhdueshme teknike, dokumenti i politikave të KBFB është aprovuar nga qeveria në prill 2011 (BTI, 2012). Në mënyrë që KBFP të funksionojë plotësisht, ajo duhet të pranohet nga të gjitha ekipet e menaxhimit gjatë aktivitetëve të tyre të përditshme dhe nuk duhet të shihet si një kërkesë tjetër e BE-së.

Sipas hulumtimit të GAP-it (2013), mënyra aktuale e ndarjes buxhetore dhe raportimi buxhetor nuk është bërë në aq hollësi që do t'ua mundësonte deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve që ta kuptojnë qartë ndarjen dhe shpenzimin e parave publike. Në vend që ta rrisin raportimin transparent, Ministria e Financave (MF) e ka zvogëluar formatin e raporteve buxhetore në raporte tremujore dhe vjetore, duke e zvogëluar edhe më shumë transparencën dhe llogaridhënien për shpenzimin e parave publike. Në lidhje me hollësitë e raportimit, organizatat buxhetore nuk i publikojnë raportet e hollësishme të shpenzimeve në faqet e tyre. GAP (2013) zbulon se prej 19 ministrive në Qeverinë e Kosovës, vetëm Ministria e Drejtësisë i publikon rregullisht të dhënat për shpenzimet buxhetore të këtij institucioni. Ndërsa, institucionet e pavarura nuk i publikojnë raportet e ndara për shpenzimet buxhetore, por vetëm raportet vjetore të përmbushjes të cilat po ashtu përfshijnë një përshkrim të shkurtër të buxhetit të institucionit. Publikimi i shpenzimeve dhe i buxhetit duket të jetë më problematik në komuna. Prej 37 komunave në Kosovë, vetëm komuna e Malishevës ka publikuar raporte të herëpashershme për shpenzimet buxhetore, ndërsa shumica dërrmuese e komunave nuk e kanë publikuar buxhetin fare (GAP, 2013). Në raportin e njëjtë zbulohet se buxheti i Qeverisë së Kosovës shpesh ofron linja të përgjithshme buxhetore. Rastet e tilla janë ndarja e linjave buxhetore si investimet në komuna në bashkëfinancim me donatorët e tjerë pa e saktësuar komunën apo llojin e projektit. Një dobësi domethënëse në lidhje me transparencën e buxhetit është mospublikimi i propozimit të buxhetit të ekzekutivit deri sa të aprovohet. Për shkak të këtij gabimi në procesin e transparencës buxhetore,

²⁴ Nenet 1 dhe 20.9, Ligji Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, 3 qershor 2008.

Kosova nuk i fiton të gjitha pikët në lidhje me kriteret e OGP (PQH) të transparencës buxhetore. Buxheti i Kosovës bëhet publik për qytetarët në faqen e Ministrisë së Financave vetëm pasi që të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës.

Në procesin e planifikimit buxhetor organizohen dëgjime publike. Format më të përdorura të njoftimit publik për takimet e organeve kryesore legjislative ishin njoftimet në faqet komunale, njoftimet e vendosura në ndërtesat komunale dhe/ose në tabelat për informim publik, ose madje edhe në ekrane publike të paraqitjes së videove, duke i vendosur pllakatet apo njoftimet në vende publike, duke shpërndarë fletushka, duke transmetuar njoftime në radio dhe duke i dërguar ftesa drejtpërdrejt shoqërisë civile dhe organizatave të mediave (OSBE, 2012).

Eksplorimi, gërmimi dhe/ose përpunimi i një burimi mineral apo ndonjë aktivitet tjetër lidhur me minierat rregullohet me nenin 4 të Ligjit Nr. 03/L-163, i cili thotë që asnjë person nuk mund të kryejë asnjë aktivitet pa licencën ose lejen e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në pajtim me këtë ligj. KPMM i publikon në faqen e vet të internetit ftesat për investitorët, licencat e lëshuara, tenderët dhe vendet e lira të punës. Po ashtu mund të shkarkohen të gjithë formularët e aplikimit²⁵.

Kuvendi i Kosovës po ashtu e ka aprovuar Ligjin Nr. 03/L-090 mbi Partneritetin Publiko-Privat (PPP) dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre. Në nenin 6 të këtij ligji thuhet që partneritetet publiko-private dhe koncesionet jepen nga autoriteti publik i cili, bazuar në ligj, është drejtpërdrejt përgjegjës për aktivitetin ekonomik që është objekt i marrëveshjes. Sipas ligjit, është themeluar komisioni ndërministror PPP. Është publikuar marrëveshja PPP për funksionimin dhe zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës e vitit 2010²⁶.

Ndihma ndërkombëtare – Rishtazi Qeveria e Kosovës a ka aprovuar Rregulloren për bashkërendimin e donatorëve Nr.04/2011 e cila ka hyrë në fuqi më 3 qershor 2011. Të gjitha të dhënat për monitorimin dhe vlerësimin e tërë sistemit të bashkërendimit të donatorëve janë: të dhënat nga platforma e menaxhimit të ndihmës, të dhënat e tjera për shpenzimet publike dhe shfrytëzimi i fondeve të jashtme. Ndërsa indikatorët themelorë për matjen e rezultateve të sistemit për bashkërendimin e donatorëve janë të bazuara në Studimin e Deklaratës së Parisit (Nitaj, 2012). Vendet partnere dhe donatorët janë pajtuar ta mbajnë njëri tjetrin përgjegjës për shënimin e përparimit lidhur me zotimet dhe objektivat e dakorduar në Paris duke e mbikëqyrur zbatimin e tyre (OECD, 2008).

Raporti vjetor i Programit i BE-së (2013) vëren se njëra prej të metave të projekteve të mëparshme të ndihmës ishte mos lidhshmëria ndërmjet bërjes së politikave dhe procesit buxhetor. Deri më tani ndihma e donatorëve është përqendruar në institucionet individuale dhe në aspektet specifike të planifikimit. Projektet priren të përqendrohen në rëndësinë e të punuarit së bashku për t'i rritur dobitë që do të fitohen nga strukturat dhe proceset ekzistuese. Megjithatë, nevojitet mbështetje e mëtejshme në mënyrë që të vendoset një sis-

25 Shih <http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/en/home/news.html#LicensatANG>

26 Shih <http://www.pppkosova.org/repository/docs/PPP%20PIA%20Agreement%20Web.pdf>

tem më gjithëpërfshirës, i bashkërenduar dhe i qëndrueshëm i planifikimit strategjik dhe i bashkërendimit të politikave.

Pjesëmarrja publike

Ligji për vetëqeverisjen lokale dhe Udhëzimi Administrativ 2008/9 për transparencë në komuna, thonë që takimet e kuvendit komunal dhe të komisioneve të tij janë të hapura për publikun. Ndërsa Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë dhe qarkorja e buxhetit saktësojnë cilat forma të konsultimeve publike duhet të mbahen gjatë procesit të përgatitjes dhe aprovimit të buxhetit të ekzekutivit dhe të komunës (OSBE, 2012).

Në raportin e OSBE-së (2012) thuhet që pjesëmarrja në takimet publike ka ndryshuar shumë prej njërit takim në tjetrin. Prania e mediave në takimet publike është e ngjashme me praninë e tyre në takimet e kuvendit komunal. Zakonisht qytetarët nuk janë të informuar ose janë pjesërisht të informuar kur mbahen dëgjimet për buxhetin. Si pasojë e kësaj qytetarët e Kosovës të cilët e financojnë buxhetin e shtetit nuk e dinë si ndahet apo shpenzohet ai (OSBE, 2013). Në mënyrë që të rritet niveli i transparencës së sistemit buxhetor, duhet të ketë koherencë ndërmjet dokumenteve të buxhetit dhe objektivave të shpenzimeve. Filozofia e një buxheti vjetor të balancuar, çon tek teprica duke e pasur para sysh që shumë agjenci shpenzuese nuk kanë pasur kapacitete të duhura të prokurimit për t'i ndarë fondet në mënyrë efikase. Në lidhje me procedurat e prokurimit ekzistojnë disa parime të transparencës: drejtësia dhe paanshmëria, llogaridhënia dhe transparenca e procesit, fshehtësia dhe siguria e informatave dhe e materialeve dhe menaxhimi efektiv i konflikteve të interesit (AMCHAM, 2012).

Llogaridhënia

Buxheti i Kosovës ekzekutohet përmes sistemit qendror të thesarit dhe shfrytëzohet në të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë të gjitha komunat e Kosovës. Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave dhe është përgjegjëse për blerjen qendrore dhe të bashkërenduar por po ashtu edhe për mbështetjen e autoriteteve kontraktuese me ekspertizë profesionale.

Përgatitja e buxhetit të Kosovës dhe planifikimi i tij bazohet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë²⁷. Në pajtim me udhëzuesin për buxhetin e Kosovës dhe procesin e planifikimit (f.11), buxheti i Kosovës aprovohet deri në fund të vitit nga Kuvendi i Kosovës. Buxheti përgatitet përmes një numri veprimesh të njohura si proces buxhetor. Deri sa ta arrijë formën përfundimtare si projektligj për buxhet, dhe para se të dorëzohet për aprovim në Kuvend, procesi buxhetor zakonisht kryhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe organizatave buxhetore (GAP, 2013).

²⁷ Ligji nr. 03/L-048 Menaxhimi i financave publike dhe përgjegjësitë, neni 1

Qasja e politikës fiskale i ka rritur deficitet buxhetore dhe i ka kufizuar opcionet e financimit (Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën, 2011). Të shfrytëzuarit e euros si valutë zyrtare e ka lidhur shkallën e inflacionit të Kosovës me shkallën e inflacionit të euro zonës. Kështu, ndryshimet në çmimet globale kanë kontribuar në një shkallë më të lartë të inflacionit në Kosovë (BTI, 2012). Qeveria e Kosovës vendosi ta tejkalojë kornizën afatmesme të shpenzimeve për t'i rritur pagat e nëpunësve civilë dhe të personelit shëndetësor për 50% deri në fund të vitit 2010. Shpenzimet u kritikuan shumë nga FMN si një qasje ad-hoc ndaj politikave fiskale. Për më tepër, vazhdon të rritet ndjenja e qytetarëve se janë të përjashtuar nga proceset buxhetore dhe fiskale (BTI, 2012). Kjo po ashtu vazhdoi ta rrisë barrën në doganën kufitare për ta mbushur buxhetin e shtetit.

Auditori i Përgjithshëm auditon buxhetin e Kosovës rregullisht; megjithatë, në realitet shumica e parregullsive që zbulohen nuk çojnë tek sanksionet ligjore. Në lidhje me monitorimin dhe llogaridhënien, zyra e auditorit të jashtëm ka vazhduar ta rrisë numrin e personelit dhe ta përmirësojë funksionimin, ndërsa roli i saj është bërë më kuptimplotë për organizatat qeveritare. Ndër vite është rritur intensiteti i auditimit dhe zyra e auditorit të përgjithshëm ka filluar t'i auditojë edhe ndërmarrjet shtetërore. Mbikëqyrja e respektimit të afateve të fundit të lidhura me zhvillimin e buxhetit nga ana e komunave, mund të vihet në pikëpyetje. Edhe pse shumica e kryetarëve të komunave nuk e kanë dorëzuar propozimin e buxhetit në kuvendin komunal në afat, Ministria nuk e ka përmbyllur obligimin e saj ligjor për emërimin e një administratori financiar komunal në ndonjërin prej komunave të prekura (OSBE, 2012)

Në lidhje me procesin e prokurimit publik, organet monitoruese duhet të forcohen dhe t'i rrisin kapacitetet e tyre. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) i cakton rregullat për zbatim dhe është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të Prokurimit Publik të Kosovës. Agjencia për Prokurim Publik (APP) është përgjegjëse për organizimin e blerjes së bashkërenduar, ndërsa Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është përgjegjës për shqyrtimin e procedurave. Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është përgjegjës për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit publik.

Në mesin e çështjeve të tjera, korrupsioni në sistemin e prokurimit është bërë një fenomen i pranueshëm. Me kalimin e viteve, komuniteti i biznesit (AMCHAM) ka ushtruar shumë ankesa në lidhje me parregullsitë procedurale dhe korrupsionin. Rasti më i ri i madh i korrupsionit është zbuluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht, në lidhje me procesin e shtypjes së pasaportave biometrike. Pretendimet i referohen vlerës së korrupsionit deri në 10% të vlerës së përgjithshme të tenderit. Në frymën e të gjitha mundësive të korrupsionit, shumë vende e kanë krijuar të ashtuquajturën listë të zezë në të cilën përfshihen kontraktuesit të cilët në një periudhë të caktuar ju kanë dhënë mitë zyrtarëve, janë marrë vesh për çmime, kanë ofruar mallra dhe shërbime të nën-kontraktuara ose e kanë shkelur ligjin në ndonjë mënyrë. Në këtë mënyrë janë eliminuar konkurruesit jo të drejtë, duke e mundësuar një procedurë më të drejtë, transparente dhe të hapur të prokurimit publik (AMCHAM, 2012). Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar ligjin e ri për prokurimin publik më 2011 dhe ai ka hyrë në fuqi në po atë vit. Në nenin e parë të artikullit thuhet qartë që qëllimi i ligjit është të sigurojë shfrytëzim më efikas, më fitimprurës, më të drejtë dhe më transpar-

ent të fondeve publike duke vendosur rregulla dhe procedura (AMCHAM). Janë nxjerrë po ashtu edhe shumë akte nënligjore, siç janë:

- Rregullorja e prokurimit dhe udhëzimet operacionale
- Dokumentet standarde të tenderimit dhe formularët
- Rregulloret për menaxhimin e kontratës
- Kodi i etikës i prokurimit
- Dokumenti për misionet diplomatike të Kosovës (AMCHAM, 2012)

Faza e tretë e projektit të BE-së “Reforma e Sistemit të Prokurimit Publik” prej vitit 2009 deri më 2011 ofroi shumë mbështetje, e cila më vonë nuk u mor parasysht. Deri në fund të vitit 2011 KRRPP aprovoi mbi 70 akte nënligjore që merren me procedurat e prokurimit si dosje të tenderit, Kodin e Etikës të Prokurimit dhe të tjera, përveç Ligjit për prokurimin publik Nr. 04/L-042. Ligji i ri është kompleks, në veçanti për kontratat me vlerë të mesme dhe të vogël dhe ende shfrytëzon aprovimin e APP për procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit, ose për procedurat e mos anulimit. Këto kërkesa krijojnë probleme burokratike. Në mesin e akteve nënligjore siç është Rregullorja e Prokurimit dhe Udhëzimet Operacionale dhe rregullorja e punës e KRRPP-së me Udhëzimet Operacionale kanë hyrë në fuqi më 2012 (AMCHAM, 2012). Edhe pse ishin bërë përpjekje për t’i arritur standardet e BE-së, Ligji i mëparshëm për Prokurimin Publik megjithatë nuk ishte në gjendje t’i plotësonte standardet e caktuara.

Teknologjia dhe inovacioni

Pjesa kryesore e reformës buxhetore u arrit me ndryshimet e bëra në ekzekutimin e buxhetit të cilat kanë të bëjnë me procedurat ex-ante të kontrollit të pagesave të Thesarit. Përgjegjësinë për pagesat e ligjshme e kanë organizatat e ligjshme, ndërsa thesari ushtron kontroll të kufizuar për t’u siguruar që shpenzimet janë në pajtueshmëri me buxhetin e aprovuar. Për ta mbështetur kontrollin e pagesave në procesin e decentralizimit që filloi më 2009 dhe përfundoi më 2010, Thesari themeloi një tavolinë ndihmëse dhe funksione të monitorimit të thesarit (Sigma, 2011).

Në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar (MKF), përqendrimi duhet të jetë në menaxhimin e sigurt dhe efikas të sistemeve informative të menaxhimit financiar. Këtu duhet të përfshihen po ashtu edhe masat e mira të planifikimit dhe të raportimit. Duhet të përmirësohet trajnimi i duhur për shfrytëzimin e procedurave të raportimit. Ofrimi i ndihmës teknike për kontrollin financiar në organizatat e deleguara ka përfunduar në verën e vitit 2011 (Sigma, 2011). Si të tilla procedurat e mësuara duhet të merren parasysht për të siguruar konsekuencë dhe transparencë, ndërsa në secilin institucion duhet të krijohen dhe të standardizohen mekanizmat e informatave kthyese. Deri më tani, vetëm disa institucione kanë modul të informatave kthyese. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dha

një shembull të mirë duke e krijuar një modul online të informatave kthyesë, ku qytetarët mund ta raportojnë çdo veprim të paligjshëm në lidhje me dëmtimin e lumenjve, të pyjeve ose për ndërtimet pa leje.

Tabela 3. Menaxhimi efektiv i resurseve publike. Rreziqet dhe Mundësitë

Rreziqet	Mundësitë
<p>Raportimi aktual buxhetor nuk është i lehtë për t'u kuptuar nga qytetarët. Kështu mund të jetë edhe në rastin e disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës kur është fjala për ndarjen dhe shpenzimin e parave publike.</p> <p>Politikat e paparashikueshme fiskale mund të çojnë tek jo stabiliteti makro-ekonomik.</p> <p>Në shqyrtimet e buxhetit pjesëmarrja e qytetarëve është e vogël; kjo mund të shkaktojë rrezikun që mjetet e buxhetit të mos ndahen për çështjet të cilat qytetarët i konsiderojnë vendimtare.</p> <p>Përjashtimi i qytetarëve nga krijimi i politikave dhe i buxhetit mund të çojë tek ajo që publiku të mos ndjejë se i zotëron asetet publike si edhe tek rritja e ekonomisë joformale nëse ata nuk shohin vlerë në pagimin e taksave dhe në ligj.</p> <p>Mundësia për lirinë e veprimit të zyrtarëve të prokurimit publik.</p>	<p>Publikimi i propozimit të buxhetit të ekzekutivit deri sa është në procesin e aprovimit do ta rrisë transparencën dhe do t'i përfshijë qytetarët dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile në fazën e hershme të planifikimit të buxhetit.</p> <p>Publikimi i shpenzimeve të hollësishme buxhetore në bazë akruale do ta rrisë llogaridhënien e zyrtarëve publikë kur shpenzohen paratë publike.</p> <p>Përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të funksionimit të sistemit të prokurimit publik janë me rëndësi themelore për sigurimin e procedurave profesionale dhe transparente të prokurimit.</p> <p>Zbatimi i e-prokurimit do ta ulë nivelin e lirisë së veprimit të zyrtarëve të prokurimit.</p>

KOMUNITETET E SIGURTA

Transparenca

Në prill 2007, Martti Ahtisaari dorëzoi planin e tij për zgjidhjen e statusit të Kosovës në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Pjesë e këtij plani 15 pikësh ishte po ashtu edhe decentralizimi komunal i Kosovës. Ahtisaari propozon kompetenca më të gjera komunale në të cilin rast komuniteti serb do të ketë kontroll në shëndetësi, në arsimin e lartë, polici, çështje kulturore, trashëgimi kulturore serbe e kështu me radhë. Për më tepër, kjo siguron që komunitetet e populluara me serbë do të kenë autonomi të lartë financiare, mund të pranojnë financim nga Serbia dhe mund të përfitojnë nga partneriteti dhe bashkëpunimi me institucionet e Serbisë. Sipas planit Ahtisaari, janë parashikuar 6 komuna të populluara me serbë: Graçanica, Novo Bërda, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Mitrovica-Veri. Plani është përqendruar në mbrojtjen e të drejtave, kulturës dhe identitetit të komuniteteve pakicë në Kosovë dhe po ashtu të siguruarit e vendosjes së një pjesëmarrjeje aktive në jetën publike (Përmbledhje e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 2009). Në bisedimet e fundit politike, të mbajtura ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, është aprovuar një plan 15 pikësh nga të dy palët, i cili garanton të drejta për pakicën serbe.

Pakica serbe në Kosovë e ka po ashtu një numër të rezervuar të vendeve në parlament. Të zgjedhurit në parlament i përfaqësojnë interesat e popullsisë dhe si të tilla të drejtat e serbëve në parlament janë të mbrojtura sepse ata i kanë 20 vende të rezervuara në parlament duke shprehur mendimin e pakicës. Në Kuvendin e Kosovës është propozuar Komisioni i përhershëm për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, i cili do të ndihmojë në garantimin e interesave jetike të komuniteteve në procesin e hartimit të ligjeve. Përfaqësimi i komuniteteve garantohet edhe në nivel ekzekutiv, duke ja ofruar një ministri komunitetit serb dhe një tjetër një komuniteti jo shumicë. Në sistemin gjyqësor, së paku 15 % e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Kosovës duhet të jenë nga komunitetet pakicë (Beha, 2011). Këtu përfshihet një përfaqësim i gjerë i pakicave në ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor që ka për qëllim zbatimin e ligjeve që janë gjithëpërfshirëse dhe demokratike për të gjitha nacionalitetet.

Përveç komunave në veri të Kosovës, janë themeluar dhe janë duke funksionuar komuna të tjera të decentralizuara. Megjithatë, në këto faqe të internetit është publikuar një numër i kufizuar i dokumenteve. Në faqen e komunës së Graçanicës, buxheti komunal nuk publikohet fare. Përgjithësisht jepen vetëm informata përkthuese për shërbimet e ofruara nga komuna.

Sigurinë dhe integritetin territorial të Kosovës e mbron misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR-i. Ata e bashkërendojnë punën e tyre me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in. Pjesa më e madhe e personelit siç janë gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët policorë dhe doganorë janë nga EULEX-i, sidomos në veri të Kosovës dhe ata përpiqen t'i rregullojnë aktivitetet e ligjshme brenda këtyre territoreve. Në të vërtetë, mandati kryesor i EULEX-it është t'i luftojë krimet e luftës, krimin e organizuar dhe korrupsionin në Kosovë (SIGMA, 2011).

Policia vendase është pjesë e Shërbimit Policor të Kosovës në mbarë territorin e Kosovës, por përbërja e saj duhet të korrespondojë me përzierjen etnike lokale dhe komandanti i

policisë lokale rekomandohet nga komuna. Organet e qeverisë qendrore dhe të gjyqësorit po ashtu duhet ta pasqyrojnë përbërjen etnike të Kosovës. Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës i garantojnë të drejtat e pakicave. Ligjet me interes të posaçëm për pakicat mund të aprovohen vetëm nëse shumica dërrmuese e përfaqësuesve të pakicave në parlament votojnë për to. Objektet fetare dhe kulturore serbe dhe komunitetet në Kosovë mbrohen me ligj. Të gjitha dokumentet janë në dispozicion në faqet e internetit të institucioneve relevante. Ministria për Komunitete dhe Kthim publikon në faqen e saj dokumentet relevante për kthimin e komunitetit serb të Kosovës në Kosovë. Po ashtu publikohen edhe projektet, tenderët dhe mundësitë për punësim.

Mitrovica perceptohet si rajoni më i pasigurt dhe jo vetëm prej serbëve. Pas vitit 2008, këtë besim për rrezikun dhe dhunën në atë rajon e kanë forcuar ngjarjet e motivuara politikisht. Më 2009, Qendra për të Drejtën Humanitare nxori një raport për sigurinë dhe të drejtat e njeriut në të cilin thekson se gjendja në Mitrovicë është e tendosur dhe që pjesëtarët e të gjitha grupeve etnike ndjehen të pasigurt atje. Në këtë rast, serbët e Kosovës i kanë identifikuar disa prej çështjeve më problematike të cilat i bëjnë ata të ndjehen të pasigurt, duke filluar nga: problemet ndëretnike (53.5%), por ata në masë të madhe pajtohen me grupet e tjera lidhur me shqetësimet e tjera për sigurinë siç janë shqetësimet ekonomike, mjedisore, krimi, dhe kështu me radhë. Marrëveshja e fundit ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve kanë krijuar mundësi për përfshirjen e qytetarëve serbë të Kosovës në veri të Kosovës në sistemin juridik të Kosovës. Kjo mund t'i qetësojë tensionet në veri dhe krijon mundësi për themelimin e institucioneve formale në komunat veriore. Njëra prej marrëveshjeve ishte të themelohej një fond i pavarur zhvillimor për veriun e Kosovës. Përveç pajtimit që fondi do të menaxhohet në mënyrë të pavarur nga buxheti i Kosovës dhe do të ketë një bord drejtues të përbërë nga një përfaqësues i BE-së, një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës dhe një përfaqësues i komunitetit vendas serb, hollësitë e tjera lidhur me këtë janë ende të dykuptueshme.

Pjesëmarrja publike

Procesi i decentralizimit ka qenë i suksesshëm në krijimin e komunave të reja serbe dhe si i tillë ka pasur për rezultat një pjesëmarrje të lartë të serbëve për të votuar në zgjedhjet komunale 2009, në veçanti në jug të lumit Ibër. Çështja është se zbatimi i plotë varet nga financimi i strukturave të reja administrative dhe nga aftësia e misioneve ndërkombëtare për ta kthyer sundimin e ligjit në zonat veriore. Decentralizimi është zgjeruar me themelimin e komunës së Hasit. Procesi i decentralizimit ka për qëllim që komunat të jenë më afër qytetarëve të tyre dhe ta rrisë sasinë e shërbimeve publike dhe të vendimmarrjes së pavarur.

Me kalimin e viteve, Kosova ka pasur për qëllim ta përmirësojë sigurinë e qytetarëve të të gjitha përkatësive etnike dhe duke qenë kështu ka krijuar strategji për sigurinë e komu-

niteteve të cilat nuk kanë qenë shumë të suksesshme në arritjen e synimit të tyre. Strategjia e fundit për sigurinë e komuniteteve për vitin 2011-2016, është aprovuar me mjaft sukses. Në strategjinë e re përfshihet një koncept i ri për sigurinë e komunitetit në të cilin rast formohet partneriteti ndërmjet autoriteteve të sigurisë dhe qytetarëve të Kosovës ku është më e lartë përfshirja e planifikimit dhe e vendimmarrjes së qytetarëve kur është në pyetje krijimi i një mjedisi të sigurt. Në këtë mënyrë, qytetarët i ndajnë përvojat dhe shqetësimet e tyre që jo vetëm se e bën këtë strategji gjithëpërfshirëse por po ashtu edhe më të besueshme dhe më të suksesshme për t'u zbatuar. Janë caktuar objektivat e sigurisë si pjesë e kësaj strategjie të sigurisë dhe kjo është bërë përmes përfshirjes së qytetarëve në shtatë komunitat kryesore, institucionet qendrore, të shoqërisë civile, OJQ-ve vendase dhe organizatave ndërkombëtare; që do të thotë që strategjia është gjithëpërfshirëse (Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimtimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016, 2011).

Pjesë e kësaj strategjie të re është po ashtu edhe policimi në komunitet që nënkupton planifikimin vjetor të patrullimeve dhe shfrytëzimin e formave të reja të raportimit për patrullime. Këto reforma janë futur në përdorim në mënyrë të suksesshme në stacionet policore. Tani në shumë lagje vërehen patrullimet e policisë që kujdeset për mirëqenien e qytetarëve. Arritja e kësaj strategjie është po ashtu plani për zvogëlimin e krimeve kryesore, përmirësimi i procedurave operacionale për përkufizimin e kategorive dhe të përkatësisë etnike të viktimave, përmirësimi i raporteve për krimet, dhe kështu me radhë. Në këtë mënyrë mund të regjistrohen statistika të qarta lidhur me konfliktin në grupet e caktuara etnike. Po ashtu është arritur përparim në menaxhimin e përmirësuar të patrullimeve, në veçanti pasi që është bërë përfshirja dhe konsultimet me komunitetin vendas (Raporti i Programit i EULEX-it, 2011).

Në lidhje me perceptimet e komunitetit lidhur me sigurinë, gjatë tërë dekadës së kaluar janë zhvilluar sondazhe të ndryshme për matjen e nivelit të ndjenjës së sigurisë dhe të qetësisë të cilën qytetarët e Kosovës besojnë se e kanë. Rezultatet e sondazhit, të cilat japin të dhëna për periudhën para vitit 2009, zbulojnë se serbët e Kosovës që nuk ndihen të sigurt pajtohen me pjesën tjetër të popullsisë për shqetësimet themelore lidhur me sigurinë. Kjo do të thotë që në nivelin lokal shqetësimet për sigurinë janë të përbashkëta dhe po ashtu janë shumë të ngjashme krahasuar me komunat e tjera. Kur të analizohen të dhënat statistikore është shumë vështirë të përcaktohen këndvështrimet e popullsisë serbe meqë koncepti i tyre për qeverisjen qendrore dhe lokale, policinë dhe gjykatat është i ndryshëm nga ai i pjesës tjetër të popullsisë dhe mjaft shpesh dallon madje edhe ndërmjet komunave serbe në Kosovë (Anna Di Lellio, 2009).

Më 2011 janë zhvilluar sondazhe të tjera të cilat zbulojnë rezultate të tjera nga vitet paraprake. Së pari, besimi i përgjithshëm në siguri, si për institucionet kombëtare ashtu edhe për ato ndërkombëtare është ulur në mënyrë drastike. Niveli i besimit në Policinë e Kosovës ka rënë po ashtu duke renditur çështje si: korrupsioni, nepotizmi, mungesa e kapacitetit për të intervenuar, mbërritjet me vonesë në rastin e thirrjeve urgjente dhe kështu me radhë. Në anën tjetër, serbët e Kosovës kryesisht ju besojnë policëve serbë dhe do të donin të merreshin kryesisht me ta. Kjo rregullohet me ligj pasi që struktura e Forcës Policore të Kosovës

është e përfaqësuar proporcionalisht nga etnitë që jetojnë në komunat përkatëse. Llogaridhënia

Në vitet e fundit Kosova ka transferuar një numër të kompetencave politike, fiskale dhe administrative prej nivelit qendror në nivelin lokal të qeverisjes si pjesë e procesit gjithëpërfshirës të decentralizimit. Ky proces është në pajtim me parimet e Kartës Evropiane të Këshillit të Evropës për Vetëqeverisje Lokale dhe të Protokolleve të saj (OSBE, 2012).

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë siguron pavarësi financiare të institucioneve komunale. Këto institucione ia dorëzojnë krejt kërkesat e tyre Kuvendit të Kosovës, të cilat pastaj analizohen, prezantohen dhe aprovohen në Asamblenë e Përgjithshme të Kosovës. Shumë komuna pranojnë po ashtu mbështetje të donatorëve dhe kjo ju jep atyre fonde zhvillimore shtesë. Megjithatë, nuk ka ndonjë model të unifikuar të mbledhjes së financave dhe varet prej komunës në komunë (SIGMA, 2011).

Mekanizmat institucionalë që merren me sigurinë e komunitetit janë: Ministria e Punëve të Brendshme - Departamenti për siguri publike – Sektori për Siguri të Komunitetit, Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, Policia e Kosovës, Ministria e Administrimit dhe e Qeverisjes Lokale – Departamenti për vetëqeverisje lokale, Ministria e Administrimit dhe e Qeverisjes Lokale – Departamenti për hetim dhe reformë të qeverisjes lokale, Agjencia për menaxhimin e emergjencave, Asociacioni i komunave të Kosovës, Këshillat komunalë për siguri në bashkësi, ekipet e veprimit për siguri në bashkësi dhe Këshillat komunalë për siguri publike (Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016, 2011). Ministria për Pakicë dhe Këshilli Konsultativ për Pakicat janë në mënyrë specifike për sigurinë dhe nevojat e pakicave.

Korniza ligjore që merret me sigurinë publike është: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-035 për Policinë e Kosovës, Ligji nr. 02/L-70 për sigurinë në komunikacion, Ligji nr. 02/L-41 për mbrojtje nga zjarri, Ligji nr. 03/L-143 për armët, Udhëzimi Administrativ nr.08/2009 MPB-02/2009 MAPL për këshillat komunalë për siguri në bashkësi (Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016, 2011).

Në lidhje me katastrofat e mjedisit, Kosova është e ekspozuar ndaj tërmeteve, vërshimeve dhe zjarreve të pyjeve. Një rrezik të konsiderueshëm paraqesin edhe shembjet e tokës, thatësia, të reshurat e mëdha të borës dhe shpërthimet e pendave të rezervuarëve të ujit. Këto rreziqe paraqesin kërcënim të përhershëm për qytetarët e Kosovës (UNDP, 2011). Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) funksionon me misionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Fushëveprimi i saj është t'i mbështesë qytetarët dhe ekipet e intervenimit të parë për të siguruar një ekip për veprim të përbashkët, në ndërtimin, përmirësimin dhe mbajtjen e kapacitetit të nevojshëm për përgatitjen, mbrojtjen, reagimin dhe përmirësimin nga të gjitha llojet e rreziqeve.

Shërbimi i zjarrfikësve dhe i shpëtimit është themeluar për t'i luftuar fatkeqësitë e zjarrit dhe ato natyrore që ndodhin në Kosovë. Është pjesë e Departamentit për menaxhimin

e emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme por funksionon nën përgjegjësinë e komunave përkatëse. Këto shërbime po ashtu përgjigjen në raste të tjera të emergjencave, siç është tërmeti, vërshimet dhe rastet e tjera që kërkojnë mbrojtje të civilëve. Linjat telefonike të brigadave të zjarrfikësve në secilën komunë publikohen në e-portalin e qeverisë.

Teknologjia dhe inovacioni

Deri tani, në shumicën e komunave të Kosovës janë themeluar forume të sigurisë të cilat kanë për qëllim adresimin e shqetësimeve sociale dhe komunale të cilat mund t'i kenë qytetarët (Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016, 2011). Zhvillimi i teknologjisë informative dhe komunikimit (TIK) paraqet një funksion vendimtar për organizatat e përditësuara policore. Kjo ka qenë e vështirë të instalohet në Policinë e Kosovës, në veçanti kur është fjala për kapacitetet njerëzore që e menaxhojnë TIK. Deri më tani policia e Kosovës ka arritur të ketë vetëm element dhe zhvillim të qëndrueshëm të TI-së. Një ekspert i TI-së nga Komisioni Evropian, TAIEK, u soll në Kosovë me kërkesë të drejtorisë së policisë së Kosovës në mënyrë që të ndihmojë në avancimin e sistemit të TIK. Ky ekspert, në bashkëpunim me drejtorin e TI-së të Policisë së Kosovës, zhvilloi një plan pesë vjeçar strategjik për sistemet TIK, i cili duhet t'i trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me TI dhe bazë të të dhënave të qëndrueshme (Raporti i Programit i EULEX-it, 2011).

Tabela 4. Komunitetet e sigurta. Rreziqet dhe Mundësitë

Rreziqet	Mundësitë
<p>Mungesa e të dhënave transparente do të ndikojë në besimin e qytetarëve në institucionet lokale.</p> <p>Nuk janë të gjithë qytetarët në dijeni për punën të cilën kryen secili institucion dhe kjo paraqet rrezik që ata të mos dinë ku t'i drejtojnë problemet e tyre.</p> <p>Ende ka rrezik nga konflikti ndëretnik, sidomos në veri të Kosovës.</p> <p>Për shkak të arsyeve të paraqitura si: korrupsioni, nepotizmi dhe mungesa e kapacitetit për të intervenuar, mund të jetë shumë vështirë që institucionet e Kosovës për siguri ta kërkojnë sërish besimin e qytetarëve.</p> <p>Marrëveshja e Qeverisë së Kosovës me Qeverinë e Serbisë për ta krijuar një fond zhvillimor për veriun e Kosovës mund ta krijojë një burim tjetër për korrupsion nëse në procesin e menaxhimit nuk zbatohet transparenca e plotë.</p> <p>Mungesa e të dhënave publike për ndotjen e mjedisit e ndarë sipas rajoneve kërcënon sigurinë në bashkësi meqë ata nuk janë në dijeni për problemet dhe nuk janë në gjendje të japin informata kthyesë në këtë aspekt.</p> <p>Zbatimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për integrimin e institucioneve komunale të veriut në legjislacionin e Kosovës mund të kundërshtohet nga komuniteti i serbëve të Kosovës në veri.</p>	<p>Procesi i decentralizimit ua mundëson udhëheqësve komunalë të jenë më afër qytetarëve të tyre dhe ta rrisin cilësinë e shërbimeve publike. Së fundi, qeveria vendosi ta krijojë komunën e Hasit në rajonin e Prizrenit.</p> <p>Përbërja e forcës lokale të policisë sipas përbërjes etnike e rritë besimin në polici dhe sigurinë e komuniteteve.</p> <p>Policimi në bashkësi duhet të mbështetet me të dhëna të publikuara statistikore të ndara sipas komuniteteve/lokaliteteve.</p> <p>Decentralizimi i shërbimeve për mbështetje emergjente siç janë zjarrfikësit në nivel komunal e rritë mundësinë për mbështetje të qytetarëve për shërbimin dhe e rritë sigurinë në bashkësi.</p> <p>Zbatimi i mundshëm i marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (integrimi i komunave veriore) do ta krijojë një mjedis më të favorshëm dhe më të sigurt në përgjithësi meqë mund t'i zbusë marrëdhëniet ndëretnike.</p>

LLOGARIDHËNIA E SHTUAR E KORPORATAVE

Ligji për Ndërmarrjet Publike (NP), i aprovuar më 2008 dhe i ndryshuar më 2012, e rregullon çështjen e qeverisjes së korporatave duke u mbështetur në parimet e OECD-së dhe të praktikave të tjera ndërkombëtare. Ligji parashikon që të gjithë aksionarët, pavarësisht nga madhësia e pronësisë së tyre, duhet të trajtohen njësoj dhe që NP-të i nënshtrohen trajtimit dhe kornizës së njëjtë ligjore si edhe ndërmarrjet private. Koncepti i qeverisjes së korporatave është relativisht i ri në Kosovë dhe nuk është zbatuar shumë. Në procesin e privatizimit është diskutuar gjerësisht për përmendjen e metodave alternative të privatizimit por nuk është përfshirë si faktor kryesor në menaxhimin e kompanive. Në kompanitë private, koncepti i qeverisjes së korporatave është i lidhur me mungesën e bursës dhe të rregulloreve specifike për kompanitë private (Task Forca për Integrim në BE, 2012). Prandaj, grupi i vetëm i kompanive që pritet ligjërisht të veprojnë në pajtueshmëri me këto parime janë ndërmarrjet publike (NP). Për shkak të tipareve të tyre specifike, mënyra si drejtohen këto kompani, të cilat ua ofrojnë qytetarëve të Kosovës shërbimet themelore publike, është me rëndësi kryesore. Ndërsa, pritet që vetëm disa kompani private të veprojnë në pajtueshmëri me standardet e qeverisjes së korporatave.

Transparenca

Disa prej parimeve kryesore në këtë fushë përfshijnë²⁸:

Bordet duhet të jenë të balancuara ndërmjet drejtorëve ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë, ndërsa rolet e kryesuesit dhe të kryeshefit ekzekutiv duhet të jenë të ndara. Përbërja e jo-ekzekutivit të drejtorëve në Bord duhet të bazohet në kriterin e kualifikimit, të përvojës, profesionalizmit, pavarësisë dhe llojllojshmërisë së kandidatëve. Politika për pagat dhe shpërblimin e drejtorëve duhet të jetë transparente. Kompanitë duhet të kenë plan për menaxhimin e rrezikut dhe duhet të monitorohen nga bordet e tyre. Duhet të shmanget konflikti i interesit në çdo aspekt. Kompanitë që janë në interes publik duhet ta themelojnë një komision të auditimit, i cili i jep këshilla Bordit. Sa i përket transparencës, qasja e BE-së kërkon që kompanitë të bëjnë raportim periodik financiar dhe paraqitje të aksioneve të mëdha.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës thuhet që “Republika e Kosovës është pronare e të gjitha ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, të cilat njihet si NP... Të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi do të jenë obligime të Republikës së Kosovës ... Të drejtat pronësore të një NP-je që ofron shërbime vetëm në komunën specifike ose në një numër të kufizuar të komunave do t’i përkasin asaj/atyre komunave, ... si edhe detyrimet përkatëse ...”. NP-të në Kosovë janë të ndara në Ndërmarrje Publike Qendrore (NPQ) të cilat Qeveria mund t’i privatizojë, t’i jap me koncesion ose me qira, dhe në Ndërmarrje Publike Komunale (NPK) ku komunat kanë pronësi, ashtu siç përkufizohet me Ligjin 04/L-111 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nrt.03/l-087 mbi ndërmarrjet publike (Task Forca për Integrim në BE, 2012).

²⁸ Qasja e BE-së ndaj qeverisjes së korporatave, 2008, f.5-8.

Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) e themeluar sipas nenit 37 të Ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e NP-ve. Monitorimi përfshin mbledhjen e të dhënave, analizat dhe rekomandimet në lidhje me çështjet e NP-ve të cilat janë në kompetencë të ministrisë dhe të Qeverisë. NJPMNP i ofron mbështetje departamentit për çështje buxhetore të NP-ve dhe funksionon nën Ministrinë për Zhvillim Ekonomik (MZHE). Ka një drejtor menaxhues, një asistent dhe 5 analistë ekonomikë të trajnuar në nivel të lartë profesional²⁹.

NJPMNP e ka krijuar një faqe zyrtare të internetit në të cilën është e obliguar që vazhdimisht t'i ngarkojë dhe përditësojë të gjitha dokumentet dhe informatat e rëndësishme të NP-ve. Këto dokumente duhet të jenë në dispozicion të publikut për një periudhë pesë vjeçare. Sa i përket transparencës, NJPMNP publikon në faqen e internetit dokumente relevante për të gjitha ndërmarrjet publike siç është: raporti për kompensimin që ju është paguar zyrtarëve të lartë, numri i të punësuarve dhe organogrami dhe plani i biznesit. Dokumentet e tjera të rëndësishme që publikohen janë statuti dhe procedurat e tyre, kodi etik, vendimet që kanë të bëjnë me qeverisjen, etj. Informatat e ngjashme publikohen në faqet e internetit të NP-ve individuale.

Institucionet e tjera të përfshira në monitorimin e aktiviteteve të NP-ve janë agjenci të pavarura si Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) sa i përket prokurimit publik. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) e kryen auditimin e ligjshmërisë së buxhetit të konsoliduar të Kosovës, të organizatave të tij buxhetore dhe të institucioneve të tjera të cilat e marrin më shumë se 50% të buxhetit të tyre nga buxheti i Kosovës; Ndërsa, Komisioni i Kosovës për Konkurrencën (KKK) i monitoron rregullat e konkurrencës si një organ pothuaj juridik (Task Forca për Integrim në BE, 2012). Roli i komisionit të konkurrencës është i rëndësishëm meqë industritë kryesore të monopolit të cilat funksionojnë në Kosovë ju përkasin ndërmarrjeve publike, domethënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Transmisionit Elektrik të Kosovës, Operatorit të Sistemit dhe Tregut (KOSTT), Hekurudhave të Kosovës (HK), Aeroportit Ndërkombëtar të Kosovës (ANK), në mes tjerash (BTI, 2012). Rishtazi janë privatizuar dy kompani publike, Posta dhe Telekomit të Kosovës (PTK) dhe Kompania e Kosovës për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS). Disa organizata e kanë humbur statusin e tyre të monopolit, siç është PTK-ja, kur autoritetet filluan të lëshojnë licenca për operatorë privatë të telekomunikacionit. Megjithatë, shumica e kompanive të tjera publike, siç është KEK-u, ANP, HK dhe KOSTT ende e kanë mbajtur statusin e monopolit në tregjet e tyre. Vetëm KEK-u dhe PTK-ja janë dy punëdhënësit më të mëdhenj komercialë në Kosovë, me më shumë se 3,000 të punësuar. Në anën tjetër, PTK-ja dhe ANP-ja janë kompanitë më fitimprurëse, me përfitime të kombinuara neto prej më shumë se 50 milionë euro (44 milionë euro për PTK-në dhe 10 milionë euro për ANP-në) (BTI, 2012).

Sipas Riinvest-it (2012), aktorët relevantë e kontestojnë bazën ligjore sipas së cilës është bërë procesi i privatizimit. Privatizimi i telekomit është futur si pjesë e ligjit për buxhetin 2011. Ky ligj skadoi më 31 dhjetor 2011 dhe si i tillë nuk mund të shfrytëzohet si bazë për

29 (MED - <http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/?page=1,2>)

vazhdimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pavarësisht nga kjo, qeveria e ka aprovuar privatizimin e Telekomit të Kosovës. NJPMNP nuk është e përfshirë drejtpërdrejt në procesin e privatizimit. Ky proces zhvillohet ekskluzivisht nga Komisioni për Privatizim i Qeverisë (në lidhje me kompetencat e këtyre komisioneve shih Riinvest, 2009).

Zgjedhja e anëtarëve të bordit mbetet njëra prej çështjeve më të kundërshtuara në qeverisjen e NP-ve në Kosovë. Procesi i emërimit të anëtarëve në borde ka filluar më 2012, është shoqëruar me vonesa të shumta dhe anulime që kanë ndikim negativ në vendimmarrjen strategjike dhe në funksionimin efikas të NP-ve. Ky proces është kritikuar vazhdimisht për mungesë të transparencës dhe njollosje nga ndërhyrja politike. Sipas Ligjit Nr. 03/L-087 bordet e drejtorëve në kompanitë publike do të përbëhen nga 5 ose 7 drejtorë. Neni 17.4 i ligjit për NP-të po ashtu kërkon që së paku dy anëtarë të bordit të jenë ekspertë të kontabilitetit. Hulumtimi i Riinvest-it (2012) zbulon se rezymeja e asnjërit nga kandidatët e zgjedhur nuk publikohet. Kualifikimet, përvoja dhe ekspertiza profesionale e tyre janë të njohura vetëm për komisionin përzgjedhës. Mungesa e transparencës në këtë rast nxit perceptimet negative lidhur me procesin. Mungesa e informatave për historikun dhe ekspertizën e anëtarëve të bordit paraqet një shqetësim të madh për shoqërinë civile dhe publikun e gjerë duke e pasur parasysh rëndësinë e shërbimeve që ofrojnë këto NP. Qeveria e Kosovës nuk i ka bërë publike arsyet për anulimin e zgjedhjes së anëtarit të bordit më 2011, ndërsa arsyet e dhëna për anulimin e procesit më 2012 nuk kanë ofruar justifikim të fuqishëm, duke treguar mungesë të transparencës.

Në lidhje me transparencën e raportimit, duket sa ka vonesa në publikimin e raportit vjetor të NJPMNP. Duket se vonesa ka ndodhur për shkak të vonesave të shkaktuara nga raportet vjetore të NP-ve të cilat është dashur të përfundoheshin brenda 90 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik dhe duhet të kalojnë nëpër procesin e auditimit pastaj. Një raport i përgjithshëm i NJPMNP po ashtu duhet të auditohet, e cila gjë shkakton vonesa shtesë. Në këtë aspekt mund të konsiderohet më shumë çështje e transparencës së vonuar.

Procesi i privatizimit të KEDS-it dhe PTK-së është shoqëruar me shumë kritika nga shoqëria civile. Procesi është kritikuar për mungesë të transparencës dhe të llogaridhënies së qeverisë. Në këtë aspekt, shoqëria civile ka ngritur dyshime për korrupsion. Privatizimi i KEDS-it është konsideruar të jetë bërë me çmim shumë të ulët dhe sugjerime të ngjashme janë bërë edhe në rastin e PTK-së. E para është privatizuar më 2012 ndërsa kjo e fundit më 2013 në tenderin e dytë të privatizimit për shkak të anulimit të procesit të parë të privatizimit të PTK-së.

Informatat për ndotjen e mjedisit të shkaktuar nga kompanitë publike janë në dispozicion vetëm në raporte dhe nuk ka statistika publike të cilat do të mund t'iu ofronin qytetarëve informata të lehta për t'u lexuar lidhur me ndotjen e ajrit, në veçanti nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Raportet e publikuara në lidhje me gjendjen e mjedisit, siç është ndotja e ajrit, nuk përditësohen. Të dhënat e fundit që janë në dispozicion në raportet e tyre janë për vitin 2011 dhe nuk ka përditësim të vazhdueshëm për statistikat lidhur me gjendjen e mjedisit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i transparencës është krijimi i një regjistri të

hapur të biznesit. Agjencia e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve (AKRB) ofron të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me regjistrimin, kryerjen e ndryshimeve ose ndërprerjen e biznesit. Qytetarët mund të marrin informata po ashtu për bizneset për të cilat janë të interesuar përmes bazës së të dhënave online të ofruar nga AKRB. Një numër i shërbimeve shtesë për biznese ofrohen online, siç janë informatat për themelimin dhe zhvillimin e biznesit, ligjin e punës, sistemin tatimor, ekonominë e huaj dhe informatat lidhur me infrastrukturën. Agjencia e Statistikës e Kosovës (ASK) ofron të dhëna të plota për kompanitë e themeluara dhe të shpërbëra brenda një viti. Prandaj, numri i kompanive të regjistruara nuk pajtohet me numrin e kompanive aktive dhe nuk ka bazë të centralizuar të të dhënave. Pjesëmarrja publike

Pjesëmarrja publike në vendimmarrjen e kompanive publike në Kosovë është shumë e kufizuar. Procesi vendimmarrës dhe planifikimi strategjik i kompanive publike është përgjegjësi e vetme e bordit të drejtorëve dhe për rrjedhojë e qeverisë.

Qeveria, përveç përmes NJPMNP, e mban bordin përgjegjës për përmbushjen e tyre përmes Takimit Vjetor të Përbashkët (TVP). TVP është një ngjarje zyrtare në të cilën qeveria, si akcionare, ka mundësi të bëjë pyetje lidhur me përmbushjen e raportuar dhe me përmbushjen e pritur dhe të votojë për çështjet kryesore të rëndësishme për të ardhmen e ndërmarrjes. Edhe pse TVP duhet të jetë takim publik, ai nuk publikohet; prandaj publiku nuk është i informuar mirë lidhur me punën e tij (Riinvest, 2012).

Procesi i privatizimit në këta dy sektorë është vazhdimisht i shoqëruar me kundërthënie dhe kritika të mëdha nga shoqëria civile, partitë opozitare dhe aktorët e tjerë. Në procesin e privatizimit të dy kompanive publike, të KEDS-it dhe të PTK-së, përpjekjet e partive opozitare, të përfaqësuesve të sindikatave të pavarura dhe të shoqërisë civile për suspendimin e këtij procesi deri sa të krijohej një konsensus themelor shoqëror mbetën të pasuksesshme. Edhe pse shoqëria civile ishte shumë aktive në ofrimin e raporteve hulumtuese që përkrahnin qeverisjen e mirë në kompanitë publike, rekomandimet e tyre nuk u morën seriozisht.

Sipas Task Forcës për Integrim në BE (2012), NP-të kanë qasje të kufizuar në vendbanimet jo-shumicë meqë në disa vendbanime të Kosovës, të banuara kryesisht nga popullsia serbe, NP-të kanë mundësi të kufizuar për kryerjen e aktiviteteve të tyre ose nuk funksionojnë fare. Për shkak të arsyeve politike, KEK-u nuk ka qenë në gjendje që të faturojë dhe t'i mbledhë pagesat për rrymën të cilën ja ka ofruar popullsisë serbe në veri të vendit dhe nuk ka qenë në gjendje t'i shkyç konsumatorët.

Llogaridhënia

Kuvendi i Kosovës e ka ndryshuar Ligjin për NP-të më 2012. Ndryshimet e bëra në ligj përfshijnë kufizimin e përfshirjes së bordit në mikro-menaxhimin e ndërmarrjeve. Përveç kësaj, janë eliminuar disa konflikte për ligjin mbi qeverisjen lokale dhe janë zvogëluar shpërblymimet për anëtarët e bordit. Sipas ligjit të ri nga NP-të kërkohet t'i harmonizojnë planet e

tyre të biznesit me politikat zhvillimore të sektorit dhe mund të shqyrtohen në periudhat e mëvonshme. Përveç auditimit të rregullt të brendshëm dhe të jashtëm, ndryshimet e zbatuara ua mundësojnë institucioneve, si qeverisë, parlamentit ose auditorit të përgjithshëm, të ndërmarrin çdo lloj të auditimit që konsiderohet i nevojshëm (Riinvest, 2012).

Ligji i përkufizon qartë kanalet e raportimit. NP-të duhet në mënyrë sistematike t'i raportojnë NJPMNP lidhur me përmbushjen, ndërsa NJPMNP përgatit dhe dorëzon në qeveri analizën dhe vlerësimet e përmbushjes së NP-ve. Qeveria ja prezanton parlamentit raportin e përgjithshëm për përmbushjen e NP-ve gjatë raportimit të saj vjetor. Sipas standardeve të OECD, këto raporte duhet të ofrojnë informata të mjaftueshme për të siguruar që qeveria i ushtron të drejtat e saj pronësore në mënyrë të informuar.

Megjithatë, ndryshimet e reja nuk i kanë trajtuar dobësitë lidhur me sqarimin e pavarësisë së anëtarëve të bordit. KIPRED-i (2011) ka gjetur se në procesin e zgjedhjes më 2009, komisioni përzgjedhës nuk ja ka dërguar qeverisë listën e kandidatëve ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore dhe procesi i përgjithshëm nuk ka qenë transparent dhe është prishur me ndërhyrje politike. Një faktor vendimtar për të ndikuar në këtë dobësi është përbërja e komisionit për anëtarët e bordit. Meqë ky komision përbëhet nga zyrtarët qeveritarë, ai zvogëlon besimin për sigurimin e pavarësisë të anëtarëve të zgjedhur të bordit, përkundër faktit që procesi zhvillohet përmes një procesi të rregulluar të vlerësimit. Hulumtimi i Riinvest-it (2012) gjen se shumica e kandidatëve të zgjedhur janë përkrahës politikë të partive në koalicion. KIPRED-i (2011, f. 28-29) tregon se përkundër kërkesave të ligjit që kandidatët të jenë politikisht të pavarur, disa anëtarë të bordit të NP-ve qendrore janë madje zyrtarisht anëtarë të partisë politike (për hollësi shih raportin e KIPRED-it, 2011; faqe 28 dhe 29). Ligji thekson që anëtarët e bordit janë zyrtarë të pavarur, por nuk e trajton çështjen e anëtarëve të bordit të cilët në të kaluarën kanë garuar për post publik dhe kanë qenë anëtarë të partive politike.

Përkundër krijimit të infrastrukturës ligjore (ligji mbi ndërmarrjet, ligji për NP-të dhe ligjet e tjera përkatëse) dhe themelimit të institucioneve të nevojshme si NJPMNP, ende është evidente mungesa e zbatimit të dispozitave ligjore dhe të mbikëqyrjes cilësore nga aktorët (Riinvest, 2012). Ashtu si kërkohet me ligj, prej vitit 2009 NJPMNP ka organizuar trajnime për sekretarët e bordit për të siguruar rrjedhë më të mirë të komunikimit dhe të bashkërendimit ndërmjet NJPMNP dhe bordit të drejtorëve. Po ashtu ja ka dalë të paraqes dokumente të rëndësishme për avancimin e qeverisjes së përbashkët të NP-ve. Përveç kësaj, ka përcaktuar dhe aprovuar kodin e etikës dhe kodin e qeverisjes së korporatave dhe ka hartuar raportet për vlerësimin e përmbushjes për NP-të përfshirë: raportin e përmbushjes së bordit dhe një udhëzim për anëtarët e bordit të NP-ve. Përmbushja e kërkesave ligjore nga NJPMNP mbetet vetëm hapi i parë drejt përmirësimit të qeverisjes së korporatave. Megjithatë, kapacitetet e NJPMNP për ta mbikëqyruar më mirë funksionimin e NP-ve janë ende të kufizuara (Riinvest, 2012).

NJPMNP vlerëson secilën NP individualisht. Harmonizimi i operacioneve me planin e biznesit është faktori kryesor për vlerësimin e përmbushjes së tyre. Përveç kësaj, takimet e

bordit dhe procesverbalet e takimeve, funksionimet e komisioneve të bordit, raportet e auditimit dhe raportet e tjera përkatëse janë pjesë e analizës së përmbyshjes. Sipas hulumtimit të Riinvest-it (2012), KEK-u është në mesin e ndërmarrjeve që ia kanë dalë t'i plotësojnë obligimet e tyre të mirëbesimit. Ka pasur tregues pozitiv në arritjen e objektivave të caktuara në planin e biznesit si edhe në respektimin e ligjit për NP-të dhe të kodit të etikës dhe qeverisjes së korporatave. KEK-u po ashtu ia ka dalë t'i raportojë NJPMNP rregullisht. Çmimet e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore, si monopole që funksionojnë natyrshëm në Kosovë, janë vendosur nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) duke u bazuar në kompetencat të cilat ia jep Ligji për Rregullatorin e Energjisë 03/L-185 dhe duke u bazuar në rregulloren dhe parimet për llogaritjen e pagesave në sektorin e energjisë elektrike (Rregullorja për çmimet). Tarifat për ngrohje qendrore janë caktuar duke u bazuar në Ligjin 03/L-116, sipas të cilit ZRRE i cakton çmimet dhe tarifat duke u bazuar në propozimin vjetor të distributorit. Bordi i Drejtorëve të ZRRE udhëhiqet nga kryesuesi dhe ka pesë anëtarë. Secili prej tyre emërohet për një periudhë kaluese prej pesë vjetësh (Task Forca për Integrim në BE, 2012).

Funksionimi i aviacionit të Kosovës rregullohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AACK), i cili është i themeluar me Ligjin për Aviacionin Civil dhe është agjenci rregullatore. Është përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë së aviacionit civil, të rregullit ekonomik të aeroporteve dhe të shërbimeve të navigacionit ajror në Kosovë. Ai lëshon leje dhe dekrete të navigacionit ajror ashtu siç parashikohet me ligj. Bordi Mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë; dy prej tyre kanë mandat dy vjeçar (përfshirë kryesuesin), ndërsa pjesa tjetër e tyre (tre) kanë mandat katër vjeçar. Anëtarët e Bordit emërohen nga Qeveria. Ai i raporton drejtpërdrejt Kuvendit.

Sektori i hekurudhave rregullohet nga Autoriteti Rregullator për Hekurudhat (ARRH) që funksionon si organ i pavarur dhe i raporton Kuvendit të Kosovës. ARRH i përkufizon rregullat dhe kriteret për të pasur qasje në tregun e hekurudhave dhe i licencën operatorët hekurudhorë, lëshon certifikata të sigurisë për operatorët hekurudhorë dhe lëshon udhëzime për sigurinë, në pajtim me Licencat Evropiane dhe SEETO (Task Forca për Integrim në BE, 2012). Ndërsa, funksionimi i kompanive të ujit dhe të mbeturinave rregullohet nga Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe të Mbeturinave (ZRRUM) e cila i mbikëqyrë shërbimet e ujit dhe të mbeturinave të ngurta në Kosovë, i licencën ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave dhe i cakton tarifat. Po ashtu i mbështetë standardet e shërbimeve që ju ofrohen klientëve. Zyra funksionon duke u bazuar në kornizën ligjore të Ligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi funksionimin e ofruesve të shërbimit për ujë, kanalizim dhe mbeturina. Ajo menaxhohet nga drejtori dhe zëvendës drejtori të cilët emërohen nga Kuvendi për një mandat pesë vjeçar.

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRSB) janë dy agjenci të themeluara për ta mbrojtur mjedisin.

Teknologjia dhe inovacioni

Ndërmarrjet publike dhe shoqërore kanë mbetur prapa në aspektin e përdorimit të informatave digjitale për zbulimin e të dhënave lidhur me publikun. Faqet e internetit të ndërmarrjeve publike nuk përditësohen dhe aty do të mund të përfshiheshin të dhëna më relevante. Çështja më e rëndësishme është që nuk ka opsion për informata kthyesë që do ta mbështeste përmirësimin e shërbimeve nga këto ndërmarrje.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk ofron e-opsione për qytetarët ashtu që të mund t'i kontrollonin faturat e tyre dhe informatat e tjera përkatëse, ose madje edhe të ushtronin ankesë. E vetmja informatë që ofrohet është se qytetarët mund të thërrasin në qendrën e thirrjeve të KEK-ut dhe t'i marrin të gjitha informatat e nevojshme dhe të lënë informata kthyesë. Prandaj, themelimi i një moduli të bazuar në internet do ta shtonte përmbushjen e shërbimit të institucionit. Një gabim në llogaritje të faturave të rrymës së fundi çoi tek disa protesta të organizuara nga qytetarët. Edhe pse zyrtarët e KEK-ut i lidhën gabimet në llogaritjet e faturave të rrymës me gabime teknike, kjo do ta zvogëlojë edhe më tej besimin e qytetarëve tek NP-të.

Tabela 5. Përmirësimi i qeverisjes së korporatave. Rreziqet dhe Mundësitë

Threats	Opportunities
<p>Emërimi i anëtarëve të lidhur politikisht në bordet ekzekutive të NP-ve rrezikon përbushjen e NP-së dhe rritë mundësinë për konflikte të interesit dhe nepotizëm.</p>	<p>Publikimi i biografive të anëtarëve të bordit ekzekutiv do ta shtojë transparencën dhe llogaridhënien e paneleve përzgjedhëse gjatë vlerësimit të kandidatëve.</p>
<p>Vonesat në raportimin e NP-ve në NJMNP kanë ndikim negativ në llogaridhënie dhe transparencë.</p>	<p>Publikimi i të gjitha të dhënave përkatëse rregullisht në faqet e internetit të NP-ve dhe të kompanive të tjera përkatëse, të cilat i zbatojnë kriteret për qeverisjen e korporatave, do ta rrisin besimin e qytetarëve drejt shërbimeve të ofruara dhe besueshmërisë së kompanive.</p>
<p>Mungesa e masave mbrojtëse për informatorët do të ndikojë negativisht në numrin e rasteve të raportuara.</p>	<p>Përfshirja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në komisionin për përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve ekzekutive të NP-ve dhe të agjencive rregullatore mund ta sigurojë përzgjedhjen e anëtarëve të pavarur. Themelimi i Institutit për Qeverisjen e Korporatave në Kosovë në mënyrë që ta mbështesë hulumtimin në këtë fushë.</p>
<p>Ndërhyrja e anëtarit të bordit në çështjet e mikro-menaxhimit të NP-ve.</p>	<p>Nëse Kuvendi i Kosovës siguron përfshirje më të madhe të aktorëve të tjerë në dëgjimet publike, të cilat kanë të bëjnë me drejtimin e NP-ve qendrore, kjo mund ta ulë numrin e vendimeve të ndikuara politikisht.</p>
<p>Mosshfrytëzimi i duhur i mekanizmit të informatave kthyesë të lehtë për përdorim në NP do t'i pengojë NP-të që të marrin kontribut të duhur nga qytetarët.</p>	

**SONDAZH LIDHUR ME BESIMIN DHE
MIRËBESIMIN NË QEVERISJEN E HAPUR**

SONDAZH LIDHUR ME BESIMIN DHE MIRËBESIMIN NË QEVERISJEN E HAPUR

Sondazhi është njëri prej aktiviteteve të para që ka për qëllim ta vlerësojë perceptimin publik ndaj institucioneve përkatëse të Kosovës në lidhje me qasjen e qeverisjes së hapur dhe i mbulon katër shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet qasja OGP (PQH). Është mjeti i parë për ofrimin e indikatorëve të matshëm lidhur me mënyrën si qytetarët e perceptojnë qeverinë, transparencën e saj, llogaridhënien, pjesëmarrjen publike dhe mjetet teknologjike të cilat shfrytëzohen nga qeveria për ta rritur qasjen e qeverisjes transparente dhe të hapur.

Pjesët në vijim do ta japin një analizë të thuktë të sondazhit të kryer në Kosovë; një vlerësim që është tërhequr nga mostra përfaqësuese e popullsisë së vendit. Qëllimi kryesor i sondazhit është të hulumtohet perceptimi i qytetarëve ndaj qeverisë, besimi i tyre në institucione, si edhe vlerësimi i tyre për funksionalitetin dhe efikasitetin lidhur me fushat e Qeverisjes së Hapur. Së pari raporti do të ofrojë të dhëna të përgjithshme për të anketuarit dhe pastaj do të përqendrohet në besimin dhe mirëbesimin e institucioneve të Kosovës, perceptimet për nivelin e transparencës së këtyre institucioneve, përfshirë përpjekjen e qytetarëve për të pasur qasje në informatat publike, nivelin e pjesëmarrjes, nivelin e llogaridhënies institucionale dhe shfrytëzimin e teknologjisë.

Metodologjia dhe informatat e përgjithshme

Sondazhi në Kosovë ishte gjithëpërfshirës dhe në të morën pjesë 1,049 të anketuar nga mbarë Kosova. Shpërndarja e mostrës të rastësishme ishte shembull tipik. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave ishte me anë të intervistave sy më sy, ndërsa përpunimi i të dhënave është bërë në softuerin operativ SPSS.


Ekipi i Riinvestit i ka trajnuar të gjithë kontrollorët lidhur me pyetësin dhe me zgjedhjen e mostrës. Si pjesë e këtij trajnimit, kontrollorëve ju dhanë udhëzime dhe sqarime të hollësishme lidhur me pyetësin. Para se të kryhej anketimi në terren pyetësi u testua po ashtu. Menaxheri i projektit po ashtu kreu një proces të verifikimit përmes telefonit. Të dhënat e mbledhura nga anketa pastaj u shifruan në SPSS. Ne e kemi shfrytëzuar këtë mjet statistikor për ta lehtësuar kontrollimin e të dhënave dhe për t'i kryer analizat themelore statistikore të cilat do t'i prezantojmë në pjesën në vijim.

Të dhënat e mbledhura nga anketimi u shifruan nga personeli me përvojë duke i përdorur tabelat SPSS të përgatitura me fushat e të dhënave dhe tabelat që shfaqen të cilat i tregojnë shifrat përkatëse. Pas futjes së të dhënave, dy persona, njëri duke e shfrytëzuar pyetësin dhe tjetri tabelën, ja lexuan ato me zë njëri tjetrit për ta vërtetuar saktësinë e përgjigjeve. Pastaj, të dhënat analizohen duke shfrytëzuar SPSS për t'i identifikuar përgjigjet jashtë shkallës së pritur, përfshirë papajtueshmëritë e mundshme në ndryshore.

Në pyetësor u përfshinë të gjitha komunat, përfshirë komunat me pakicë serbe. Afërsisht 50.7 për qind e të anketuarve ishin meshkuj, ndërsa 49.3 për qind ishin femra. Proporcioni meshkuj/femra në Kosovë është 96 për qind (Agjencia e Statistikave e Kosovës - ASK, 2013).

Kjo do të thotë që në këtë sondazh është arritur përfaqësimi gjinor. Moshja mesatare e të anketuarve ishte 34.09 vjeç. Kjo do të thotë që moshja mesatare e të anketuarve ishte shumë më e vjetër se sa moshja mesatare e vendit e cila është 29.5 vjeç (ASK, 2013). Përkatësia kombëtare e të anketuarve është paraqitur në ilustrimin 2, ku shumica e të anketuarve ishin shqiptarë (89.9 për qind) dhe pjesa tjetër ishin serbë (8.3 për qind), boshnjakë (1.4 për qind), turq (0.3 për qind), egjiptianë (0.1 për qind). Afërsisht 92 për qind e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë dhe pjesa tjetër prej 8 për qind i përket etnive të tjera (ASK, 2011). Rezultatet e këtij sondazhi dhe grupet e të anketuarve janë qartë përfaqësues të etnive kryesore në Kosovë.

Ilustrimi 1. Nacionaliteti i të anketuarve (rezultatet në përqindje)



Burimi - Llogaritja e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Afërsisht 45.3 për qind e të anketuarve i kanë përfunduar studimet e tyre themelore, 40.9 për qind e kanë përfunduar shkollën e mesme, ndërsa 4.3 për qind e kanë përfunduar ndonjë lloj të studimeve post diplomike. Vetëm 9.5 për qind e kanë përfunduar shkollimin fillor ose nuk kanë shkollim fare. Lidhur me nivelin e punësimit të të anketuarve, 30.8 për qind kanë punësim të përhershëm, ndërsa 25.6 për qind janë të papunësuar dhe janë duke kërkuar punë. Pjesa tjetër e të anketuarve kanë kontrata punësimi me kohë të caktuar (19.6 për qind), të papunë dhe që nuk janë duke kërkuar punësim (13.2 për qind), në pension (5.1 për qind), dhe studentë (5.7 për qind). Afërsisht 43.2 për qind e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa 33.3 për qind janë të punësuar në sektorin publik. Pjesa tjetër janë ndërmarrës (23.5 për qind). Studimi i fuqisë punëtore për pjesën e parë të vitit 2012 i kryer nga ASK zbulon rezultate të ngjashme me ato të sondazhit. 36.8 për qind e popullsisë është fuqi aktive punëtore, ndërsa pjesa tjetër është joaktive.

Përafërsisht 89.5 për qind e të anketuarve e kanë deklaruar fenë e tyre si myslimanë. Kjo korrespondon me të dhënat se afërsisht 90 për qind e popullsisë së Kosovës deklarohen si

muslimanë. Në fund, afërsisht 46.3 për qind e të anketuarve konstatojnë që të ardhurat e tyre familjare janë ndërmjet 200 dhe 600 euro në muaj, që është mjaft e saktë sepse rroga mesatare në Kosovë është rreth 280 euro dhe është me e ulëta në Evropë (Kosova: Profili i marrëdhënieve industriale, 2012). Vetëm 2.3 për qind e të anketuarve theksojnë që paga e tyre është mbi 2000 euro, ndërsa 19.2 theksojnë që paga e tyre bie ndërmjet 51 dhe 200 euro në muaj.

REZULTATET E SONDAZHIT

Kjo pjesë do t'i analizojë gjetjet kryesore të sondazhit të kryer në Kosovë. Nga të anketuarit është kërkuar t'i rendisin institucionet në shkallën prej 1 deri në 4³⁰. Sa i përket analizës, proporcioni i përgjigjeve të qytetarëve që kanë thënë besim të madh (ose pajtohem plotësisht) dhe besim deri në një shkallë (ose pak a shumë pajtohem) për pyetjet përkatëse janë shfrytëzuar si indikatorë të besimit. Rezultatet i zbulojnë perceptimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me nivelin e besimit dhe të mirëbesimit në institucionet publike, në transparencën e qeverisjes, pjesëmarrjen publike, llogaridhënien dhe shfrytëzimin e teknologjisë si mjet rregullator për lehtësimin e qeverisjes së hapur.

Niveli i besimit dhe i mirëbesimit në institucionet shtetërore dhe publike

Ilustrimi 2, paraqet nivelin e besimit që qytetarët e Kosovës e kanë në institucionet e ndryshme. Institucioni më i besuar në Kosovë janë mediat (nga 62.9 për qind e të anketuarve), ndërsa institucionet fetare janë institucioni i dytë më i besuari në Kosovë. Sipas Ligjit (neni 5) mbi liritë fetare në Kosovë “në Kosovë nuk ka fe zyrtare” (edhe pse afërsisht 90 për qind e popullsisë vlerësohet të jenë myslimanë), dhe si i tillë Ligji mbi liritë fetare nuk e përfshin të drejtën kushtetuese për drejtimin e institucioneve fetare (Liria fetare në Kosovë: kujdesi prindëror ndaj një vendi të ri, 2008). Megjithatë, institucionet fetare duket se gëzojnë nivel të lartë të besimit nga popullsia e Kosovës, edhe pse ligjërisht ato mbesin të parregulluara. Policia e Kosovës, Bashkimi Evropian dhe KFOR-i janë institucionet në vijim më të besuara. Është interesant të vihet re që në një studim të kryer nga Forumi për nisma qytetare dhe Saferworld më 2010, Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës ishin institucionet që gëzonin besimin më të madh, ndërsa mediat ishin renditur si institucioni i pestë më i besuar (Çështje besimi, 2010). Rezultatet e tjera janë mjaft të ngjashme për shembull besimi në EULEX (më 2010 besimi ishte 33.6 për qind dhe tani është 31.1 për qind) dhe sistemi gjyqësor (më 2010 me 22.3 për qind dhe tani është 26.9 për qind) nuk ka përjetuar ndryshim radikal. Edhe pse këto institucione e kanë ndryshuar renditjen e tyre, prapë institucionet e njëjta e përbëjnë

Mediat, institucionet fetare, Policia e Kosovës, BE-ja dhe KFOR-i duket se janë institucionet më të besuara në Kosovë, ndërsa Qeveria e Kosovës, Presidentja e Kosovës dhe partitë politike janë institucionet të cilave ju besojnë më së paku.

30 1 – Nuk kam besim fare (ose nuk pajtohem fare); 2 – Nuk kam shumë besim (ose pajtohem deri në një shkallë); 3 – Besim deri në një shkallë (ose pajtohem pak a shumë); dhe 4 – Besim të madh (ose pajtohem plotësisht).

grupin e institucioneve më të besuara nga qytetarët. OJQ-të janë institucioni i gjashtë më i besuar dhe i fundit që gëzon besimin e më shumë se 50 për qind të të anketuarve. Qeveria e Kosovës, Presidentja e Kosovës dhe partitë politike janë tri institucionet më pak të besuara. Vetëm 22.9 për qind e qytetarëve thonë që kanë besim të madh ose besim deri në një shkallë në Qeverinë e Kosovës, ndërsa vetëm 22.4 për qind e thonë këtë për Presidenten e Kosovës. Sipas Raportit të Pulsit Publik (UNDP, 2013) rezultate të ngjashme janë gjetur edhe në lidhje me të qenit të kënaqur me qeverinë, ndërsa afërsisht 30 për qind e qytetarëve janë të kënaqur me punën e qeverisë. Prandaj, qytetarët duket se kanë besim më të madh në qeverinë lokale krahasuar me atë qendrore. Rreth 43 për qind e të anketuarve thonë që kanë besim të madh ose besojnë deri në një shkallë në kryetarët e tyre të komunave që është më i lartë se besimi në Parlamentin e Kosovës (36.3 për qind).

Institucionet e tjera, siç janë shërbimet komunale publike (kompanitë përkatëse publike), administrata publike, organizatat shtetërore të auditimit dhe EULEX-i duket se perceptohen si të besuara nga afërsisht përqindja e njëjtë e qytetarëve (rreth 32 për qind). Është për t'u habitur që edhe pse Bashkimi Evropian duket se është njëri nga institucionet më të besuara, EULEX-i i cili funksionon me mandat të BE-së është më pak i besuar nga qytetarët e Kosovës. Në lidhje me gjyqësorin e Kosovës, vetëm 26.9 për qind e të anketuarve kanë treguar besim të madh ose besim deri në një shkallë (26.9 për qind).

Ilustrimi 2. Ju lutemi tregojeni besimin dhe mirëbesimin tuaj në institucionet në vijim (në përqindje)



Burimi - Llogaritjet e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Në raportin e BTI (2012) thuhet që partitë politike në Kosovë janë të bazuara në liderë, nuk kanë ideologji dhe lëvizin nga e majta në të djathtë varësisht nga mundësitë që paraqiten.

Sipas raportit të njëjtë zgjedhjet e brendshme partiake janë vetëm formale dhe kryetarët e partisë nuk kundërshtohen kurrë për këndvështrimet e tyre. Nën-pjesa në vijim i diskuton gjetjet për perceptimet e qytetarëve lidhur me transparencën e qeverisjes si njëra nga katër kriteret e qeverisjes së hapur.

Transparenca

Transparenca është njëra nga shtyllat kryesore të OGP (PQH). Edhe pse Kosova vetëm rish-tazi ka filluar bisedimet për OGP (PQH) me anëtarët themelues të OGP (PQH), ende mbetet shumë punë për t'u bërë në këtë aspekt. E-qeverisja është një hap në drejtimin e duhur, por me rëndësi vendimtare është po ashtu rritja e nivelit të vetëdijesimit për shërbimet e tilla që janë në dispozicion dhe informatat për shoqërinë.


Në lidhje me nivelin e transparencës si njëra prej shtyllave kryesore të qasjes së qeverisjes së hapur, të anketuarit besojnë që e gjithë përmbushja financiare dhe informatat teknike për kontratat e financuara nga qeveria duhet të bëhen publike (77.2 për qind-besimi këtu vlerësohet me pajtohem pak a shumë ose pajtohem pak dhe pajtohem plotësisht). Banka Botërore vlerëson se korrupsioni i shton për mesatarisht 20 për qind shpenzimet e prokurimit publik (Të bërit e prokurimit publik në Kosovë më transparent, 2012). Edhe pse pjesa më e madhe e qytetarëve pajtohen që kontratat e financuara nga qeveria duhet të bëhen publike, në të vërtetë ende ka mjaft hapësirë për korrupsion, siç thuhet në gjetjet e Bankës Botërore. Gjatë vitit 2012, në nivel të institucioneve qendrore janë bërë mbi 600 kërkesa për qasje në dokumente të institucioneve publike, prej të cilave mbi 80 për qind të rasteve ju është lejuar qasja në dokumente. Në nivelin komunal janë bërë rreth 590 kërkesa, në rreth 80 për qind të rasteve është lejuar qasja në dokumente publike³¹.

75.1 për qind e të anketuarve nuk besojnë që deputetët e Parlamentit kanë të drejtë t'i mbajnë të fshehta informatat për pasurinë personale. Me ligj nga zyrtarët kërkohet që ta deklarojnë pasurinë e tyre personale.

Vetëm 24.9 për qind e qytetarëve besojnë që deputetët e parlamentit kanë të drejtë t'i mbajnë të fshehta informatat për pasurinë personale. Në të vërtetë, sipas ligjit është e obligueshme që personat që janë në pozita vendimtare publike ta deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) dhe nëse nuk e bëjnë këtë, ata rrezikojnë të gjobiten dhe të burgosen.

31 Raporti Gjithëpërfshirës (2012). Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Raporti gjithëpërfshirës për të drejtën e qasjes në dokumentet publike nga institucionet publike

Ilustrimi 3. Sa pajtoheni me deklaratat në vijim (në përqindje)



Burimi – Llogaritjet e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Një fushatë e vitit 2011 mbi deklarin e pasurisë 46.4 për qind e të anketuarve thonë që qytetarët nuk kanë ekspertizë të çoi deri tek rritja e numrit të deklarimeve të bëra nga 96 për qind (1830) e zyrtarëve (Raporti i Progresit, 2012). Duket se niveli i vetëdijesimit lidhur me llogaridhënien është në rritje. **46.4 për qind e të anketuarve thonë që qytetarët nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme për të gjykuar lidhur me vendimet qeveritare.**

Në pyetjen lidhur me publicitetin e veprimeve negative të qeverisë, rreth 70 për qind e të anketuarve pajtohen pak a shumë ose pajtohen plotësisht që ai çon sinjale negative tek investitorët, kështu që ka efekt negativ në zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërsa, afërsisht 46.8 për qind e qytetarëve thonë që nëpunësit civilë të cilët i nxjerrin informatat sekrete lidhur me veprimet e qeverisë duhet të ndëshkohen. Megjithatë, Kosova e ka zbatuar ligjin për mbrojtjen e informatorëve. Në këtë rast informatori do të mbrohej ligjërisht; edhe pse, krejt do të varej nga lloji i informatës së nxjerrë. Edhe pse njeriu do të mendonte që nëse informata e tillë është me rëndësi vendimtare për dijeninë e publikun, një veprim i tillë do të mund të arsyetohej.

Sa ju përket politikave të rekrutimit në sektorin publik, të anketuarit nuk pajtohen shumë se duhet të merren informatat për përkatësinë etnike dhe fetare të nëpunësve civilë (rreth 60 për qind). Në bazë të rezultateve duket që politikat e rekrutimit duhet të bazohen në përmbushjen si kriteri kryesor i rekrutimit.

Në fund, edhe pse të anketuarit në përgjithësi besojnë që informatat duhet të ndahen publikisht me qytetarët, vetëm 5.5 për qind e të anketuarve thonë që kanë bërë kërkesë zyrtare për informata publike (prej 5.5 për qind të kanë bërë kërkesë zyrtare për informata publike, 1.2 për qind e këtyre kërkesave janë bërë më 2013) dhe qasje në të dhëna. Edhe pse me

ligjin (2010/03-L-215), qytetarëve ju lejohej ta kërkojnë ndarjen e këtyre informatave, 94.5 për qind e të anketuarve nuk e kanë shfrytëzuar kurrë të drejtën e tyre ligjore.

Pjesëmarrja Publike

Pjesëmarrja publike është shumë e rëndësishme për rritjen e integritetit dhe të nivelit të llogaridhënies të institucioneve publike. Pjesëmarrja e publikut dhe e OSHC duhet të përfshihet në hartimin e ligjit dhe të strategjisë. Prandaj, pjesëmarrja publike dhe angazhimi i qytetarëve në zhvillimet publike shkon përtej përfshirjes së OSHC në hartimin e strategjive dhe të politikave të qeverisë. Vetëm 23.6 për qind e të anketuarve thonë që kanë marrë pjesë në demonstratë ose tubim. Kjo tregon që qytetarët nuk janë aktivë në mbrojtjen / kërkimin e të drejtave të tyre. Në anën tjetër, Raporti i Pulsit Publik tregon se 45 për qind e qytetarëve janë të gatshëm t'iu bashkohen protestave për arsye politike (UNDP, 2013).

Rreth 46.4 për qind e të anketuarve thonë që një qytetar i zakonshëm nuk ka ekspertizë të mjaftueshme për të gjykuar lidhur me vendimet e marra nga qeveria (ilustrimi 4). Prandaj, ai tregon që një pjesë e madhe e qytetarëve nuk besojnë se shoqëria civile është e aftë t'i gjykojë ose t'i vlerësojë vendimet e marra nga zyrtarët qeveritarë dhe si e tillë i pranon vendimet si punë e kryer. Kjo mund të jetë njëra prej arsyeve pse 76.4 për qind e të anketuarve të intervistuar – edhe pse nuk janë të kënaqur me qeverisjen – nuk protestojnë ose marrin pjesë në tubime.

Ilustrimi 4. Sa pajtoheni me deklaratat në vijim (në përqindje)



Burimi – Llogaritja e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Përveç kësaj, ndërsa 57.6 për qind e qytetarëve thonë që përfaqësuesit e Parlamentit, si të zgjedhur me votë të lirë, e kanë krejt përgjegjësinë për t'i formësuar çështjet publike; 51.7 për qind e të anketuarve besojnë se dëgjimet publike janë vetëm ngjarje formale dhe nuk kanë ndonjë ndikim

të madh në vendimet komunale. Kjo tregon që shumë qytetarë mund të besojnë që vendimet kanë mundur të jenë marrë më parë dhe që dëgjimet janë vetëm formale dhe nuk kanë ndonjë ndikim në nivelin komunal. Megjithatë, në të vërtetë, vetë pjesëmarrja e qytetarëve, edhe pse parashikohet me ligj, është e ulët në dëgjimet e ndryshme me vetëm 16.3 për qind të qytetarëve të Kosovës që janë aktivë në nismat dhe organizatat e bazuara në shoqëri (KCSF, 2011).

Rreth 67 për qind e të anketuarve pajtohen në mjaftueshëm apo shumë që vendimmarrja institucionale ndikohet nga bashkësia ndërkombëtare.

Përkundër shfaqjes së besimit më të lartë në media, rreth 48 për qind e të anketuarve pajtohen se faqet individuale dhe komentet në internet nuk e paraqesin opinionin publik si duhet, i cili krahasuar me televizionin dhe gazetat duket se gëzon më pak besim nga qytetarët. Së fundi, vetëm 20.8 për qind e të anketuarve pajtohen që lobimi është i keq për shoqërinë. Meqë lobimi mund të konsiderohet nga këndvështrimi pozitiv dhe ai negativ, në përgjigje mund të ndikojnë këndvështrimet e lobimit të marra parasysht nga të anketuarit.


Llogaridhënia

Llogaridhënia institucionale është njëra prej katër kriterëve të kërkuara me standardet OGP (PQH). Në këtë rast, zyrtarët e zgjedhur publikë me votë demokratike duhet të jenë përgjegjës karshi qytetarëve të vendit. Korniza ligjore duhet të forcohet dhe ligjet duhet të zbatohen plotësisht.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (67.2 për qind) besojnë që presioni politik nga bashkësia ndërkombëtare ka ndikim në vendimmarrjen e përgjithshme të qeverisë (ilustrimi 5). Ndërsa, 57 për qind e të anketuarve pajtohen mjaftueshëm ose shumë që anëtarët individualë të parlamentit mund të ndikojnë në procesin vendimmarrës. Ndonëse besojnë që anëtarët e parlamentit janë përgjegjës për formësimin e çështjeve politike, qytetarët kanë qenë dëshmitarë të presionit ndërkombëtar në anëtarët e Parlamentit për të votuar në favor të marrëveshjes Prishtinë – Beograd në Bruksel dhe po ashtu edhe në favor të Ligjit për amnistinë (qytetarët kanë nënshkrua peticion kundër ligjit duke i mbledhur 12,000 nënshkrime), në mesin e disa shembujve të fundit.

Të anketuarit (53 për qind) po ashtu thonë që kompanitë e mëdha ndërkombëtare mund të ndikojnë në vendimet qeveritare. Ndërsa një numër më i vogël i të anketuarve (51.7 për qind) pajtohen mjaftueshëm ose shumë që partitë opozitare mund të ndikojnë në vendimet qeveritare. Një numër më i vogël i të anketuarve pajtohen mjaftueshëm ose pajtohen shumë që mediat, komisionet parlamentare, biznesmenët vendas, avokati i popullit ose zyra shtetërore e auditimit mund të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes së qeverisë (shih ilustrimi 5). Nga 62.9 për qind e të anketuarve të cilët theksojnë që besojnë më së shumti në media, 60 për qind e tyre thonë që pajtohen mjaftueshëm ose shumë që mediat mund të ndikojnë në procesin vendimmarrës të qeverisë.

Ilustrimi 5. Sipas mendimit tuaj si munden organizatat në vijim të ndikojnë në vendimet e qeverisë (në përqindje)



Burimi – Llogaritjet e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Grupet qytetare, institucionet fetare ose shoqatat e qeverisë lokale konsiderohen që kanë më pak ndikim në vendimmarrjen e qeverisë (shih ilustrimin 5). Të anketuarit besojnë që sindikatat e pavarura kanë më së paku ndikim në vendimet qeveritare (23.8 për qind). Kjo mund të varet shumë nga industria pjesë e të cilës është sindikata, por tregtarët kanë qenë mjaft të suksesshëm për ta bindur qeverinë që ta heqë tarifën prej 35 për qind për çimenton e importuar, e cila ishte futur në përdorim më 2012. Industria e ndërtimit po lulëzon në Kosovë dhe duke qenë kështu një vendim i tillë kishte pasur ndikim të madh te këta tregtarë. Edhe pse nuk ishte krejt meritë e tregtarëve që u tërhoq ky vendim, ata ishin grup me mjaft ndikim në këtë rast. Megjithatë, në realitet, ky është një rast i rrallë ku sindikatat e kanë pasur një ndikim të këtij lloji.

Përdorimi i teknologjisë

Kosova është mjaft e re në e-qeverisje; megjithatë, është kërkesë themelore në qasjen e të dhënave të hapura që kërkohet në kuadër të kriterëve të Nismës OGP (PQH). Qytetarët nuk janë gjithmonë në dijeni për shërbimet e disponueshme online; si të tilla fushatat e vetëdijesimit duhet të shkojnë paralelisht me zhvillimet teknologjike.

Në lidhje me përdorimin e teknologjisë për qasje në informata dhe ndarje të tyre, është shqetësuese që 55.1 për qind e qytetarëve nuk janë në dijeni nëse qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit. Vetëm 37.7 për qind e dinë që qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit dhe 7.2 për qind thonë që qeveria e tyre lokale nuk ka faqe të internetit. Kjo ka të bëjë me faktin që burimi kryesor i marrjes së informatave dhe po ashtu burimi më i besuar janë mediat. Kjo po ashtu tregon nivelin e ulët të pjesëmarrjes nga ana e qytetarëve dhe faktin që ata nuk e hulumtojnë faqen e internetit të qeverisë, as në nivel qendror as në atë lokal.

Prej 37.7 për qind të të anketuarve të cilët e dinë që qeveritë e tyre lokale kanë faqe të internetit, vetëm 29.7 për qind thonë që ata më së shumti i shfrytëzojnë faqet e internetit për t'i kontrolluar programet dhe ngjarjet në qytet/qytezë (ilustrimi 6). Në anën tjetër, 21.5 për qind e të anketuarve të cilët i shfrytëzojnë faqet qeveritare të internetit thonë që i shfrytëzojnë faqet e internetit për t'i dorëzuar dokumentet dhe për t'i shkarkuar formularët për administratën lokale. Kjo veçori mund ta ketë rritur lehtësinë e shfrytëzimit të shërbimeve për ata qytetarë, por prapë se prapë niveli i njohurisë lidhur me ekzistimin e shërbimeve të tilla është i ulët.

Ilustrimi 6. Nëse pushteti lokal ka faqe të internetit, si e shfrytëzoni atë (në përqindje)



Burimi – Llogaritja e autorëve duke u bazuar në rezultatet e sondazhit

Edhe më pak të anketuar i shfrytëzojnë faqet e internetit të qeverisë lokale për të dërguar ankesa ose komente tek personeli i komunës ose për të shkarkuar vendime ose rezoluta të qeverisë lokale (shih ilustrimin 6). Arsyeja më e vogël për t'i shfrytëzuar faqet e internetit të qeverive lokale është të komunikojnë me këshilltarë komunalë (prej 37.7 për qind të të anketuarve, 13 për qind e dinë që qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit).

55.1 për qind e qytetarëve nuk janë në dijeni nëse qeveria e tyre lokale ka faqe të internetit.

Në bazë të sondazhit mund të shohim që qytetarët kanë nivel të ulët të besimit në institucionet publike dhe në vendimmarrësit. Qytetarët nuk i besojnë qeverisë, presidentes ose partive politike. Ky është një problem i madh që duhet të trajtohet. Përkushtimi ndaj qasjes së qeverisjes së hapur do të ishte një hap i rëndësishëm. Përveç kësaj, në lidhje me besimin, nuk besojnë të gjithë qytetarët se zyrtarët qeveritarë duhet ta informojnë publikun për pasurinë e tyre. Në këtë rast, megjithatë, me ligj zyrtarët janë të obliguar t'i publikojnë informatat lidhur me pasurinë e tyre. Kjo është vendimtare për llogaridhënien publike zyr-

tare ndaj qytetarëve të vendit. Qytetarët nuk kërkojnë qasje në informata publike, as nuk marrin pjesë në tubime ose demonstrata për raste të ndryshme. Kjo tregon që pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e ulët dhe si rrjedhojë edhe llogaridhënia e zyrtarëve është e ulët.

Në përgjithësi, qytetarët e Kosovës nuk kanë besim ose mirëbesim të madh në institucionet publike. Kjo duhet të jetë shumë shqetësuese për këto institucione dhe duke qenë kështu nevoja për trajtimin e këtij problemi është vendimtare. Në mënyrë që ta rifitojnë besimin publik, qeveria, parlamenti, gjyqësori e kështu me radhë duhet të inkorporojnë politika transparente dhe gjithëpërfshirëse për ta inkurajuar debatin e hapur dhe për ta përfshirë shoqërinë civile dhe qytetarët e interesuar në proceset e hartimit të ligjeve

PËRFUNDIM

Analiza e politikave të Qeverisë së Kosovës në kontekst të qeverisjes së hapur tregon se ekziston një kornizë e konsiderueshme legislative. Përkundër faktit që Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i fillojë procedurat për anëtarësimin e Kosovës në Nismën OGP (PQH), zbatimin e qeverisjes së hapur mbetet sfidë për të ardhmen. Procesin e udhëheq Ministria për Integritim Evropian dhe do të mbështetet nga një përfaqësues i shoqërisë civile si bashkë-udhëheqës i procesit. Ministria e Kosovës për integritim evropian e ka nënshkruar Letrën e Qëllimit dhe e ka adresuar atë në Sekretariatit e OGP (PQH) duke e shprehur interesimin e Qeverisë së Kosovës që t'i bashkohet OGP-së (PQH). Për këtë qëllim, plani i veprimit është dizajnuar të hartohet në një proces konsensual gjithëpërfshirës, përfshi institucionet publike, komunitetin e biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të tjerë relevant. Aktivitetet në planin e veprimit duhet të fokusohen rreth pesë fushave kryesore: rritja e cilësisë së shërbimeve publike, shtimi i integritetit publik, menaxhimi efektiv i resurseve publike, përmirësimi i sigurisë së komuniteteve dhe llogaridhënia e shtuar korporatave. Adresimi i tyre njëkohësisht do të kontribuojë në përmirësimin e mangësive institucionale, si parakusht i avancimit të Kosovës në procesin e integritetit në Bashkim Evropian.

Domosdoshmëria e rritjes së transparencës nga Qeveria e Kosovës sugjerohet nga rezultatet e sondazhit për besimin në institucionet publike të realizuar nga Instituti Riinvest (2013). Rezultatet e sondazhit tregojnë që Presidentja e Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe partitë politike janë institucionet në të cilat ka më së pakti besim në vend. Ky sinjal duhet të konsiderohet si indikator serioz nga Qeveria e Kosovës, që të përkushtohet ndaj një qeverisjeje më transparente dhe të përgjegjshme, për të përmirësuar integritetin publik dhe për të rritur besimin tek qytetarët.

Edhe pse procesi i anëtarësimit në Nismën OGP (PQH) ka filluar vetëm rishtazi, deri më tani Qeveria e Kosovës ka marrë veprime relevante. Sipas urdhëresës administrative nr. 7/2008 të Ministrisë së Administratës Publike, të gjitha institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës janë të obliguara t'i krijojnë faqet e tyre të internetit ose t'i përmirësojnë ato ekzistueset si mjet për rritjen e transparencës. Megjithatë, nuk ka metodologji të standardizuar e cila mund ta zbatohet nga të gjitha institucionet në lidhje me llojin e të dhënave që duhet publikuar. Kjo rrit lirinë e veprimit të zyrtarëve publikë ose të udhëheqësve institucionalë për t'i publikuar të dhënat sipas zgjedhjes së tyre. Në nivel qendror dhe lokal ka dallime të qarta lidhur me llojin e dokumenteve që mund të shkarkohen në faqet e tyre. Ndërsa sa i përket qasjes në dokumente zyrtare të cilat mund të shfrytëzohen me kërkesë, ka mungesë të kapaciteteve administrative në institucionet qendrore dhe edhe në ato lokale. Si rrjedhojë, shumë kërkesa të qytetarëve, të organizatave të shoqërisë civile dhe të palëve të tjera të interesuara për të pasur qasje në dokumentet publike, refuzohen apo nuk trajtohen. Kërkesat për të pasur qasje në dokumentet publike në masë të madhe kanë të bëjnë me kontratat publike, siç është kontrata për autostradën ose për projektet e tjera publike, meqë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik e publikon vetëm emrin e kompanisë dhe shumën e ofertës fituese. Rezultatet e anketës së realizuar nga Riinvest (2013) tregojnë për interesim të qytetarëve për qasje në dokumentet me interes publik. Rreth 78% e qytetarëve pajtohen që të gjitha informatat mbi aspektet financiare, efektshmërinë dhe informatat e tjera teknike për kontratat e financuara nga qeveria duhet të bëhen publike.

Në lidhje me rritjen e llogaridhënies dhe të integriteti publik, janë aprovuar disa ligje si: ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të larët publikë, ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publikë, ligji për mbrojtjen e informatorëve dhe ligji për prokurimin publik. Ligji për financimin e partive politike dhe konfliktin e interesit duhet të përmirësohen edhe më. Zbatimi i plotë i këtij legjislacioni është sfidë për institucionet e Kosovës në të ardhmen, ndërsa korrupsioni është shqetësimi kryesor i shoqërisë. Janë themeluar po ashtu institucionet e pavarura të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e punës së institucioneve qeveritare dhe të kompanive publike. Mirëpo, përfshirja e anëtarëve të lidhur politikisht në borde ekzekutive të institucioneve të pavarura e minon pavarësinë e tyre të supozuar. Edhe pse individët përkatës mund të japin dorëheqje nga pozitat politike para angazhimit të tyre në institucionet e pavarura, është vështirë t'i shmangen ndikimit politik nga partitë e tyre politike. Nisma OGP (PQH) mund t'i shërbejë Qeverisë së Kosovës si mekanizëm vetëkorrigjues në rritjen e integritetit të saj publik. Perceptimi aktual i qytetarëve të Kosovës lidhur me llogaridhënien e qeverisë duket se është në pajtim me integritetin e dobët publik të qeverisë dhe të institucioneve tjera përkatëse. Më shumë se 67% e qytetarëve pajtohen që vendimet qeveritare mund të ndikohen nga presioni politik nga komuniteti ndërkombëtar, ndërsa 50% e qytetarëve pajtohen që vendimet ndikohen nga pjesëtarët individualë të parlamentit ose kompanitë e mëdha ndërkombëtare. Një përqindje më e vogël e qytetarëve pajtohen ose pajtohen deri diku që në vendimet qeveritare mund të ndikojnë komisionet parlamentare, Avokati i Popullit ose Zyra e Auditimit e Shtetit. Vetëm rreth 26% e qytetarëve pajtohen që organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë vendimet qeveritare.

Sa i përket rritjes së pjesëmarrjes publike, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me CIVIKOS e kanë hartuar strategjinë qeveritare për bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë për periudhën 2013-2017, e cila ka për qëllim ta përmirësojë procesin e konsultimeve dhe të bashkëpunimit. Zyra e kryeministrit po ashtu ka përgatitur doracakë udhëzues për ministrinë e linjës lidhur me mënyrën e hartimit të legjislacionit në bashkërendim me organizatat e shoqërisë civile dhe doracakun për procesin e konsultimeve publike. Në anën tjetër, përfshirja e qytetarëve ka qenë mjaft e kufizuar. Rregullat për takimet publike në procesin e hartimit të buxhetit komunal janë respektuar në vetëm 50% të rasteve. Rezultatet e sondazhit tregojnë që vetëm rreth 6% e qytetarëve të intervistuar kanë ushtruar kërkesë zyrtare për informata apo të dhëna publike. Ndërsa, rreth 52% e qytetarëve pajtohen që dëgjimet publike janë ngjarje zyrtare që kanë pak ndikim në procesin vendimmarrës. Krijimi i zyrës qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile mund ta forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve dhe ta rrisë pjesëmarrjen publike.

Publikimi i të dhënave në e-portalin e Qeverisë së Kosovës dhe në faqet e internetit të institucioneve përkatëse janë mjetet kryesore teknologjike që shfrytëzohen për t'ua ofruar qytetarëve të dhënat më afër dhe për ta rritur transparencën. Përkundrazi, rezultatet e sondazhit tregojnë që më shumë se gjysma e qytetarëve të Kosovës nuk e dinë nëse pushteti i tyre lokal ka faqe të internetit, ndërsa vetëm rreth 38% i kanë shikuar ndonjëherë faqet e qeverive të tyre. Nga qytetarët që i shikojnë faqet e tyre komunale, rreth 28% e shfrytëzo-

jnë atë për t'i shikuar programet dhe ngjarjet në qytet, rreth 22% e shikojnë faqen e internetit për t'i përcjellë vendimet e këshillit, ndërsa vetëm rreth 16% prej tyre kanë dërguar ndonjëherë ankesë përmes faqes së internetit. Faqet e internetit shfrytëzohen si mjet për të komunikuar me këshilltarët lokalë për vetëm rreth 13% të qytetarëve të intervistuar. Krijimi i një moduli të standardizuar të informatave kthyesë në e-portalin e Qeverisë së Kosovës dhe në uebfaqet e institucioneve tjera publike do të lehtësojë pjesëmarrjen qytetare, duke mundësuar komunikim interaktiv me secilin qytetar të interesuar të kontribuojë në vendimet dhe veprimet specifike të secilit institucion publik.

Sa i përket kritereve të pranueshmërisë në Nismën OGP (PQH), Kosova duket se i plotëson më shumë se 75% të kritereve të kërkuara që e kualifikon Qeverinë e Kosovës për anëtarësi në Nismën OGP (PQH). Kriteri i lirisë së qasjes në informata dhe të kriteri i Ligjit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe të politikanëve të zgjedhur janë plotësisht të pranueshëm, ndërsa për vlerësim të saktë të kriterit për liritë civile Kosova duhet të përfshihet në studimin e indeksit të demokracisë të EIU (NJSE). Kosova nuk është përfshirë në Studimin e Buxhetit të Hapur i cili është mjeti kryesor për vlerësimin e transparencës fiskale në të cilin bazohet vlerësimi i Nismës OGP (PQH), kështu që vlerësimi krahasues në raport me vendet e tjera nuk është i mundshëm. Kosova nuk e plotëson kriterin e publikimit të draftit të buxhetit shtetëror, por plotëson kriterin e publikimit të raporteve të auditimit të buxhetit për të gjitha institucionet, të cilat publikohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Mbi të gjitha, Nisma OGP (PQH) ka të bëjë me bashkëpunimin gjithëpërfshirës për përmirësim të qeverisjes së hapur. Kosova është në fazat e para të procesit dhe synon përpilimin e planit shtetëror të veprimit në kuadër të Nismës OGP (PQH). Plani i veprimit duhet të jetë produkt i marrëveshjes konsesuale mes Qeverisë, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe grupeve të tjera të interesit, që synon rritjen e transparencës, fuqizimin e qytetarëve, luftimin e korrupsionit dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja për forcim të qeverisjes.

BURIMET/REFERENCAT

AKK, 2013. Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

AMCHAM, 2012. Public Procurement in Kosovo Challenges of the Business Community. Rep. Prishtina: American Chamber of Commerce in Kosovo./Prokurimi Publik në Kosovë, Sfidat e Komunitetit të Biznesit. Prishtinë: Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Beha, A., 2011. Decentralisation in Kosovo: A Challenge to Deal With? /Decentralizimi në Kosovë: Një sfidë me të cilën duhet të merremi? " Journal of Peace, Conflict and Development ISSN 1742-0601: 23-42.

Bennett, Ch, 2011. Public Perceptions of Safety and Security in Kosovo: Time to Act./Perceptimet publike të sigurisë në Kosovë: Koha për të vepruar. Saferëorl.

BIRN (2013). The State: Accessible to citizens. Balkan Investigative Reporting Network – BIRNKosova/Shteti: I qasshëm për qytetarët. Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese – BIRN Kosova

BTI, 2012. Kosovo Country Report. /Raporti i shtetit të Kosovës. Rep. N.p.: Bertelsmann Stiftung's Transformation Index. Print.

Di Lellio, A., 2009. Community Safety. Rep. Prishtina: United Nations Development Programme./Siguria e komuniteteve. Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

EC, 2011. KOSOVO 2011 PROGRESS REPORT. Rep. no. SEC(2011) 1207./Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2011.

EU, 2008. The EU approach to corporate governance/Qasja e BE-së në qeverisjen e korporatave, 2008, f.5-8.

EU, 2013. Annual Programme. Support to Public Administration Reform: 01 – 2013 / 0. Eulex Programme Report, 2011. Bolstering the rule of law in Kosovo: A Stock Take./Programi vjetor. Mbështetja e reformës në administratën publike: 01-2013/0. Raporti i Programit i EULEX-it, 2011. Përkrahja e sundimit të ligjit në Kosovë.

GAP, 2013. Kosovo Budget – transparency and forms of budget reporting./Buxheti i Kosovës – transparenca dhe format e raportimit të buxhetit.

KCSF, 2011. Kosovo Civil Society Index. Better Governance for a Greater Impact. Analytical Country Report for Kosovo./Indeksi i shoqërisë civile të Kosovës. Qeverisje më e mirë për ndikim më të madh. Raport analitik i vendit për Kosovën.

KDI, 2011. Kosovo Democratic Institute. Assessment of Institutional Integrity./Instituti Demokratik i Kosovës. Vlerësimi i integritetit institucional.

KIPRED, 2011. Kosovar Institute for Research and Policy Development. Public Management:

Analysis of executive boards of public enterprises and independent agencies. 2011/06./Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave. Menaxhimi publik: Analiza e bordeve ekzekutive të ndërmarrjeve publike dhe të agjencive të pavarura .

Kosovo Prime Minister's Office, Comprehensive report., 2012. Comprehensive report on the right to access public documents by public institutions./Zyra e kryeministrit të Kosovës, raport gjithëpërfshirës, 2012. Raport gjithëpërfshirës për të drejtën e qasjes në dokumente publike nga institucionet publike,

Kosovo Police, 2012. Kosovo Police annual report./Policia e Kosovës, 2012. Raporti vjetor i Policisë së Kosovës.

MIA, 2011. "National Strategy and Action Plan for Community Safety 2011-2016." Government of Kosovo, Ministry of Internal Affairs./MPB, 2011. "Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016." Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme.

Nitaj, F. 2012. Donor Coordination in Kosovo 2012-2020. Capstone Project Report in partial fulfilment of the requirements for the degree of Master of Science at the RIT - Centre for Multidisciplinary Studies & American University in Kosovo./Bashkërendimi i donatorëve në Kosovë 2012-2020. Raporti i projektit në plotësimin e pjesshëm të kërkesave për diplomën e magistraturës në RIT - Qendra për studime multi-disiplinore & Universiteti Amerikan në Kosovë.

OECD, 2008. Survey on Monitoring the Paris Declaration. Making aid more effective./Studimi për monitorimin e Deklaratës së Parisit. Bërja e ndihmës më efektive.

Office of the Auditor General (2012). Kosovo Annual Audit Report./Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2012). Raporti vjetor i auditimit i Kosovës .

OSCE, 2012. Budget Development Process in Kosovo Municipalities: An Assessment./Procesi i zhvillimit të buxhetit në komunat e Kosovës: vlerësim.

OSCE, 2012a. The state of independent institutions in Kosovo./Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë.

Peteri, G., 2013. "Monitoring and advocating open government partnership commitments in the Western Balkans: Generic Methodology."/"Monitorimi dhe përkrahja e zotimeve të partneritetit për qeverisje të hapur në Ballkanin Perëndimor: Metodologjia e përgjithshme." Preportr, 2013. Periodic publication of the Kosovar Center for Investigative Journalism./Publikimi periodik i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese.

Rinvest., 2009. Improving Corporate Governance and Transparency in Banks and Insurance Companies in Kosovo./Përmirësimi i qeverisjes së korporatave dhe transparencë në

banka dhe në kompanitë e sigurimit në Kosovë.

Riinvest, 2012. Improving Transparency and Governance of Public Funds. Public Procurement Process in Kosovo./Përmirësimi i transparencës dhe qeverisja e fondeve publike. Procesi i prokurimit publik në Kosovë.

Riinvest, 2013. Opinion Poll./Sondazh.

Sigma, 2009. ASSESSMENT Kosovo. Support for Improvement in Governance and Management./Vlerësimi Kosova. Mbështetja për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit.

Sigma, 2011. ASSESSMENT Kosovo. Support for Improvement in Governance and Management./ Vlerësimi Kosova. Mbështetja për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit.

Summary of the Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement." U.S. Department of State. U.S. Department of State, 20 Jan. 2009./Përmbledhje e propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. "Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara. Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 20 janar 2009.

Task Force for European Integration (2012). Discussion Material, Thematic Round Table "Economy, Finance and Statistics"./Task Forca për integritime evropiane. Material për diskutim, Tryezë e rrumbullakët tematike "Ekonomia, Financat dhe Statistika".

UNDP, 2011. Kosovo Human Development Report: Private Sector and Employment./ Raporti për zhvillimin njerëzor të Kosovës: Sektori privat dhe punësimi.

NAPDP, 2013. National Agency for Personal Data Protection Annual Report for 2012./Raporti vjetor i Agjencisë nacionale për mbrojtjen e të dhënave personale për vitin 2012.

Interview with Demush Shasha, the Permanent Secretary of the Ministry of European Integration, January 2013./Intervistë me Demush Shashën, sekretar i përhershëm i Ministrisë për Integritime Evropiane, janar 2013.

Interview with Valdete Idrizi, CiviKos Platform, January 2013. /Intervistë me Valdete Idrizin, Platforma CiviKos, janar 2013.

Interview with Fidan Kalaja, FOL movement, April 2013. /Intervistë me Fidan Kalanë, lëvizja FOL, prill 2013.

Interview with Ardita Metaj, TACSO, April 2013./Intervistë me Ardita Metajn, TACSO, prill 2013.

Web sources:/Burimet nga interneti:

<http://www.opengovpartnership.org> (OGP Initiative website)(Faqja e Nismës PQH).

<https://www.rks-gov.net/en-US/Pages/Fillimi.aspx> (Kosovo Government e-portal, a link to other websites of central and local governmental institutions and other relevant web sources).(E-portali i Qeverisë së Kosovës, një vegzë për faqet e tjera të institucioneve qeveritare qendrore dhe lokale dhe të burimeve të tjera relevante të internetit).

PARTNERËT E PROJEKTIT



CENTER FOR EURO-ATLANTIC STUDIES



Avokimi për Qeverisje të Hapur, i cili ka filluar në janar 2013, është një projekt rajonal i financuar nga BE-ja dhe i udhëhequr nga rrjeti PASOS për inkurajimin e qeverisë së Kosovës, të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë që të bëhen më transparente. Përmes një metodologjie të përbashkët të trajtimit të kornizës së përbashkët për qeverisje të hapur, projekti përfshin trajnimin e shoqërisë civile nga ekspertët lidhur me metodologjinë për formësimin e zotimeve të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) për secilin vend, trajnimin e organizatave të shoqërisë civile të bazuar në avokim, monitorim dhe analizim të politikave. Identifikimi i politikave të qeverisjes dhe i sondazheve është kryer në të gjashtë vendet, me qëllim që të zhvillohen planet e veprimit të politikave të vendeve, duke avokuar për qeverisjen e hapur dhe integritetin për t'i trajtuar pesë sfidat rreth të cilave janë të strukturuar zotimet e OGP.